

AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

**Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet
me shumicë të terminimit të thirrjeve në
rrjetet e telefonisë së lëvizshme**

Dokument Përfundimtar

Miratuar me VKD nr. 4, datë 16.2.2024

208

Përmbledhje ekzekutive	5
1. Hyrje	11
1.1 Analiza e tregjeve përkatëse sipas praktikës së Komisionit European	13
1.2 Procedura e Analizës së Tregut të zhvilluar nga AKEP	16
2. Analizat e mëparshme në tregun e terminimit të thirrjeve mobile	18
3. Praktika e BEREC dhe AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare	21
3.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator.....	21
3.2 Rishikimi i kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike në BE	22
3.3 Tarifat mesatare të terminimit celular në vendet e BE/BEREC	23
3.4 Praktika e rregullimit sipas <i>benchmark</i> të BEREC dhe zbatimi i modelit të kostove Pure LRIC nga AKEP	24
4. Panoramë e përgjithshme e tregut të shërbimeve celulare	28
4.1 Ofruesit e shërbimeve celulare në Shqipëri	28
4.2 Analiza e zhvillimeve të shërbimeve celulare	30
4.2.1 Struktura e përdoruesve të shërbimeve mobile	31
4.2.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare	32
4.2.3 Të ardhurat dhe investimet nga sipërmarrësit e tregut celular.....	33
4.2.4 Treguesit e ARPU dhe ARPM	35
4.2.5 Indeksi i përqendrimit të tregut për treguesit kryesorë të tregut mobile	36
4.2.6 Pësia e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare.....	38
4.3 Masat rregullatore <i>on-net/off-net</i>	40
4.4 Zhvillimet nga 2023 dhe në vijim si dhe këndvështrimi në të ardhmen (Forward looking) ..	42
5. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare	46
5.1 Përcaktimi i tregut përkatës për terminimin e thirrjeve celulare	47
5.2 Përcaktimi i sipërmarrësve me FNT.....	48
5.3 Rregullimi i MTR kombëtare	48
5.4 Metoda e rregullimit të MTR	49
5.4 Rregullimi/derregullimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.....	54
5.4.1. Praktika e Komisionit European dhe vendeve të rajonit për përcaktimin e tregut përkatës	54

5.4.2.	Impakti i terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.....	55
5.4.3	Argumente kundër rregullimit të MTR ndërkombëtare	58
5.4.4.	Argumente pro rregullimit të MTR për thirrjet ndërkombëtare	60
5.4.5	Konkluzione mbi terminimin e thirrjeve ndërkombëtare	63

edj
CJH

Përmbajtja e Figurave

Figura 1: Tarifat MTR sipas vendeve të BEREC (korrik 2021).....	23
Figura 2: Ecuria e tarifave të MTR për Shqipërinë 2010 -2022	26
Figura 3: Glide path i propozur nga konsulentët për reduktimin e MTR.....	28
Figura 4: Numri i përdoruesve të telefonisë celulare (2018 – 2022)	31
Figura 5: Struktura e përdoruesve mobile aktivë.....	32
Figura 6: Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale nga komunikimet elektronike mobile 2016-2022	33
Figura 7: Të ardhurat nga shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjeteve celulare 2016-2022 (miliardë lekë)	33
Figura 8: Ecuria e Investimeve të sipërmarrësve në rrjete celulare 2018-2022.....	35
Figura 9: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit (2013-2022)	41
Figura 10: Terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare 2018-2022	56
Figura 11: Ecuria e të ardhurave nga terminimi në rrjetin celular	57
Figura 12: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare 2014-2022	57

Përmbajtja e Tabelave

Tabela 1: Tarifat për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare	9
Tabela 2: Ndryshimet e listës së tregjeve nën rregullim në BE.....	15
Tabela 3: Udhëzuesi i rishikuar i Komisionit Evropian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg	16
Tabela 4: Tarifat mesatare të thjeshta të terminimit për vendet e BEREC	25
Tabela 5: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (benchmark korrik 2018 – qershor 2021)	26
Tabela 6: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2018-2022.....	30
Tabela 7: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB).....	32
Tabela 8: Ecuria e ARPM dhe ARPU 2017-2022	36
Tabela 9: Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2018-2022	36
Tabela 10: Pesha e thirrjeve hyrëse (minutave) ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celularë 2018-2022.....	38
Tabela 11: Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave të operatorëve 2018-2022.....	38
Tabela 12: Të ardhura mesatare për minutë MTR ndërkombëtar 2018-2022	39
Tabela 13: Të ardhura mesatare për minutë nga terminimi kombëtar dhe ndërkombëtar 2018-2022	39
Tabela 14: Rezultatet e modelit të kostos për reduktimin e përshkallëzuar të MTR.....	51
Tabela 15: Afatet dhe tarifat maksimale të vendosura për aplikimin e MTR kombëtare	53

Përmbledhje ekzekutive

1. Ky dokument përbën versionin final të analizës së tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, dhe është përgatitur pas Këshillimit Publik të dokumentit: “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme*”. Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, miratuar me VKD të AKEP nr.16, datë 16.11.2023, iu nënshtrua procedurave të Këshillimit Publik për një periudhë prej 60 ditësh (16.11.2023 – 16.1.2024), periudhë gjatë së cilës kanë depozituar në AKEP komentet e tyre palët e interesuara Vodafone Albania sh.a., One Albania sh.a., Neofone sh.p.k., si dhe Autoriteti i Konkurrencës.
2. Terminimi i thirrjeve mobile (MTR) është një shërbim me shumicë i ofruar nga operatori mobile për t’i mundësuar konsumatorëve të rrjetit të tij marrjen e thirrjeve. Kur ofruesit e shërbimeve të thirrjeve nga rrjetet fikse ose mobile ju mundësojnë pajtimtarëve të tyre dërgimin (kryerjen) e thirrjes në numrat e rrjeteve mobile të Republikës së Shqipërisë, ata i paguajnë operatorit që u mundëson terminimin e thirrjes një tarifë me shumicë për këtë shërbim, që quhet ‘tarifa e terminimit të thirrjes në rrjetet mobile’. MTR-të përcaktohen mbi bazë tarifimi për minutë dhe aktualisht, sipas parashikimeve të legjislacionit të tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, janë subjekt rregullimi, rregullim i cili bëhet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).
3. Objektivi kryesor i rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile është vlerësimi i konkurrueshmërisë në tregun mobile në Republikën e Shqipërisë dhe marrja e masave të përshtatshme për rregullimin *ex-ante*, me synim nxitjen e konkurrencës dhe eficiencës në këtë treg. Dokumenti i analizës së tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare u përgatit në zbatim të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë udhëzimet dhe rekomandimet e Bashkimit Europian, me synim përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile në Republikën e Shqipërisë, karakteristikat e tregut vendas, si dhe trajton zhvillimet në treg dhe pritshmëritë e AKEP-it për të ardhmen e afërt dhe të mesme, si dhe masat rregulluese përkatëse për sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregjet përkatës të analizuar.
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme është pjesë e rregullores për “Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.9, datë 17.7.2009, e ndryshuar (Rregullorja), sipas së cilës AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse si tregje të mundshme për ndërhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike.
5. Me ligjin nr.107, datë 20.12.2018, Kuvendi vendosi që në ligjin 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa:
 - a. Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:



“c) shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime”.

6. AKEP, me vendimin nr.70, datë 1.10.2018 vendosi për “Miratimin e dokumentit: Rregullimi i tarifave të Sipërmarrësve me fnt në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - dokumenti përfundimtar”, dhe me Vendimet nr.71, nr.72 dhe nr.73 vendosi për “Rregullimin e tarifave të sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg për tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm”, respektivisht për Altelecom, Telekom Albania (tani One Albania) dhe Vodafone Albania.
7. AKEP, me vendimin nr. 89, datë 15.11.2018, vendosi për “Shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 1.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar”, dhe shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues përkatësisht nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 1.10.2018. Sipas pikës 6 të këtij vendimi, AKEP vendosi për “nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse referuar sa më lart, si dhe të tregjeve të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri të plotë të legjislacionit të Bashkimit European”.
8. Me Vendimin nr. 9, datë 24.4.2020, “Mbi përfundimet e arritura pas Këshillimit Publik për dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të akses origjinimit në rrjetet celulare”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi: (i) “Të vlerësojë si të paplotësuar testin e tre kritereve të sanksionuar në pikën 4, të nenit 3, të Rregullores, në përfundim të Analizës së Tregut kryer sipas përcaktimeve dhe hapave proceduralë të parashikuara nga ligji 9918/2008” dhe Rregullorja 9/2009 dhe (ii) të mos përcaktojë sipërmarrës me fuqi të ndjeshme duke mos vendosur detyrime rregullatore në tregun me shumicë të akses-origjinimit në rrjetet celulare, si pasojë e mosplotësimi të testit të tre kritereve, konform pikës 4, të nenit 5, të Rregullores”.
9. Me Vendimin nr.11, datë 16.6.2020 – “Mbi përfundimet e arritura pas përfundimit të Këshillimit Publik të dokumentit: “Analizë tregu i telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi ndër të tjera:
 - T’i konsiderojë të tre operatorët e rrjeteve celulare Altelekom sh.a., Telekom Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr.12, nr.13, nr.14, datë 22.2.2018, si dhe tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë/minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr.71, nr.72, nr.73 të datës 1.10.2018.
10. Duke vlerësuar qëndrimet e operatorëve të rrjeteve celularë gjatë proceseve të mëparshme, parashikueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e vendimeve të AKEP, si dhe procesin e asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një modeli kostosh BULRIC, me anë të Vendimit nr.11, datë 16.6.2020, Këshilli Drejtues i AKEP shpalli sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në tregun

përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare tre operatorët Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom, dhe vendosi të mbajë tarifën aktuale maksimale 1.11 lekë/minutë për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare sipas *benchmark*-ut Pure LRIC të BEREC, deri në përfundim të projektit në zbatim të asistencës teknike për Modelin e Kostove dhe analizën e radhës së tregjeve përkatëse.

11. Gjatë periudhës 2020 – fillimi vitit 2023 në tregun vendas janë shënuar ndryshime të qenësishme në tregjet e komunikimeve elektronike si në aspektin e zhvillimeve teknologjike dhe cilësisë së shërbimit, ashtu edhe në aspektin e ndryshimeve strukturore të sipërmarrësve kryesorë që ofrojnë shërbime nëpërmjet rrjeteve fikse dhe atyre mobile. Disa nga zhvillimet kryesore strukturore paraqiten si më poshtë vijon:
 - a. Përftimi i kontrollit të shoqërisë ABCom sh.p.k., nga shoqëria Vodafone Albania sh.a., autorizuar me vendim e Komisionit të Konkurrencës nr. 676, datë 7.2.2020. Ndryshim i cili i ka mundësuar shoqërisë Vodafone Albania të jetë tashmë një ndër konkurrentët kryesorë edhe në tregun e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve fikse;
 - b. Komisioni i Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 855, datë 14.1.2022, ka vendosur për Autorizimin e përqendrimit të realizuar nga përftimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë Albtelecom sh.a., nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag (4iG Nyrt);
 - c. Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimin nr. 869, datë 8.3.2022, autorizoi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag;
 - d. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të Vendimit nr.14, datë 7.11.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të frekuencave të dhëna sipas regjimit të autorizimit individual dhe regjimit të autorizimit të përgjithshëm, si dhe për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP nga sipërmarrësi “Albtelecom sh.a.” te sipërmarrësi “One Telecommunications sh.a.”;
 - e. Këshilli Drejtues i AKEP, më anë të Vendimit nr.15, datë 16.12.2022, ka miratuar transferimin e të drejtave të përdorimit të disa frekuencave nga sipërmarrësit “Albtelecom sh.a.” dhe “One Telecommunications sh.a.”, tek sipërmarrësi “Vodafone Albania sh.a.”.
12. Si rezultat edhe i ndryshimeve të ndodhura në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike (pika 11), duke filluar nga data 1 janar 2023, në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile ushtrojnë veprimtarinë e tyre dy shoqëri: One Albania (bashkimi i Albtelecom me One Telecommunications) dhe Vodafone Albania. Të dy këto shoqëri (pas përqendrimit Vodafone Albania me Abcom në vitin 2020) janë edhe sipërmarrësit me pjesët më të mëdha në tregun e ofrimit të shërbimit *broadband* nëpërmjet rrjeteve fikse për numër pajtimtarësh.

13. Në përfundim të procesit për ndërtimin e modelit të kostove BULRIC, me anë të Vendimit nr.3, datë 1.4.2021, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi miratimin e dokumentit “*Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile*”, dhe Vendimit nr.10, datë 22.7.2021, për “*Miratimin e dokumentit – Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare*”, publikoi rezultatet e modelit të kostove të pastra mesatare të LRIC për tarifat e terminimit për periudhën 2022 - 2025.
14. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.11, datë 16.6.2020, ndër të tjera ka paraparë rëndësinë e zgjatjes së intervaleve kohore mes dy analizave, nga 3 në 5 vjet, të rekomanduara nga Komisioni Europian, për t’i dhënë kohën e mjaftueshme tregjeve për të strukturuar një fizionomi të qëndrueshme dhe për t’i lejuar rregullatorit të vrojtojë dhe të shqyrtojë kushtet e posaçme dhe dinamikat e tyre reale, duke shmangur çdo analizë skematike. Në këtë kuadër, hartimi i këtij dokumenti vjen pas përfitimit të rezultatit të modelit të kostove për shërbimet e terminimit mobile, dhe merr në konsideratë faktorët ekonomikë specifikë, dinamikat e tregut shqiptar, eventualisht edhe rekomandimet dhe direktivat në fuqi të Komisionit Europian, si edhe impaktin mbi përdoruesit fundorë.
15. Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka trajtuar në dokumente të mëparshme të analizës, në mënyrë të plotë, argumentet *pro* dhe *kundër* për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas disa varianteve të diskutuara për Këshillim Publik, si: (i) klasifikimi si treg nën rregullim me masat e mosdiskriminimit dhe transparencës, (ii) rregullimin e tarifës së terminimit ndërkombëtar mbi bazën e reciprocitetit, (iii) rregullimi i tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare për të konverguar me tarifat e terminimit të brendshëm në rrjetet celulare, nëpërmjet një *glide path* afatshkurtër dhe (iv) lënia e tregut në derregullim sipas praktikave të shumicës së vendeve anëtare të BE/BEREC.
16. AKEP, pas analizës së faktorëve që ndikojnë në këtë treg, dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e shërbimeve të Komisionit Europian si dhe qëndrimin të Operatorëve të Rrjeteve Celulare për shkak të zonës gjeografike të rregullimit jashtë territorit të RSH dhe me efekte negative të ardhurat e operatorëve dhe buxhetit të shtetit dhe pa efekte reale të çmimit me pakicë të shërbimeve të operatorëve celularë të përdoruesit e këtyre shërbimeve, ka vendosur mosrregullimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare. Megjithatë, terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare në periudha kohore të caktuara të mëparshme ka qenë nën rregullim edhe në Shqipëri, por aktualisht terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është i derregulluar plotësisht.
17. Dokumenti përmban dhe një rishikim të ecurisë dhe zhvillimeve të tregut me pakicë të telefonisë celulare nga analiza e vitit 2019, efektet e rregullimit në tregun celular si dhe paraqet përfundimet e AKEP për statusin me FNT dhe masat përkatëse rregulluese për tregjet e analizuara, pas marrjes në konsideratë të komenteve të paraqitura nga palët në Këshillimin Publik.
18. Në konkluzionet për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve mobile, AKEP ka marrë në konsideratë rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare

sipas vendimit nr.10, datë 22.7.2021.

19. AKEP ka konsideruar si një ndryshim të rëndësishëm strukturor zhvillimet që kanë ndodhur në tregun e telefonisë celulare gjatë periudhës 2021-2022, si rezultat i të cilave, duke filluar nga janari 2023 e në vijim, tregu celular gjendet me dy rrjete aktive, pas bashkimit të dy operatorëve One Telecommunications sh.a., dhe Altelecom sh.a., në një operator të vetëm. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.14, datë 7.11.2022, vendosi “Kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP si dhe Autorizimet e Përgjithshme dhe Individuale të sipërmarrësit Altelecom sh.a., tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a.”, i cili ka hyrë në fuqi në datën 1.1.2023 në përfundim të këtij procesi, me pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse të ekstrakteve të dy shoqërive Altelecom sh.a., dhe One Telecommunications sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), duke e çuar numrin e operatorëve në tregun e telefonisë celulare nga 3 në 2 operatorë, përkatësisht: One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.. Mbi këtë ndryshim të rëndësishëm strukturor është referuar edhe këndvështrimi i AKEP-it në zhvillimet e mundshme në të ardhmen e këtij tregu, në këtë dokument.
20. Për sa më sipër, AKEP në këtë dokument ka vendosur përcaktimin e sipërmarrësve One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare.
21. MTR për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT të rishikohen sipas tabelës së mëposhtme, bazuar në përshkallëzimin nëpërmjet *glide path* për zbatimin e ri të MTR në zbatim të rezultateve të modelit të kostove miratuar me VKD nr.10, datë 22.7.2021.

Tabela 1: Tarifat për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare

Tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile (lekë)				
Sipërmarrësi	1.12.2019	01.10.2024	01.04.2025	01.10.2025
One Albania	1.11	1.02	0.89	0.75
Vodafone Albania				

22. Përcaktimi i AKEP për masat rregulluese për sipërmarrësit e përcaktuar me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, u hartua në përputhje me sa është trajtuar në këtë dokument, duke marrë në konsideratë opsionet e mundshme të propozuara për rregullimin e MTR kombëtar, si dhe konsiderimin e opsioneve të dhëna për thirrjet ndërkombëtare hyrëse, si dhe komentet e paraqitura. Sipas ligjit 9918/2008, i ndryshuar, neni 34: “Nëse AKEP përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ai vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji”. Nga përfundimet e arritura në analizën përkatëse të tregut të terminimit të thirrjeve zanore në rrjetet celulare, AKEP ka vlerësuar që seti i masave rregullatore për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore kombëtare të mbetet i njëjtë me përcaktimet në analizën pararendëse, me ndryshimin e vetëm reduktimin e vlerës së MTR-së për terminimin e thirrjeve zanore në dy rrjetet celulare aktive Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a.,

sipas vlerave dhe opsioneve të referuara më sipër, ndaj në mënyrë të përmbledhur masat rregullatore përkatëse janë:

- Detyrimi i Mosdiskriminimit (neni 39);
- Detyrimi i transparencës (neni 40);
- Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit (neni 42);
- Detyrimi për kontroll të tarifave (neni 45).

23. Në vendosjen e detyrimeve, AKEP konsideron objektivat rregullatore dhe faktin që detyrimet ndaj operatoreve me FNT, duhet të jenë proporcionalë me masën e problemit dhe të mos jenë barrë e tepërt për operatorin, duke vlerësuar që të dy operatorët celularë të kenë të njëjtat detyrime për FNT në terminimin e thirrjeve mobile.
24. Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka analizuar gjerësisht argumentet *pro* dhe *kundër* për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas opsioneve të propozuara në Këshillimin Publik, si: (i) Përfshirjen e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare); (ii) me përkufizimin si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje *ex-ante* dhe FNT me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare ose vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare; (iii) aplikimin e një reduktimi të veçantë nëpërmjet *glide path* edhe për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare duke synuar në afat mesëm orientimin drejt MTR kombëtar; (iv) lënie në derregullim siç është aktualisht.
25. AKEP në këtë fazë, duke konsideruar faktorët *pro* dhe *kundër* të referuar në dokumentin e analizës për shërbimin e terminimit të thirrjeve mobile, karakteristikat dhe rrethanat kombëtare, qasjen e Komisionit Europian për mosrregullimin e thirrjeve ndërkombëtare *nga* dhe *drejt* vendeve të treta (jashtë BE-së), vlerëson lënie në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare siç është aktualisht, deri në fazën e ardhshme të analizës së tregut ku do të analizohet edhe mundësia për të orientuar tarifën drejt një euro tarifë të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në Shqipëri, njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së në tregjet e terminimit.
26. Gjithashtu, AKEP vlerëson se masa rregullatore për mosdiskriminim e thirrjeve mobile *on-net/off-net* e vendosur në vitin 2014, e ka dhënë efektin e saj në përputhje me qëllimin e vendosur dhe si e tillë gjykon që kjo masë të tërhiqet në referencë me parashikimet e nenit 36, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar. Arsyet për tërheqjen e kësaj mase rregullatore ndër të tjera argumentohen nga faktorët si:
- a. struktura e re e tregut me dy operatorë mobile;
 - b. mungesa e stimuljeve të nevojshëm për aplikim të tarifave grabitqare për krijimin e grupeve të mbyllura;
 - c. struktura e thirrjeve e balancuar për një periudhë relativisht të gjatë, etj.
27. Në bazë të përcaktimeve të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, ky dokument u hartua pas realizimit të procesit të Këshillimit Publik me palët e interesuara për një periudhë 2 mujore nga data e

publikimit në faqen web të AKEP. Për efekt të transparencës, pas miratimit të dokumentit përfundimtar, komentet e përmbledhura të palëve të interesuara, së bashku me dokumentin final të analizës së tregut (përjashtuar ato konfidenciale) dhe vendimet për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat rregullatore do të publikohen në faqen zyrtare të AKEP.

1. Hyrje

28. Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim ligji 9918), në nenin 1 të tij, përcakton se qëllimi i ligjit është që, nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike, të promovojë konkurrencë dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.
29. Kreu VI i ligjit, Rregullimi i Konkurrencës, përmban përcaktimet për rregullimin e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike, dhe përfshin, ndërmjet të tjerave, detyrimin e AKEP-it për kryerjen e analizës së tregut për vlerësimin e konkurrencës efektive dhe përcaktimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg. Gjithashtu, ky kre përmban kriteret e përdorura nga AKEP për vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg, detyrimet/masat rregulluese në rast të gjetjes së sipërmarrësve me FNT.
30. Hartimi i këtij dokumenti është i një rëndësie të veçantë pasi merr në konsideratë rezultatet e modelit të kostove të përfituara nga shërbimi i konsulencës përgjatë periudhës 2020 – 2021, i cili paraqet informacion të detajuar për kostot e shërbimeve të rrjeteve celulare, si edhe jep rekomandimet përkatëse për vijimin e rregullimit të shërbimeve të terminimit të thirrjeve celulare në përputhje me karakteristikat e tregut shqiptar.
31. Në përputhje me parashikimet e Rregullores nr. 9/2009 “Mbi Analizën e Tregjeve”, e ndryshuar, si edhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit Europian, në këtë dokument jepet përkufizimi i detajuar i tregut përkatës, dimensionit gjeografik dhe ai i produktit/shërbimit.
32. Ky dokument përbën versionin final të Analizës së Tregut për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, dhe është përgatitur pas Këshillimit Publik për këtë dokument të zhvilluar për një periudhë 60 ditore, më 16.11.2023 – 16.1.2024. Bazuar në parashikimet e nenit 35, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, AKEP ka nxjerrë për Këshillim Publik me grupet e interesit dokumentin me përcaktimin dhe analizën e tregjeve, në përputhje me përcaktimet e neneve 32 e 34 të këtij ligji.
33. Rishikimi dhe rregullimi i tregjeve të komunikimeve elektronike është një proces mjaft teknik dhe kompleks, dhe si i tillë bazohet në implementimin e plotë të legjislacionit shqiptar për këtë fushë. Gjithashtu, hartimi i këtij dokumenti merr në konsideratë edhe një sërë udhëzimesh dhe rekomandimesh të Komisionit Europian për të vënë në zbatim praktikatat sa më të mira në fushën e rregullimit të komunikimeve elektronike në vendet e Evropës dhe më gjerë, me qëllim nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike.

34. Pika 4 e nenit 31, parashikon detyrimin për nxjerrjen e një rregulloreje për analizën e tregjeve dhe përcaktimin e sipërmarrësve me FNT në tregjet përkatëse. AKEP, me vendimin nr.747, datë 17.7.2009, ka miratuar Rregulloren për Analizën e Tregjeve (në vijim referuara si Rregullorja), dhe me vendimin nr. 2342, datë 31.7.2013, ka miratuar amendime të kësaj Rregulloreje. Kjo Rregullore përcakton midis të tjerave një listë prej 7 tregjesh për t'u analizuar nga AKEP për FNT, si dhe detyrimin për të kryer testin e tre kritereve për tregjet që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të Rregullores ose e Rekomandimit në fuqi të Komisionit European për tregjet përkatëse të dyshuara për ndërhyrje *ex-ante* në sektorin e komunikimeve elektronike. Lista e tregjeve të përfshira në Rregulloren e AKEP është sipas rekomandimit të KE-së të vitit 2007, ndërsa Rekomandimi i fundit në fuqi i KE-së është Rekomandimi (EU) 2020/2245, datë 18 dhjetor 2020.
35. Bazuar në Rregulloren nr. 9, datë 17.7.2009 "Për Analizën e Tregut", e ndryshuar, AKEP analizon për FNT tregjet përkatëse të mëposhtme si tregje të mundshme për ndërhyrje *ex-ante* në territorin e Republikës së Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike, *inter alia*:
- ***Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme (celulare).***
- Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në Rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për Analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve.
36. AKEP, duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare harton dokumentin e Analizës për shërbimet e komunikimeve elektronike dhe përcakton tregjet përkatëse, dhe në vijim të kësaj analize përcakton nëse në këto tregje ka konkurrencë efektive. Në rastet kur AKEP evidenton se *një* apo *më shumë* sipërmarrës ka/kanë Fuqi të Ndjeshme në Treg, atëherë ai vendos masat e nevojshme, të njohura si kushtet dhe detyrimet për FNT për sipërmarrësin/sipërmarrësit, me qëllim adresimin e problematikave të tregut.
37. Gjatë këtij procesi, AKEP ushtron të drejtën e tij në rregullimin e këtij sektori specifik si rregullatori i vetëm i pavarur në Republikën e Shqipërisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare. AKEP i ushtron funksionet e tij në mbështetje të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, (ligji 9918/2008) dhe akteve të tjera rregullatore, si edhe duke marrë në konsideratë Direktivat dhe Rekomandimet e Komisionit European për këtë fushë.
38. Ligji 9918/2008 parashikon se, kur AKEP gjykon se faktet, që justifikuan përfundimet e arritura për përcaktimin dhe Analizën e Tregjeve (analizat pararendëse), kanë ndryshuar dhe nuk pasqyrojnë situatën aktuale në treg, atëherë AKEP rishikon përfundimet dhe vendimet përkatëse. Pavarësisht kësaj praktike, AKEP është i detyruar që një herë në dy vjet të rishikojë përfundimet për përcaktimin dhe analizën e tregjeve, duke paraqitur përfundimet përkatëse në fushën e komunikimeve elektronike.

1.1 Analiza e tregjeve përkatëse sipas praktikës së Komisionit European

39. Ligji 9918 është në linjë me direktivat e KE-së të vitit 2003 dhe 2009, dhe metodologjia e Analizës së Tregjeve e përcaktuar në Ligj dhe në Rregullore përcakton se AKEP duhet të marrë në konsideratë rekomandimet e Komisionit European dhe BEREC. Disa nga Rekomandimet dhe Udhëzimet e KE dhe BEREC të marra në konsideratë nga AKEP në përgatitjen e këtij dokumenti janë si më poshtë:

- a. Udhëzimi i Komisionit për Analizën e Tregut dhe vlerësimin e FNT (2002/C 165/03) sipas kuadrit rregullator për komunikimet elektronike, rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (në vijim referuar si Udhëzimi i KE)¹;
- b. Dokumenti i rishikuar i ERG² për qëndrim të përbashkët në qasjen ndaj masave rregullatore të duhura në kuadrin rregullator të komunikimeve elektronike;
- c. Rekomandimi i Komisionit, datë 7 maj 2009, për trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet celulare dhe fikse në BE;
- d. Rekomandimi i Komisionit, datë 9 tetor 2014, për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex-ante* në përputhje me Direktivën 2002/21/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit në një kuadër të përgjithshëm rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik (2014/710/EC);
- e. Udhëzuesin e rishikuar të Komisionit European për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT (SMP *guidelines* FLTEEP20180015 - May 6, 2018);
- f. Rekomandimin e Komisionit European (EU) 2020/2245, datë 18 dhjetor 2020, për produktet dhe shërbimet përkatëse brenda sektorit të komunikimeve elektronike të rregulluara *ex-ante* në përputhje me Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit European dhe të Këshillit (EU) 2018/1972 për miratimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane (EECC).

40. Udhëzimet dhe parimet e mishëruara në dokumentin e mjeteve juridike të BEREC synojnë të nxisin zhvillimin e tregut të vetëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, si dhe të bëjnë të mundur një praktikë rregullatore uniforme dhe konsistente në shtetet e ndryshme anëtare. Sipas legjislacionit të KE-së, një sipërmarrës përcaktohet me FNT nëse një ose më shumë ndërmarrje kanë fuqi ekonomike, që i/u jep atij/atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ata të aftë të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

41. Në rekomandimin e vitit 2014, numri i tregjeve të dyshuar për ndërhyrje *ex-ante* është reduktuar në 5, nga 7 që ishte në vitin 2007, dhe në vitin 2020 nga kjo listë kanë mbetur

¹ Official Journal of the European Communities C 165/7: "Commission guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the Community regulatory framework for electronic communications networks and services (2002/C 165/03)"

²ERG (06) 33 "Revised ERG Common Position on the approach to Appropriate remedies in the ECNS regulatory framework" Final Version May 2006.

vetëm dy tregje. Në vijim paraqitet tabela me evoluimin e listës së tregjeve të përcaktuara për rregullim *ex-ante* nga Komisioni European, nga viti 2007 e deri në vitin 2020.



Tabela 2: Ndryshimet e listës së tregjeve nën rregullim në BE.

Lista tregjeve nën rregullim 2007	Lista tregjeve nën rregullim 2014	Lista tregjeve nën rregullim 2020
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (3)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet fikse (1) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (7)	Tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile (2) i pandryshuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse (4)	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar	Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike nga vendndodhje fikse WLA (3a) rishikuar
Tregun me shumicë të aksesit broadband (5)	Tregun me shumicë të aksesit broadband WCA (3b) rishikuar	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të segmenteve terminuese të linjave me qera (6)	Tregun me shumicë të aksesit me shpejtësi të lartë nga vendndodhje fikse (4) rishikuar	Tregun me shumicë të dedikuar nga vendndodhje fikse
Tregun me pakicë të aksesit në rrjet telefonik publik nga vendndodhje fikse (1)	Hequr nga lista	Hequr nga lista
Tregun me shumicë të origjinimit të thirrjeve në rrjetin telefonik publik (2)	Hequr nga lista	Hequr nga lista

42. KE më 7 maj 2018 ka miratuar Udhëzimin e ri për Analizën e Tregut dhe FNT “*Guidelines on market analysis and the assessment of significant market power under the EU regulatory framework for electronic communications networks and services*” (2018/C 159/01), që zëvendëson Udhëzimin e vitit 2002. Ky Udhëzim është marrë në konsideratë nga AKEP në hartimin e këtij dokumenti për Këshillimin Publik.
43. Tregjet e terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë fikse dhe asaj mobile janë hequr nga lista e tregjeve nën rregullim nga BE nën argumentimin se këto tregje kanë tendencë të shkojnë drejt konkurrencës efektive, si rezultat i vendosjes së tarifës së vetme për terminimin e thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe mobile (*single maximum EU-level wholesale rates for fixed and mobile voice termination (F/MTRs)*).
44. Udhëzimi për FNT (KE) e shpreh në mënyrë të qartë që përcaktimi i tregut përkatës nuk është një proces mekanik apo abstrakt. Ai kërkon një analizë të detajuar të të gjithë të dhënave të disponueshme për ecurinë dhe sjelljen në treg në të kaluarën dhe një kuptim gjithëpërfshirës të mekanizmave dhe funksionimit të tregut në të tashmen. Për sa kohë Analiza e Tregut është një proces i cili synon përmirësimin e kushteve të tregut në të ardhmen (*Forward looking*), udhëzimet për FNT e përcaktojnë në mënyrë të qartë që rregullatori duhet të evidentojë nëse tregu është konkurrues ose jo, dhe në këtë mënyrë, nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës efektive, duke marrë në konsideratë parashikimet për zhvillimet e ardhshme të pritshme të tregut gjatë një periudhe të arsyeshme, të marrë masat përkatëse për evitimin e pengesave dhe kufizimeve të konkurrencës efektive.
45. Udhëzimi për përcaktimin me FNT përshkruan se si metodologjia e legjislacionit të konkurrencës mund të përdoret nga rregullatorët e telekomunikacionit në analizat e tyre. Në veçanti, janë dy dimensionet për përcaktimin e tregut përkatës: produktet përkatëse që bëjnë pjesë në të njëjtin treg dhe përcaktimi i tregut gjeografik.

1.2 Procedura e Analizës së Tregut të zhvilluar nga AKEP

46. AKEP, për përcaktimin e tregut përkatës përdor përkufizimin e dhënë në nenin 3, pika 7, të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar: “*Treg përkatës janë produktet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tyre, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese*”.
47. Ky përkufizim i ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, është i ngjashëm dhe në linjë me përkufizimin e dhënë në Udhëzimin e KE-së, Udhëzim i përdorur nga AKEP (ERT) në të gjitha analizat e mëparshme. Për këtë arsye, si dhe duke qenë se Udhëzimi i KE-së është pjesë e dokumenteve të KE-së të referuara në Rregullore për Analizën e Tregut, AKEP në këtë Analizë përdor të njëjtën metodologji për përcaktimin e produkteve/shërbimeve që janë pjesë e të njëjtit treg përkatës, si dhe në Analizat e tjera të tregut, siç është shtjelluar dhe në paragrafët në vijim.
48. Gjatë procesit të kryerjes së Analizës së Tregut, synimi kryesor i rregullatorit është që të evidentojë dhe t’i përgjigjet pyetjes nëse në treg ka konkurrencë efektive? Përcaktimi i termit ‘Fuqi e Ndjeshme në Treg’ është ekuivalent me konceptin e Pozitës Dominuese sipas përcaktimit që bëhet nga ligji i konkurrencës. Në thelb, kjo nënkupton që sipërmarrësi në tregun përkatës zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

Praktika e Komisionit Europian për përcaktimin e Fuqisë së Ndjeshme në Treg

49. Sipas udhëzuesit të rishikuar të Komisionit Europian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg, i cili mbështetet në Analizën e Tregjeve të Komunikimeve Elektronike bazuar mbi parimet e konkurrencës, Fuqia e Ndjeshme në Treg e një sipërmarrësi (*single dominance*) vlerësohet kur një sipërmarrës i vetëm zotëron mbi 40% të tregut përkatës dhe prezumohet kur zotëron mbi 50 % të tregut përkatës.

Tabela 3: Udhëzuesi i rishikuar i Komisionit Europian Për Fuqinë e Ndjeshme në Treg

Dominancë individuale (Single SMP)	Udhëzimi i vjetër për FNT	Udhëzimi i ri për përcaktimin FNT
Supozohet që nuk ka FNT	Poshtë 25%	Nuk ka udhëzime
Risku i FNT	Mbi 40% "Në praktikën vendimmarrëse të komisionit, dyshimet për dominancë individuale normalisht shfaqen në rastet kur një sipërmarrës gëzon pjesë tregu mbi 40%, megjithatë në disa raste Komisioni ngre dyshimet për ekzistencën e dominancës individuale edhe kur një sipërmarrës ka pjesë tregu më të vogël se 40% (pasi dominanca mund të ekzistojë edhe kur një sipërmarrës nuk posedon pjesë të mëdha tregu).	Mbi 40% "Bazuar në eksperiencat e kaluara Komisioni sugjeron se dominanca individuale nuk ka gjasa të ndodhë në rastet kur një sipërmarrës posedon më pak se 40% të tregut përkatës. Megjithatë, mund të ketë raste specifike me pjesë tregu nën këtë nivel ku konkurrentët nuk kanë mundësinë të konkurrojnë në mënyrë efektive sjelljen e një sipërmarrësi dominant.
Supozohet që ka FNT	Mbi 50%	Mbi 50%

Burimi: European Commission issues revised SMP guidelines 6 May 2018 dhe Cullen Interantional

50. Përcaktimi i Fuqisë së Ndjeshme në Treg është dhënë në nenin 33, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, ku përcaktohen kriteret kryesore që duhet të merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar, në këtë nen citohet se:
- Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.*
51. Referenca e dhënë në nenin 33, të ligjit 9918/2008, është pothuajse e njëjtë me përkufizimin e Direktivës Kuadër të KE 2002, si edhe përkufizimin e Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane, neni 63, pika 2³ (Directive (EU) 2018/1972).
52. Për të bërë vlerësimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg, AKEP bazohet, ndërmjet të tjerave, në kriteret e mëposhtme:
- në madhësinë e sipërmarrësit në raport me tregun përkatës, si edhe me ndryshimet në kohë, në pozicionin relativ të tij ndaj lojtarëve të tregut;*
 - në pengesat e larta për hyrje dhe zgjerimin e pritshëm, si rrjedhojë e konkurrencës së mundshme;*
 - në fuqinë kundërvepruese të blerësve;*
 - në zhvillimin e elasticitetit të kërkesës dhe ofertës;*
 - në fazën e tregut përkatës;*
 - në përparësitë teknologjike;*
 - në përparësitë e rrjetit të shitjes dhe të shpërndarjes;*
 - në ekonomitë e shkallës, ekonomitë e sektorit dhe të dendësisë;*
 - në shkallën e integritit vertikal;*
 - në zhvillimin e produkteve të diferencuara;*
 - në aksesin në burimet financiare;*
 - në kontrollin mbi infrastrukturën, që nuk mund të zëvendësohet lehtësisht;*
 - në sjelljen e përgjithshme në treg, si tarifat, paketat e shërbimeve dhe të produktit.*
53. Në përfundim të procesit të analizës së tregut përkatës, AKEP konkludon nëse në treg ka sipërmarrës të përcaktuar me FNT. Nëse një apo më shumë sipërmarrës janë përcaktuar me FNT në tregun përkatës, atëherë AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 36, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, vendos, ndryshon, mban ose heq masat rregullatore të parashikuara në këtë nen.
- Në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve, secili operator i rrjetit të shërbimeve celulare është me fuqi të ndjeshme në treg pasi është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, përfshirë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare.***

³ "An undertaking shall be deemed to have significant market power if, either individually or jointly with others, it enjoys a position equivalent to dominance, namely a position of economic strength affording it the power to behave to an appreciable extent independently of competitors, customers and ultimately consumers".

54. Në zbatim të parashikimeve të ligjit 9918/2008, AKEP zhvilloi një procedurë transparente të Këshillimit Publik për dokumentet e Analizës së Tregut në një proces dinamik, duke publikuar në mënyrë të plotë informacionet dhe qëndrimet e tij rreth analizës së tregjeve përkatëse, operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe masat rregullatore të propozuara, përfshirë dhe rregullimin e tarifës së terminimit, periudha e Këshillimit Publik 16.11.2023 – 16.1.2024.
55. Në përfundim të Këshillimit Publik në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:
- Vodafone Albania sh.a., me shkresën LEA/001/LR, JL, datë 8.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/7 prot., datë 12.1.2024);
 - One Albania sh.a., me shkresën nr.108 prot., datë 15.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/8 prot., datë 15.1.2024);
 - Neofone sh.p.k., me shkresën nr.380 prot., datë 12.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/9 prot., datë 16.1.2024);
 - Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.41/2 prot., datë 16.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/10 prot., datë 22.1.2024).
56. Për efekt të transparencës, përmbledhje e komenteve të palëve të interesuara (përfshirë ato konfidenciale) do të publikohen nga AKEP, së bashku me dokumentin final të Analizës së Tregut dhe Vendimet për përcaktimin e sipërmarrësve me FNT dhe masat rregullatore.

2. Analizat e mëparshme në tregun e terminimit të thirrjeve mobile

57. Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka qenë objekt rregullimi *ex-ante* nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe, duke filluar nga viti 2010 deri në mars 2014, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BULRAIC⁴ i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare. Modeli BULRAIC në vitin 2010 referohet si LRIC+, ndërsa metoda e rekomanduar nga KE dhe e përdorur në shumicën e vendeve europiane tashmë është Pure LRIC.
58. AKEP, me vendimin nr.1505, datë 10.2.2011, miratoi dokumentin për orientimin e tarifave të terminimit në kostot BULRAIC, duke përcaktuar një grafik për reduktimin e përshkallëzuar (*glide path*) të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet e katër operatorëve celularë (tarifat për Plus ishin rekomanduese, pasi Plus nuk kishte status me FNT në kohën e vendimmarrjes). Vendimet 1506-1508 përcaktuan tarifat e terminimit të thirrjeve në mënyrë individuale për Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom.
59. Duke filluar nga muaji prill 2014, AKEP ka përdorur sërish metodën *benchmark* për rregullimin e tarifave MTR, dhe si *benchmark* është përdorur vlera mesatare e tarifave të

⁴ Bottom-Up Long Run Average Incremental Cost (Model Poshtë-Lart i Kostos Mesatare Inkrementale Afatgjatë)



terminimit në vendet europiane që kanë aplikuar modelin e kostove LRIC të pastër, sipas rekomandimit të vitit 2009 të KE. Edhe në proceset e Këshillimit Publik në dhjetor 2016 dhe shkurt 2018, AKEP vendosi që MTR të rregullohen sipas kësaj metode duke propozuar *glide path* përkatëse.

60. Bazuar në gjetjet e Analizës së Tregut 2014, AKEP me vendimet nr. 2522-2526, datë 6.11.2014, përcaktoi që tarifa 1.48 lekë/minutë të fillonte të aplikohet që prej datës 1.12.2014 për Vodafone, Telekom Albania dhe Albtelecom, ndërsa tarifa e terminimit në rrjetin Plus të qëndronte në vlerën 6.52 lekë/minutë deri në një vendim tjetër të AKEP.
61. Bazuar në procesin e shqyrtimit të ankimeve administrative të katër operatorëve celularë për vendimet e datës 6.11.2014, AKEP me vendimin nr.2542, datë 13.3.2015, ndryshoi tarifën e terminimit në rrjetin Plus (të përcaktuar me vendimet e datës 6.11.2014), duke përcaktuar një *glide path* (reduktim të përshkallëzuar) në mënyrë që tarifa e terminimit në rrjetin Plus të arrihte nivelin 1.48 lekë/minutë më datë 1.1.2016. Reduktimi u përcaktua të kryhej me dy faza të ndërmjetme që fillonin me 1.4.2015 dhe 1.7.2015.
62. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr.11, datë 22.2.2018, miratoi dokumentin “*Analizë e tregut të shërbimeve celulare: tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale celulare - Dokumenti Përfundimtar*”, dhe me Vendimet nr. 12, 13 dhe 14, datë 22.2.2018 vendosi:
- “*Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania dhe vendosjen e masave rregulluese*”;
 - “*Përcaktimin e sipërmarrësit Telekom Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Telekom Albania dhe vendosjen e masave rregulluese*”;
 - “*Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese*”.
63. Në lidhje me masën rregulluese të rregullimit të MTR, AKEP, bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg⁵, ndryshimet në MTR *benchmark* në vendet e BEREC, si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në janar 2018, përgatiti një version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR për Këshillim Publik me palët e interesuara.
64. AKEP, me vendimin nr.70, datë 1.10.2018, vendosi miratimin e dokumentit: “*Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar*”.
65. Me vendimet nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR në nivelin e 1.22 lekë/minutë duke filluar nga data 1.12.2018, dhe në nivelin 1.11 lekë/minutë nga data 1.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuara në

⁵ Dalja e Plus Communication nga tregu.

nivelin *benchmark* të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC deri në 2016 dhe korrik 2017 respektivisht.

66. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.78, datë 1.10.2018, miratoi dokumentin “*Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar*”, mbi bazën e të cilit miratoi vendimin nr. 79, datë 1.10.2018, ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet nr.80 dhe nr.81, datë 1.10.2018, përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Albtelecom sh.a., dhe sipërmarrësin Telekom Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.
67. Të tre sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., Telekom Albania sh.a., dhe Albtelecom sh.a., u shpallën sipërmarrës me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, si dhe u vendosën masat përkatëse rregullatore për Detyrimin e Mosdiskriminimit dhe Detyrimin e Transparencës.
68. AKEP, me Vendim nr.89, datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit nr.78, datë 1.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “*Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar*” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 1.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr.78, datë 1.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP. Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e Analizës për tregjet përkatëse si dhe të tregjeve të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri me legjislacionin e Komisionit European. AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit European për të përfutuar ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces.
69. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr.11, datë 16.6.2020, miratoi dokumentin “*Mbi përfundimet e arritura pas Këshillimit Publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare*”, në të cilin vendosi t’i konsiderojë të tre operatorët e rrjeteve celulare Albtelekom sh.a., Telekom Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a., si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi masat rregullatore të përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr.12, 13, 14, datë 22.2.2018, si dhe tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë/minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018. Gjithashtu, vendosi të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të

thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.

70. Në përfundim të procesit të asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një modeli kostosh BULRIC përgjatë periudhës 2020 – 2021, AKEP, me Vendimin nr.3, datë 1.4.2021, vendosi “Miratimin e dokumentit: Modeli i Referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile”, dhe me Vendimin nr.10, datë 22.7.2021 për “Miratimin e dokumentit – Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”, publikoi rezultatet e modelit të kostove të pastra mesatare të LRIC për tarifatat e terminimit.

3. Praktika e BEREC dhe AKEP për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare

71. Ky kapitull përmban informacion mbi dokumentet e KE dhe BEREC që kanë lidhje me tarifatat e terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare. Në seksionin e parë përshkruhen elementët kryesorë të rekomandimeve të KE për tarifatat e terminimit, ndërsa seksionet e tjera përmbajnë informacion në lidhje me tarifatat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC si dhe krahasime të këtyre tarifave me tarifatat e terminimit në Shqipëri.
72. Tarifatat e terminimit në vendet e BE dhe BEREC në dokumentin “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare– Dokument përfundimtar”, të miratuar në tetor 2018, janë përditësuar sipas dokumenteve më të fundit të publikuar nga BEREC, duke dhënë shënimet/sqarimet përkatëse.

3.1 Rekomandimi i KE 2009/396/EC dhe propozimi i KE 2016 për rishikimin e kuadrit rregullator

73. Komisioni Europian (BEREC) në dokumente të ndryshëm ndër vite në lidhje me rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare, ka rekomanduar përdorimin e modeleve LRIC (BU, TD apo kombinim të tyre). Komisioni Europian në rekomandimin më të fundit për orientimin në kosto të tarifave të terminimit, *Rekomandimi i KE i datës 7 maj 2009, mbi trajtimin rregullator të tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe celulare në BE (2009/396/EC)*, u ka rekomanduar autoritetet rregullatore, midis të tjerave:
- Përcaktimin e tarifave të terminimit bazuar në kostot e ofrimit nga një operator eficient. Kjo nënkupton gjithashtu se tarifatat duhet të jenë simetrike. Për përcaktimin e shkallës minimale të eficiencës për operatorët celularë rekomandohet të përdoret një operator me pjesë tregu 20%;
 - Vlerësimi i kostove eficiente të bazohet në kostot korrente dhe përdorimin kostove afatgjatë inkrementale me metodën BU, si metodologjia e duhur e kostove;
 - Rregullatorët mund të përdorin krahasimin e rezultateve të modelit BU me model TD, i cili përdor të dhëna të audituara për të përmirësuar konsistencën e rezultateve dhe mund të bëjnë rregullimet e nevojshme;

- Si inkrement të përdoret shërbimi me shumicë i terminimit që i shitet operatorëve të tjerë dhe jo gjithë shërbimet si në rastin LRIC+;
- Asimetri mund të përdoret në raste kur mund të demonstrohet se hyrësit e rinj kanë disavantazh në raport me operatorët e tjerë;
- Vendet që nuk kanë mundësi për aplikim modeli kostosh LRIC të pastër mund të përdorin metodën *benchmark* duke iu referuar vlerave në vendet që kanë aplikuar modelin LRIC të pastër.

74. Zgjedhjet e dhëna nga KE në këtë rekomandim kanë ndikim në rezultatet e modeleve BULRIC të aplikuar më parë dhe modeli i llogaritjes së kostove me zgjedhjet e përfshira në këtë rekomandim tashme njihet si LRIC i pastër (pure LRIC). Ky Rekomandim është zbatuar gjerësisht tashmë në vendet e BE-së dhe, njëkohësisht, ka filluar implementimi edhe në disa vende të rajonit.

3.2 Rishikimi i kuadrit rregullator të komunikimeve elektronike në BE


75. KE, nëpërmjet dokumentit të datës 11.10.2018, DIRECTIVE (EU) 2018/1972 “*Directive of the European Parliament and of the Council establishing the European Electronic Communications Code*”, ka caktuar BEREC që të hartojë një set masash rregullatore dhe udhëzime në funksion të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike.
76. Në përputhje me parashikimet e nenit 75 të Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane (EECC) Komisioni Europian, duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 117 të EECC, ka përshtatur një akt për të mbështetur këtë direktivë për vendosjen e një tarife të vetme maksimale për secilin nga shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe ato mobile, të cilat do të vendosen në të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të BE.
77. Kodi gjithashtu parashikon në nenet 75 (2) dhe 75 (3) që Komisioni duhet të rishikojë Rregulloren e Deleguar çdo pesë vjet, dhe në secilën rast të tillë të marrë parasysh nëse vendosja e tarifave të vetme maksimale të terminimit për thirrjet zanore në nivel Unioni mbetet e domosdoshme duke zbatuar kriteret e listuara në nenin 67 (1).
78. Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtarë (NRAs), pas hyrjes në fuqi të tarifave, nuk do të mund të vendosin masa rregullatore për kontrollin e tarifave për shërbimet celulare ose fikse në territorin e tyre kombëtar, por mund të përdorin vetëm instrumentin e masave të palidhura me rregullimin e tarifave/çmimeve (*non-price related obligation on the termination providers*).
79. Në përputhje me parashikimet e mësipërme, KE ka miratuar Rregulloren (Delegated Regulation) 2021/654, datë 18.12.2020 “Mbështetje e Direktivës (EU) 2018/1972”. Kjo rregullore, ndër të tjera, përcakton detyrimin për aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve celulare (MTR) dhe një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) dhe do të jenë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha vendet e BE.




3.3 Tarifate mesatare të terminimit celular në vendet e BE/BEREC

80. BEREC ka kryer publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare të vendeve që bëjnë pjesë në BEREC. Në listën e vendeve që publikon BEREC aktualisht përfshihen 37 vende ku bëjnë pjesë 28 vendet anëtare të BE, vendet e zonës EEA dhe disa vende me statusin kandidat për anëtar në BE. Publikimet bëhen çdo gjashtë muaj dhe dokumenti i fundit i publikuar nga BEREC i përket datës 9 dhjetor 2021, dokumenti *BoR (21) 159 "Termination rates at European level-30 June 2021" 9 December 2021*,⁶ i cili paraqet situatën e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) më 1 korrik 2018. Dokumenti i BEREC, përveç nivelit mesatar të tarifave të terminimit, përmban informacion të detajuar edhe për tarifën e terminimit sipas operatorëve në çdo vend dhe metodën e aplikuar për rregullimin e tarifës së terminimit celular, përfshirë aplikimin e LRIC të pastër si dhe *glide path* të parashikuar nga autoritetet rregullatore përkatëse.
81. Figura e mëposhtme përmban informacion mbi tarifën *benchmark* të MTR në vendet e BE/BEREC deri në korrik 2021 sipas dokumentit më të fundit të BEREC *BoR (21) 159 "Termination rates at European level-June 2021" 9 December 2021*.⁷

Figura 1: Tarifate MTR sipas vendeve të BEREC (korrik 2021)



Burimi: BEREC, BoR (21) 159, dhjetor 2021

82. Sipas të dhënave të këtij dokumenti të BEREC tarifa MTR mesatare e ponderuar në vendet e BE/BEREC rezultojnë 0.7170 eurocent për minutë, (0.881 lekë)⁸ nga 0.7574 eurocent (0.94 lekë) për minutë në vitin 2020, dhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet në analizë (37 vendeve të BEREC) rezultojnë 0.6952 eurocent (0.854 lekë), duke shënuar rënie me rreth 4% në krahasim me 0.7222 eurocent (0.899 lekë) për minutë në vitin 2020.

⁶https://www.berec.europa.eu/sites/default/files/files/document_register_store/2021/12/BoR_%2821%29_159_Termination_Rates_Report_-_30_June_2021_P4_2021_clean.pdf

⁷ <https://www.berec.europa.eu/en/document-categories/berec/reports/report-on-termination-rates-at-the-european-level-30-june-2021>

⁸ Kursi i këmbimit sipas dokumentit të BEREC BoR (21) 159, dhjetor 2021: 1 Euro=122.9773 Lekë.

83. Bazuar në të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, nga krahasimi me MTR e publikuara të vitit 2020, vërehet se ka reduktim të MTR, konkretisht tarifa mesatare e ponderuar e vendeve të BE është reduktuar në 0.7170 eurocent për minutë, nga 0.7574 eurocent për minutë në vitin 2020. Gjithashtu, edhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet e analizuar ka pësuar rënie, duke arritur nivelin 0.6952 eurocent për minutë në vitin 2021, nga 0.722 eurocent që ishte në vitin 2020.
84. Në zbatim të parashikimeve të Kodit të ri të Komunikimeve Elektronike Europiane, Komisioni European miratoi Rregulloren e Deleguar 2021/654, datë 18.12.2020, për implementimin e një tarife maksimale të përbashkët terminimi në të gjithë Bashkimin European. Sipas kësaj Rregullore, që nga data 1 korrik 2021 ka filluar implementimi i tarifave të përbashkëta të terminimit në vendet e BE-së. MTR e përbashkët pritet të jetë 0.2 eurocent për minutë në 1 janar 2024. Në zbatim të kësaj Rregullore, të gjitha vendet e Bashkimit European mund të vendosin tarifa të terminimit të thirrjeve afër vlerave të përcaktuara sipas *glide path*-it të parashikuar në këtë Rregullore.
85. Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga AKEP mbi tarifat e termimit të thirrjeve mobile në vendet e rajonit në vitin 2023, vërehet se MTR e Maqedonisë së Veriut është 1.06 eurocent/minutë, Serbia MTR 0.95 eurocent/minutë, Mali i Zi aplikon MTR në vlerën 0.52 eurocent/minutë, Kosova aplikon MTR 0.846 eurocent/minutë, ndërkohë MTR e Shqipërisë me kursin mestar të këmbimit për vitin 2022 llogaritet në vlerën 0.9334 eurocent/minutë. Në të gjitha këto vende aktualisht rregullimi i MTR aplikohet vetëm për trafikun kombëtar dhe jo për trafikun ndërkombëtar (përfshirë rregullimin si shkak i marrëveshjes së *roaming* në Ballkanin Perëndimor).

3.4 Praktika e rregullimit sipas *benchmark* të BEREC dhe zbatimi i modelit të kostove Pure LRIC nga AKEP

86. Në vijim të vendimmarrjeve të AKEP në mars 2014 si dhe në vijim të publikimit të rezultateve të modelit të kostove për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri, i cili deri tani ka qenë i bazuar në tarifat *benchmark* të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër (Pure BULRIC), në këtë seksion AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me tarifën mesatare të thjeshtë për 27 vende të BE dhe tarifën mesatare të 37 vendeve që kanë raportuar në BEREC, dhe krahasimin e këtyre tarifave me tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare në Shqipëri.
87. Tabela e mëposhtme paraqet tarifat mesatare të thjeshta për 27 vendet e BE dhe vlerën mesatare të thjeshtë të tarifave të terminimit në 37 vendet që raportojnë në BEREC, si dhe krahasimin me tarifat aktuale të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Shqipëri .


Tabela 4: Tarifrat mesatare të thjeshta të terminimit për vendet e BEREC⁹

	BEREC 30.06.2021		Shqipëri 30.06.2021	Shqipëri/BEREC
	Eurocent/minutë	Lekë/minutë	Lekë/minutë	Ndryshimi %
AVG EU27(S)	0.6706	0.825	1.11	35%
AVG 37(S)	0.7442	0.915	1.11	21%

88. Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër, vërehet se tarifrat e terminimit MTR në Shqipëri në këtë periudhë janë më të larta se ato të vendeve të BEREC si për mesataren e thjeshtë të 37 vendeve të EEA, ashtu edhe për atë të 27 vendeve të BE.
89. Numri i vendeve që përdorin modelin e kostove “*Pure LRIC*” në dokumentin e fundit të BEREC BoR(21)159 të publikuar në dhjetor 2021 rezulton 25, nga 24 që ishte në vitin 2017. Nga dokumentet e BEREC për vitet 2018 dhe 2019, evidentohet se Qipro deri në vitin 2017 ka përdorur metodën *Benchmarking*, dhe duke filluar nga data 1.1.2018 ka aplikuar modelin e kostove *Pure LRIC*.
90. Referuar të dhënave të raportit të BEREC, të datës 9 dhjetor 2021, 6 vende (përfshirë Shqipërinë) i rregullojnë tarifrat e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifa *benchmark* nga vendet që kanë aplikuar modelin ‘*Pure-BULRIC*’, ndërsa Qipro, duke filluar nga viti 2018 ka filluar zbatimin e modelit të kostove *Pure LRIC*. Tarifrat e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatëse në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit *Pure BULRIC* në vendet e tjera Europiane/BE. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Rregullores së Komisionit European 2021/654, që nga 1 korrik 2021, shumë vende të BE kanë filluar aplikimin e MTR-ve sipas vlerave të *glide path* të përcaktuar në këtë Rregullore.
91. Në Shqipëri, AKEP ka përcaktuar vlerën 1.48 lekë/minutë në vitin 2014, duke përdorur tarifën mesatare prej 1.0550 eurocent të 13 vendeve që kishin aplikuar modelin *Pure BULRIC* deri në fund të vitit 2013. Rregullimi më i fundit i bazuar në metodën ‘*benchmark pure BULRIC*’ është kryer në Islandë, e cila ka përlllogaritur vlerën *benchmark* prej 0.8813 eurocent/minutë në gusht 2016 dhe kjo vlerë ka filluar të aplikohet nga janari 2017.
92. Tarifrat e terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri kanë ardhur duke u reduktuar në mënyrë të përshkallëzuar si rezultat i ndërhyrjes së AKEP, nga viti në vit, duke konvergjuar drejt një simetrie të plotë mes tre operatorëve. Në figurën e mëposhtme paraqitet grafikisht ecuria e tarifave të terminimit për operatorët celularë si dhe mesatarja e tyre nga viti 2010 e në vazhdim:

⁹ BoR(21)159 “Termination rates at European level – 30 June 2021”

Figura 2: Ecuria e tarifave të MTR për Shqipërinë 2010 -2022



Burimi: AKEP

93. Nga grafiku vërehet që tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale kanë ardhur në ulje, duke pasur fillimisht një asimetri midis dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj në këtë treg) kundrejt operatorëve ekzistues Vodafone Albania dhe One Telecommunications (tashmë One Albania, pas bashkimit të One Telecommunications dhe Albtelecom), për të shkuar në simetri të plotë pas daljes së Plus nga tregu dhe vendimmarrjes së AKEP në tetor 2018. Ndërsa aktualisht, me ndryshimet e reja të ndodhura në strukturën e tregut të telefonisë celulare pas bashkimit të dy operatoreve Albtelecom dhe One Telecommunications, nga data 1.1.2023 tregu i telefonisë celulare ka kaluar nga 3 operatorë, në 2 operatorë, përkatësisht Vodafone Albania dhe One Albania.

94. Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të tarifave mesatare *benchmark* të publikuara nga BEREC, përditësuar me të dhënat edhe për qershor 2021, sipas dokumentit të BEREC BoR(21)159). Kursi i këmbimit i përdorur për periudha të ndryshme i referohet kursit të këmbimit të publikuar nga BEREC në dokumentin përkatës.

Tabela 5: Vlerat mesatare të tarifave të terminimit celular (*benchmark* korrik 2018 – qershor 2021)

	Korrik 2018		Janar 2019		Qershor 2021	
	Eurocent	LEKË	Eurocent	LEKË	Eurocent	LEKË
Average BEREC (Pure LRIC)	B	1.01	0.7547	0.94 ¹⁰	0.6303	0.77 ¹¹
Average EU28(S)	0.8342	1.06	0.7794	0.97	0.6706	0.82
Average EU28 (Ë)	0.8541	1.09	0.7837	0.98	0.7170	0.88
Average BEREC 37(S)	0.9402	1.2	0.8847	1.10	0.7442	0.91
Average BEREC 37(Ë)	0.8467	1.08	0.7956	0.99	0.6952	0.85
Albania (AVG 3 MNO)	1.16215	1.48	0.9801	1.22	0.90260	1.11

¹⁰ Kursi këmbimit 1 eur=124.48 ALL

¹¹ Kursi këmbimit 1 eur=122.973 ALL

ECY

Burimi: Dokumentet e BEREC dhe llogaritje të AKEP.

Nga sa më lart, rezulton se:


- Tarifa mesatare e thjeshtë e 28 vendeve anëtare të BE në 1 korrik 2018 ishte 1.06 lekë/minutë, ndërsa tarifa mesatare e ponderuar ishte 1.09 lekë/minutë. Këto vlera ishin 26-28% më të ulëta se niveli i MTR në Shqipëri deri në nëntor 2018 prej 1.48 lekë/minutë;
- Tarifa mesatare e thjeshtë e 37 vendeve të BEREC (që përfshin edhe vende të rajonit dhe Shqipërinë) më 1 korrik 2018 ishte 1.20 lekë/minutë, ndërsa mesatarja e ponderuar 1.08 lekë/minutë. Këto vlera janë respektivisht 19% dhe 40% më të ulëta se niveli prej 1.48 lekë/minutë në Shqipëri deri në nëntor 2018;
- Nga raporti i BEREC për korrik 2018, nga 37 vende të BEREC, 23 vende kanë aplikuar modelin BULRIC të pastër, dhe 7 vende (përfshirë Shqipërinë) kanë aplikuar *benchmark* mbi tarifën e aplikuar në vendet me këtë model kostoje;
- Tarifën mesatare në vendet e BE dhe BEREC në janar 2019 janë reduktuar më tej 5-16% në krahasim me korrik 2018 (me vlerat në eurocent) dhe tarifën mesatare të BEREC (Pure LRIC) janë 23% më të ulëta se tarifa 1.22 lekë/minutë në fuqi deri në 1.12.2019, dhe për qershor 2021 tarifën mesatare të BEREC (Pure LRIC) janë 30% më të ulëta se tarifa aktualisht në fuqi 1.11 lekë/minutë.
- Duke filluar nga data 1.7.2021, në zbatim të Rregullores së Komisionit Europian 2021/654 për implementimin e tarifave të përbashkëta të terminimit (MTR dhe FTR) në vendet e BE, janë përcaktuar eurotarifat (Eurorates) përkatësisht në vlerat: 0.7 eurocent/minutë për periudhën 1.7.2021 – 31.12.2021, dhe 0.55 eurocent/minutë për periudhën 1.1.2022 – 31.12.2022, të cilat janë përkatësisht 22% dhe 39% më të ulëta se tarifa aktuale e terminimit MTR në Shqipëri 1.11 lekë/minutë.

95. Duke përafuar tarifën e terminimit celulare me BE/BEREC në tetor të vitit 2018, AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR u përcaktua në nivelin e 1.22 lekë/minutë duke filluar nga data 1.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lekë/minutë nga data 1.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin *benchmark* të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e koston Pure LRIC.

96. Pas përfundimit të projektit të asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet e rrjeteve celulare, me vendimin nr.10, datë 22.7.2021, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi për "Miratimin e dokumentit – Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare", duke publikuar rezultatet përkatëse të modelit si dhe *glide path*-in për zbatimin e ri të MTR për thirrjet hyrëse kombëtare, si në figurën¹² më poshtë:

¹² Figura 41 – *Glide path* (p.sh., thirrjet hyrëse kombëtare) e dokumentit "Modeli dhe rezultatet e kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare", miratuar me vendimin nr.10, datë 22.7.2021.

Figura 3: Glide path i propozuar nga konsulentët për reduktimin e MTR



Burimi: Tera Consultants

97. AKEP, në këtë proces analize me përcaktimin e sipërmarrësve me FNT në tregun përkatës, ka proceduar me rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve telefonike në rrjetin mobile duke u bazuar në rezultatet e modelit të kostove të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.10, datë 22.7.2021.

4. Panoramë e përgjithshme e tregut të shërbimeve celulare

4.1 Ofruesit e shërbimeve celulare në Shqipëri

98. Bazuar në ligjin 9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe shërbimet celulare pajisen me autorizim të përgjithshëm dhe individual për përdorimin e burimeve të fundme, sipas procedurave ligjore dhe nënligjore të sektorit, dhe janë të regjistruar në Regjistrin e Autorizimeve të Përgjithshme për këto shërbime.
99. Në sektorin e rrjeteve dhe shërbimeve celulare aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre dy sipërmarrës (operatorë):
- One Albania sh.a., (nga bashkimi me përthithje i dy operatoreve Albtelecom sh.a., dhe One Telecommunications sh.a.);
 - Vodafone Albania sh.a..
100. Operatori One Albania sh.a., është operator kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri, i cili operon me këtë emër që nga data 1.1.2023, si rezultat i bashkimit me përthithje të operatorit Albtelecom tek operatori One Telecommunications, dhe me pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse të ekstrakteve të dy shoqërive Albtelecom sh.a., dhe One Telecommunications sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Të dy operatorët One Telecommunications dhe Albtelecom kanë qenë operatorë publik kombëtar të licencuar, respektivisht:

- One Telecommunications sh.a., (më parë Albanian Mobile Communications, ish AMC) është licencuar si operator publik kombëtar i telefonisë celulare në vitin 1996 dhe ka funksionuar si kompani shtetërore deri në shtator të vitit 2000, kur u krye privatizimi i 85% të aksioneve¹³, pjesë e cila u ble nga Cosmote Group¹⁴, operatori celular në Greqi, e cila ishte vetë pjesë e grupit OTE, operatorit *incumbent* në Greqi. Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës zotëronte rreth 12.6% të aksioneve të Telekom Albania sh.a., deri në vitin 2008, kur u krye dhe shitja e kësaj pjese Cosmote Group. Afërsisht 2.4% të aksioneve zotëroheshin nga aksionerë të vegjël (punonjës të AMC në kohën e privatizimit) të cilat më pas janë blerë nga Cosmote Group. Deutsche Telekom është aksionari më i madh i OTE. Në korrik 2015, Albanian Mobile Communications ndryshoi emrin në Telekom Albania, dhe në korrik 2020 Telekom Albania ndryshoi emrin në One Telecommunications.
 - Operatori Altelecom është licencuar si operatori i tretë kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri, më 1 mars 2004. Licenca i është dhënë Altelecom si pjesë e paketës së privatizimit të kësaj kompanie, proces i cili përfundoi në vitin 2007. Operatori Eagle Mobile filloi ofrimin e shërbimeve celulare në mars 2008 nën emrin Eagle Mobile sh.a., dhe ka funksionuar si kompani me vete me 100% pronësi të Altelecom sh.a., deri më 31.1.2013, duke u përthithur më pas nga Altelecom sh.a. Pas bashkimit të dy kompanive, shërbimet celulare ofroheshin nga Altelecom sh.a.
101. Operatori Vodafone Albania sh.a., është licencuar si operatori i dytë kombëtar i shërbimit celular në Shqipëri më 9 qershor 2001. Aksionerët e Vodafone Albania janë Vodafone Europe B.V dhe Vodafone Panafon International Holding B.V, të cilët zotërojnë secili 50% të aksioneve. Në 3 gusht 2001 Vodafone Albania filloi ofrimin e shërbimeve të saj GSM në Shqipëri.
102. Struktura e tregut, deri më datë 31 dhjetor 2017, ishte me 4 sipërmarrës. Operatori Plus Communication ishte operatori i katërt celular, të cilit iu dha autorizimi individual nga AKEP me datë 26.6.2009. Plus Communication filloi ofrimin e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme në fund të muajit nëntor 2010. Pas daljes nga tregu të Plus Communication sh.a., deri më datë 31 dhjetor 2022 struktura e tregut ishte me tre operatorë.
103. Që nga data 1 janar 2023, pas bashkimit me përthithje nga operatori One Telecommunications sh.a., të operatorit Altelecom sh.a., struktura e tregut të telefonisë celulare kaloi nga 3 në 2 sipërmarrës: One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr.14, datë 7.11.2022, vendosi “kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP, si dhe Autorizimet e

¹³ Kontrata e shitjes së aksioneve të Telekom Albania është ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8660, datë 18.9.2000.

¹⁴ Me shkresën nr. prot., 508/2 të datës 13.2.2019, Telekom Albania e ka njoftuar AKEP-in mbi transferimin e kontrollit të 99.757 % të aksioneve të zotëruara nga Cosmote Mobile Telecommunications S.A te shoqëria Albania Telecom Invest AD.

Përgjithshme dhe Individuale të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., tek sipërmarrësi One Telecommunications sh.a.”.

4.2 Analiza e zhvillimeve të shërbimeve celulare

104. Deri në fund të vitit 2022 në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare në Shqipëri ushtruan aktivitetin tre sipërmarrës: Albtelecom sh.a., One Telecommunications sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a. Të tre sipërmarrësit kanë raportuar të dhënat sipas afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse. Në tabelën në vijim paraqitet ecuria për disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2018 – 2022 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2021/2022.

Tabela 6: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2018-2022

Viti	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
- Sipas kartave SIM	4,143,603	3,378,886	3,337,824	3,484,158	3,771,419	8.24%
- Përdorues aktivë	2,714,878	2,630,076	2,618,880	2,635,466	2,782,226	5.57%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
- Totali	2,657,015	2,462,057	2,469,850	2,789,023	2,794,443	0.19%
- Përdorues aktivë	1,809,996	1,789,158	1,998,579	2,056,444	2,140,180	4.07%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	6,019,006,073	5,494,296,034	5,286,361,927	5,602,663,590	5,006,718,174	-10.64%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	2,525,099,112	2,318,816,619	2,306,339,577	2,501,744,337	2,159,758,675	-13.67%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	164,608,604	213,311,650	187,708,510	144,033,382	119,836,468	-16.80%
Numri mesazhesh SMS të dërguara nga përdoruesit	1,212,559,068	967,833,263	660,604,925	555,701,627	553,607,871	-0.38%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjetet celulare (GB)	60,051,808	69,135,490	88,950,833	155,585,664	184,480,857	18.57%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët, përpunimi AKEP

105. Nga të dhënat e tabelës vihet re se volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, volumi i cili është rritur me rreth 18.57% krahasuar me vitin 2021. Numri total i pajtimtarëve të shërbimeve celulare, sipas kartave SIM, përgjatë vitit 2022 u rrit me rreth 8.24% në krahasim me vitin 2021, ndërkohë numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare përgjatë të njëjtës periudhë është rritur rreth 5.57%.


106. Nga vlerësimi dhe krahasimi i të dhënave nga vitet e kaluara, vihet re një rritje e vazhdueshme e përdorimit të të dhënave 'Data'. Nga krahasimi i volumit të datave të konsumuara në fund të 2022 me vitin pararendës 2021, rezulton se dy rrjetet One Telecommunications me rreth 18%, e ndjekur nga Vodafone Albania me 16% si dhe me reduktim të konsumit të datave për Albtelecom në rreth 3.4%. Rritja e përdorimit të internetit nëpërmjet telefonave celularë evidenton faktin se tashmë telefonat celularë të pajisur me karta SIM e kanë ridimensionuar rolin e tyre duke kaluar nga përdorimi tradicional për kryerjen e thirrjeve zanore, drejt ofrimit të aksesit të gjerë në botën virtuale (shfletim informacionesh, transmetim të dhënash, kryerje e thirrjeve audio/video, sms, etj.). Sikundër,

treguesit e shërbimeve tradicionale thirrje zanore dhe dërgim mesazhesh kanë shënuar rënie të vazhdueshme, rënia e cila është pasojë edhe e përdorimit në masë i aplikacioneve OTT (Whatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj.) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe *video calls*.

4.2.1 Struktura e përdoruesve të shërbimeve mobile

107. Të dhënat e evidentuara nga AKEP tregojnë se numri total i kartave SIM arriti në rreth 3.7 milionë në fund të vitit 2022, e thënë ndryshe çdo banor në Shqipëri posedon rreth 1.35 karta SIM, shifër kjo më e lartë se mesatarja e rajonit të Evropës dhe ajo globale, përkatësisht 1.21 dhe 1.08 karta SIM¹⁵ për banorë. Ndërkohë numri i pajtimtarëve aktivë të shërbimeve mobile përgjatë vitit 2022 arriti rreth 2.8 milionë, duke arritur nivelin më të lartë që nga viti 2018.

Figura 4: Numri i përdoruesve të telefonisë celulare (2018 - 2022)




108. Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër vërehet se numri i pajtimtarëve që zotërojnë një SIM Card ka rënë ndjeshëm që nga viti 2018, gjë e cila lidhet edhe me daljen nga tregu të sipërmarrësit Plus Communication. Për sa i përket numrit të përdoruesve aktivë, edhe pse ka pasur rënie përgjatë periudhës 2018-2020 rënia ka qenë më e ulët. Duke filluar nga viti 2021 ka pasur rritje të numrit të pajtimtarëve aktivë dhe në vitin 2022 ky numër i ka tejkaluar vlerat e vitit 2018, duke reflektuar ndryshime jo të përfillshme në segmentin kohor 2018-2022.

109. Grafiku në vijim paraqet strukturën e përdoruesve aktivë të shërbimeve mobile, ku evidentohet qartësisht trendi i përafrimit të numrit të pajtimtarëve me kontratë drejt pjesës me parapagesë.

¹⁵ <https://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/FactsFigures2022.pdf>

Figura 5: Struktura e përdoruesve mobile aktivë



110. Edhe përgjatë vitit 2022 ka vijuar ndryshimi i strukturës së pajtimtarëve, ku vihet re ulje e numrit të pajtimtarëve me parapagim (68% nga 72% që ishte në vitin 2021), e cila tregon për tendencën e shkuarjes drejt shërbimeve me kontratë (paspagim), praktikë e cila gjendet e aplikuar gjerësisht në vendet e rajonit dhe BE-së.

4.2.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

111. Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë nga 2018 deri në 2022, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban edhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe konsumin mesatar të internetit për pajtimtarët mobile aktivë.

Tabela 7: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numëri), Data (GB)

	2018	2019	2020	2021	2022	Ndryshimi 2022/2021
Thirrje dalëse	158	171	168	178	154	-13%
Thirrje të marra	161	177	174	182	157	-14%
MOU	319	348	342	360	311	-14%
SMS Dalese	31	30	21	18	17	-4%
Trafik Data (GB)	2.60	3.20	3.91	6.39	7.30	14%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP. Përpunimi AKEP

112. Gjatë vitit 2022, një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht 154 minuta thirrje dalëse në muaj, ka dërguar 17 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 7.3 GB në internet *broadband*. Faktori kryesor që ndikon në mesataren e SMS-ve është rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT. Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

4.2.3 Të ardhurat dhe investimet nga sipërmarrësit e tregut celular

113. Të ardhurat totale të shërbimeve mobile për vitin 2022 ishin rreth 25.4 miliardë lekë, që përbën një rritje me rreth 4% nga viti 2021, vit në të cilin të ardhurat ishin rreth 24.5 miliardë, duke qenë viti i parë me përmirësim të të ardhurave, pas një rënie të theksuar dhe të vazhdueshme gjatë viteve pararendëse. Rritjen më të madhe në të ardhurat vjetore përgjatë vitit 2022 e ka shënuar One Telecommunications me rreth 7%, ndjekur nga Vodafone Albania me një rritje prej 4%, ndërsa Altelecom ka rënie me 4%.


Figura 6: Pjesët e tregut sipas të ardhurave totale nga komunikimet elektronike mobile 2016-2022



Burimi: Të dhëna të depozituara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

114. Nga raportimet e kryera gjatë vitit 2022, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile raportuan rritje të të ardhurave me rreth 4% krahasuar me vitin 2021. Në rritjen e të ardhurave totale të tregut, peshën kryesore e ka pasur rritja e të ardhurave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve me pakicë të cilët u rritën me rreth 10% krahasuar me periudhën pararendëse, sikundër të ardhurat me shumicë kanë pësuar rënie me rreth 11% krahasuar me vitin 2021.
115. Tkurrja e ndjeshme e të ardhurave me shumicë ka ardhur kryesisht për shkak të rënies së madhe të trafikut hyrës ndërkombëtar i cili ka trend rënës në vijimësi. Por, nëse krahason të dhënat e raportuara në segmentin kohor 2016-2022, rezulton se në fund të vitit 2022 kemi reduktim të volumit të këtij trafiku me rreth 60% nëse krahasohet me volumin e këtij trafiku në 2016 dhe rrjedhimisht edhe i të ardhurave nga terminimi i këtyre thirrjeve (rreth 6.6 miliardë lekë), duke ndikuar negativisht edhe në nivelet dhe normat e fitimit të operatorëve celularë.


Figura 7: Të ardhurat nga shërbimet me pakicë dhe shumicë të rrjetëve celulare 2016-2022 (miliardë lekë)



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP. Përpunimi DTMRR.

116. Siç vërehet në grafikun sa më sipër, të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë kanë pësuar rënie përgjatë gjithë periudhës së paraqitur, por rënia më e theksuar ka qenë gjatë viteve 2017 dhe 2018. Sikundër gjatë periudhës së dhënë grafikisht, vërehet se të ardhurat nga shërbimet e pakicës kanë shënuar rritje të lehtë vit pas viti.
117. Për sa i përket treguesve të rezultatit financiar neto vjetor, për vitin 2022 të tre sipërmarrësit kanë raportuar rezultat financiar negativ, respektivisht Vodafone Albania me rreth 258 milionë lekë humbje, që shënon një përmirësim nga humbja në vitin e kaluar, One Telecommunications ka raportuar humbje në vlerën 559 milionë lekë, ndryshe nga rezultati pozitiv i vitit të mëparshëm. Sipërmarrësi Albtelcom për vitin 2022 ka raportuar rezultat financiar negativ me rreth 12 miliardë lekë, duke thelluar më shumë humbjen që raportonte për vitin 2021. Fitimet në norma të ulëta dhe negative, ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme mundësinë e operatorëve për të rritur investimet dhe për të përmirësuar teknologjitë në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për konsumatorët fundorë.
118. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e investimeve të katër sipërmarrësve në infrastrukturë të rrjeteve celulare (nuk përfshihen shpenzimet për licenca/autorizime) në periudhën 2018-2022.

Figura 8: Ecuria e Investimeve të sipërmarrëseve në rrjete celulare 2018-2022



Burimi: Të dhënat e operatorëve të deklaruar në AKEP. Përpunimi DTMRR.

119. Megjithëse në vlerë më të ulët se në vitin 2021, edhe përgjatë vitit 2022 kanë vijuar investimet në rrjetet e ofrimit të shërbimeve celulare, ku vërehet se gjatë këtij viti janë investuar më shumë se 2.5 miliardë lekë. Rreth 74% e vlerës së investimeve të raportuara kanë shkuar në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së ofrimit *broadband* nga rrjetet celulare, gjë e cila reflektohet edhe në përmirësimin e mbulimit me rrjet 3G dhe 4G, si rezultat edhe të volumit të internetit të konsumuar.

4.2.4 Treguesit e ARPU dhe ARPM

120. Treguesit e ARPU¹⁶ (Average Revenue Per User / E ardhura Mesatare Për Përdorues) dhe ARPM¹⁷ (Average revenue Per Minute / E Ardhura Mesatare Për Minutë) masin të ardhurat mesatare të operatorëve për përdorues dhe për minutë, por që njëkohësisht mund të interpretohen si shpenzime mesatare të përdoruesve celularë, dhe për këtë arsye përdoren edhe si tregues agregate të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare. Në prezencë të përdorimit të lartë të paketave/ofertave dhe shportave të integruara të shërbimeve me sasi të mëdha shërbimesh të përfshira në pagesat fikse, për përdorues me parapagim dhe me kontratë, ARPM dhe ARPU janë tregues të mirë të tarifave dhe shpenzimeve mesatare efektive që paguajnë realisht përdoruesit celularë.
121. ARPM matet si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin mesatar të përdoruesve gjatë periudhës përkatëse dhe përdoret si përafrues i çmimit që një përdorues celular paguan mesatarisht për një minutë thirrje telefonike. ARPU e matur si raporti i të ardhurave nga shërbimet me pakicë të operatorëve me numrin mesatar të përdoruesve (aktivë) gjatë një viti dhe tregon sa lekë shpenzon mesatarisht një përdorues celular për shërbime celulare në vit apo në muaj.

¹⁶ ARPU (Average Revenue Per User) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin total të përdoruesve aktivë dhe tregon të ardhurat mesatare vjetore të sipërmarrësit për një përdorues.

¹⁷ ARPM (Average revenue Per Minute) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me sasinë e minutave dalëse dhe tregon të ardhurat e sipërmarrësit për një minutë.

Tabela 8: Ecuria e ARPM dhe ARPU 2017-2022

Vitet	ARPM (Lekë/Minutë)	ARPU (Lekë/përdorues)	ARPU (Euro/përdorues)	ARPM Ndryshimi vjetor (%)	ARPU Ndryshimi vjetor (%)
2017	2.60	5,091	38	3%	7%
2018	2.89	6,482	51	11%	27%
2019	3.33	7,024	57	15%	8%
2020	3.13	6,365	51	-6%	-9%
2021	3.05	6,526	54	-3%	3%
2022	3.75	6,802	57	23%	4%

Shënim: Vlerat janë pa TVSH

122. Nga tabela e mësipërme vërehet se vlera e ARPU ka tendencë rritje nga viti 2017 deri në vitin 2019, duke u pasur nga një rënie e ndjeshme përgjatë vitit 2020 dhe qëndrueshmëri për dy vitet pasuese. Për vitin 2022 ARPM ishte 3.75 lekë/minutë ose 23% më shumë se viti i mëparshëm, ndërkohë që ARPU ishte 6,802 lekë/përdorues ose 4% më shumë se në vitin 2021.

123. Duke marrë në konsideratë se gjithnjë e më shumë ofrimi i shërbimeve mobile po ofrohet në paketa me përmbajta të kombinuar (minuta, sms dhe internet), ARPU është tregues më domethënës në vlerësimin e të ardhurave nga përdoruesit. ARPU në vitin 2022 në Shqipëri ishte rreth 57.18 euro/vit, që është më e ulët se ARPU mesatare vjetore e BE-së rreth 173 euro/vit, pra rreth 3 herë më e lartë se ARPU mobile në Shqipëri.

4.2.5 Indeksi i përqendrimit të tregut për treguesit kryesorë të tregut mobile

Pjesët e tregut të operatorëve celularë për treguesit kryesorë në periudhën 2018 - 2022¹⁹ së bashku me indeksin HHI²⁰ të përqendrimit, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela 9: Pjesët e tregut të operatorëve celularë 2018-2022

		One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	HHI
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2018	34%	50%	15%	3,954
	2019	33%	50%	17%	3,883
	2020	37%	47%	16%	3,833

¹⁸ Me kurs të mesatarizuar për vitin 2022.

¹⁹ Në lidhje me pjesët e tregut, mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur në tabela, për shkak të rrumbullakimeve.

²⁰ HHI (Herfindahl-Hirschman Index), i matur si shuma e katrorëve të pjesëve të tregut të gjithë lojtarëve të tregut. Tregjet me tregues përqendrimi nën vlerën 1,500 konsiderohen si tregje konkurrues, tregjet me tregues përqendrimi HHI midis 1,500 - 2,500 konsiderohen si tregje me përqendrim të moderuar, ndërsa tregjet me tregues 2,500 ose më shumë, vlerësohen si tregje me përqendrim të lartë (konkurrueshmëri e ulët).

	2021	40%	44%	16%	3,811
	2022	38%	49%	13%	4,034
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2018	37%	47%	16%	3,842
	2019	36%	48%	16%	3,849
	2020	37%	47%	16%	3,829
	2021	39%	45%	15%	3,834
	2022	40%	47%	13%	3,988
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)	2018	37%	47%	16%	3,842
	2019	32%	53%	16%	4,018
	2020	36%	49%	15%	3,928
	2021	40%	45%	15%	3,859
	2022	39%	48%	13%	3,994
Thirrje dalëse	2018	35%	52%	13%	4,093
	2019	34%	53%	13%	4,112
	2020	34%	53%	13%	4,166
	2021	39%	50%	11%	4,151
	2022	41%	49%	10%	4,196
SMS dalëse	2018	27%	61%	12%	4,602
	2019	26%	60%	14%	4,483
	2020	26%	60%	14%	4,464
	2021	28%	58%	14%	4,340
	2022	40%	49%	12%	4,085
Trafiku të dhëna (Gbyte)	2018	26%	55%	19%	4,086
	2019	24%	59%	16%	4,113
	2020	23%	64%	13%	4,675
	2021	32%	56%	12%	4,201
	2022	34%	57%	9%	4,405
Të ardhura totale nga komunikimet	2018	32%	54%	14%	4,137
	2019	31%	54%	14%	4,149
	2020	34%	53%	13%	4,129
	2021	35%	52%	13%	4,110
	2022	36%	52%	12%	4,155

Të ardhura retail	2018	32%	55%	14%	4,173
	2019	31%	55%	14%	4,156
	2020	33%	54%	14%	4,139
	2021	35%	53%	12%	4,178
	2022	35%	53%	11%	4,230

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP. Përpunimi AKEP

124. Nga të dhënat e paraqitura sa më sipër, evidentohet se sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut, pothuajse për të gjitha treguesit e marrë në analizë, është Vodafone Albania, dhe pjesët e tregut për këtë operator kanë qenë në nivele pothuajse të qëndrueshme me luhatje të lehta nga njëri vit në tjetrin. One Telecommunications është sipërmarrësi i dytë me pjesën më të madhe të tregut për treguesit respektivë, dhe vërehet se veçanërisht përgjatë viteve 2021 – 2022 ka shënuar rritje të pjesëve të tregut.
125. Indeksi i HHI është në nivele mbi 3,800 për të gjithë treguesit e marrë në analizë, gjë e cila sipas përcaktimeve të këtij indeksi, tregon se ndodhemi në një treg me përqendrim shumë të lartë. Rritje e indeksit HHI për treguesit e marrë në analizë veçanërisht ka qenë e theksuar pas daljes nga ky treg të operatorit Plus Communications në fund të vitit 2017.

4.2.6 Pesha e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare

126. Tabelat e mëposhtme paraqesin peshën e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celularë në vitet 2018-2022, peshën e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në të ardhurat totale nga terminimi, dhe peshën e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve kombëtare në totalin e të ardhurave të operatorëve celularë (retail plus wholesale) në vitet 2018-2022.

Tabela 10: Pesha e thirrjeve hyrëse (minutave) ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara të operatorëve celularë 2018-2022

	One Telecommunication	Vodafone Albania	Albtelecom	Total
2018	3%	10%	2%	6%
2019	3%	15%	2%	8%
2020	2%	15%	1%	8%
2021	2%	10%	1%	5%
2022	2%	10%	2%	5%

Tabela 11: Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave të operatorëve 2018-2022

	One Telecommunication	Vodafone Albania	Albtelecom	Total
2018	12%	17%	10%	15%

2019	11%	16%	11%	13%
2020	7%	16%	8%	12%
2021	7%	13%	10%	10%
2022	7%	12%	9%	10%

127. Nga tabelat e mësipërme për tre operatorët, vihet re se pesha e të ardhurave nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare për vitin 2022 në totalin e të ardhurave totale të tregut mobile zë rreth 12% të tregut për Vodafone, rreth 7% për One Telecommunications dhe rreth 9% për Albtelecom. Nga krahasimi me vitet e mëparshme, pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare ka pësuar rënie të vazhdueshme për të tre sipërmarrësit.

128. Në tabelat e mëposhtme AKEP ka pasqyruar të ardhurat mesatare për 1 minutë nga terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, si dhe të ardhurat mesatare për 1 minutë nga terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare së bashku. Të dhënat janë në lekë/minutë pa TVSH.

Tabela 12: Të ardhura mesatare për minutë MTR ndërkombëtar 2018-2022

	One Telecommunication	Vodafone Albania	Albtelecom	Total
2018				
2019				
2020				
2021				
2022				

Tabela 13: Të ardhura mesatare për minutë nga terminimi kombëtar dhe ndërkombëtar 2018-2022

	One Telecommunication	Vodafone Albania	Albtelecom	Total
2018				
2019				
2020				
2021				
2022				

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorë, përpunimi AKEP.


129. Nga të dhënat e tabelës vihet re se MTR mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) ka ardhur në rënie, ndikuar kryesisht nga rënia e volumit të minutave të komunikimit për thirrjet ndërkombëtare.

4.3 Masat rregullatore *on-net/off-net*

130. AKEP, me vendimin nr.2522, datë 6.11.2014 ka vendosur “*Miratimin e Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregut me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme - Dokumenti Përfundimtar*”. Me Vendimet 2523, 2524, 2525, 2526 janë shpallur FNT në tregjet e terminimit të thirrjeve të katër operatorët dhe janë miratuar tarifave të terminimit të thirrjeve (me asimetri në favor të Plus) ndërkohë që në të njëjtat vendime është shtuar edhe detyrimi për *on-net* vs *off-net* i cili, në fakt, i referohet problematikës në tregjet celulare me pakicë dhe është marrë si një masë rregullatore.
131. Masa e mosdiskriminimit *on-net* vs *off-net* është ndërmarrë në vitin 2014 në kushtet e tarifave të larta të terminimit të thirrjeve nga një rrjet drejt një tjetër rrjeti celular që nxiste efektin ‘club’ të favorizimit të thirrjeve brenda rrjetit, duke avantazhuar operatorët me pjesë të madhe tregu dhe penalizonte për thirrjet jashtë rrjetit (operatorët me pjesë më të vogla tregu). Këto masa janë akoma në fuqi.
132. Një ndër faktorët kryesorë që është marrë në konsideratë nga AKEP për vendosjen e detyrimit të mosdiskriminimit të thirrjeve *on-net* vs *off-net* ka qenë pjesa e tregut e operatorëve, ku potencialisht operatorët me pjesën e tregut më të madhe shfrytëzojnë bazën më të gjerë të pajtimtarëve, duke ju ofruar incentiva në kohë komunikimi brenda rrjetit me çmime preferenciale. Nga periudha në të cilën është vendosur kjo masë rregullatore situata e operatorëve të këtij tregu ka ndryshuar qenësisht, ku nga katër operatorë mobile tashmë në treg kemi vetëm dy, One Albania dhe Vodafone Albania, pjesët e tregut të të cilëve janë të përafërta për sa i përket numrit të pajtimtarëve.
133. Vendimet e Autoritetit të Konkurrencës nr. 679, datë 14.2.2020, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, dhe nr. 680, datë 14.2.2020, “Për marrjen e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare”, kanë dëshmuar se ligji material për mbrojtjen e konkurrencës është i mjaftueshëm për të adresuar për zgjidhje problemet e konkurrencës në tregjet me pakicë të shërbimeve celulare.
134. Qasja e AKEP-it drejt uljes së vazhdueshme të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare nëpërmjet metodës *benchmark* të tarifave të terminimit të BE/BEREC, dhe së fundmi, nëpërmjet ndërtimit të modelit të kostove BULRIC dhe orientimit në kosto të tarifave të terminimit bazuar në rezultatet e këtij modeli duke i reduktuar më tej këto tarifa, pritet të sjellë përfitime për konsumatorët dhe të ulë ndjeshëm incentivat për efektin ‘club’ brenda rrjeteve celulare. Kjo ulje e mëtejshme e tarifave të terminimit sipas *glide path* të

përcaktuar me modelin BULRIC bëhet akoma më e rëndësishme në kushtet e reja në të cilat ndodhet tashmë tregu i telefonisë celulare me kalimin nga tre në dy operatorë, dhe me një rritje të përqendrimit në treg.

Figura 9: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit (2013-2022)



Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorët, përpunimi AKEP

135. Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2022 ishte rreth 5 miliardë minuta, e cila përbën një rënie me 10% në krahasim me vitin 2021 (5.6 miliardë minuta). Rezulton që gjatë vitit 2022, rreth 42% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë *off-net* dhe rreth 56% brenda rrjetit *on-net*, duke shënuar rritje me rreth 1pp nga viti i kaluar për *on-net* dhe rënie me 2pp për *off-net* krahasuar me vitin 2021.
136. Nga të dhënat vihen re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve *off-net* (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (*on-net*). Pesha e thirrjeve *off-net* është rritur nga 5% në vitin 2013 dhe ka arritur në 42% në vitin 2022. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve *on-net* është reduktuar nga 93% në vitin 2013 në 56% në vitin 2022. Struktura e thirrjeve *on-net* përkundrajt atyre *off-net* ka qenë e qëndrueshme përgjatë viteve 2018 – 2022, duke tentuar drejt peshave të përafërta.
137. Për sa më lart, AKEP vlerëson se kjo masë e ka dhënë efektin e saj në përputhje me qëllimin e vendosur dhe si i tillë AKEP gjykon që kjo masë të tërhiqet në referencë me parashikimet e nenit 36 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar. Arsyet e propozimit për tërheqjen e kësaj mase rregullore ndër të tjera argumentohen nga faktorët si:
- struktura e re e tregut me dy operatorë mobile;
 - mungesa e stimuljeve të nevojshëm për aplikim të tarifave grabitqare për krijimin e grupeve të mbyllura;

- c. ulja e volumit të thirrjeve *voice* ndikuar nga rritja gjithnjë e më e madhe nëpërmjet aplikacioneve OTT, të cilat gjithnjë e më shumë ofrojnë shërbim thirrjesh (audio, video, sms) me cilësi në rritje;
- d. struktura e thirrjeve e balancuar për një periudhë relativisht të gjatë, etj.

4.4 Zhvillimet nga 2023 dhe në vijim si dhe këndvështrimi në të ardhmen (Forward looking)

138. Viti 2023 shënon vitin e parë pas ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare, në të cilin aktualisht ofrojnë rrjete/shërbime përkatëse dy ofertues, pas transaksionit të ndodhur në fund të vitit 2022, duke e ulur numrin e operatorëve nga tre në dy për herë të parë që nga viti 2008, pas bashkimit të Albtelecom dhe One nën kontrollin e 4iG.
139. Ilustrimi statistikor në këtë fazë mbetet i kufizuar, pasi mbetet një vlerësim vetëm për disa tregues në dimensione të kufizuara për tre mujorin e parë të 2023, sipas statistikave të raportuara nga dy rrjetet përkatëse, ku konkretisht mund të evidentohet se:
- Numrit total i pajtimtarëve të shërbimeve celulare (karta SIM) ka shënuar një rritje të lehtë me rreth 1% gjatë tremujorit të parë 2023, ndërkohë numri i pajtimtarëve aktivë mobile ka shënuar një rënie të lehtë me rreth 0.6%, rënie më të ndjeshme rreth 5% e ka shënuar numri i pajtimtarëve aktivë me akses *broadband*.
 - Numri i pajtimtarëve me karta SIM përgjatë T1-2023 është pothuajse i barabartë për të dy operatorët One Albania dhe Vodafone, ndërkohë ky raport në T4-2022 qëndronte përkatësisht 51% me 49%.
 - Për sa i përket numrit të përdoruesve aktivë, Vodafone Albania ka shënuar një rritje me rreth 1% krahasuar me tremujorin pararendës, ndërkohë operatori i bashkuar One ka shënuar rënie me rreth 2%. Pjesët e tregut përgjatë T3-2023 paraqiten rreth 52% One dhe 48% Vodafone.
 - Lidhur me numrin e përdoruesve me akses *broadband mobile* vërehet se ka pasur një rënie me rreth 5.6% krahasuar me tremujorin pararendës, ku ndikimin më të madh e ka pasur rënia në pjesën e përdoruesve të One me rreth 10%, ndërsa Vodafone është pothuajse në të njëjtin nivel si tremujori pararendës (-0.5%). Kjo rënie e ONE, ka bërë që pjesa totale e tregut për këtë zë e Vodafone të shkojë nga 48% në T4-2022 në 51% në T1-2023.
140. Edhe pse në tregjet e telefonisë celulare, faktori “përqendrim tregu” rezulton pothuajse në të gjitha rastet në vlera të larta, ky faktor duhet marrë me rezervë kur bëhet vlerësimi i konkurrueshmërisë për produkte/shërbime të ofruara, për vetë faktin se në ndryshim nga tregje të tjera të rrjeteve/shërbimeve të mundësuar, këto tregje karakterizohen nga numër i kufizuar ofruesish. Përbën tregues pozitiv fakti që këto tregje funksionojnë në kushte të liberalizimit të tyre, pavarësisht faktit që janë të bazuara në burime të fundme si “frekuencat” dhe “numeracioni”, gjë e cila nënkupton që tregu do të ketë numër të kufizuar ofertuesish.
141. Por pavarësisht sa sipër, në kushtet kur ekziston mundësia e ofrimit të shërbimeve nga MVNO/MVO, prezenca ose mungesa e tyre në tregun e shërbimeve celulare do të përbënte

një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e konkurrueshmërisë në rastet kur kemi numër të kufizuar të aktorëve në treg, me qëllim shmangien e pasojave negative që mund të sjellë situata duopol. Aktet ligjore dhe nënligjore që monitorojnë sjelljen e aktorëve të tregut marrin një rol parësor në situatën duopol të krijuar, si dhe në rritjen e rolit të bashkëpunimit ndërmjet AKEP dhe AK, pavarësisht specifikave të ndryshme në rolin monitorues të ndërhyrjeve *ex-ante* dhe *ex-post*. Në të gjitha rrethanat mbetet e një rëndësie parësore rritja e peshës rregullatore të fushës për ndërhyrje *ex-ante*, pasi situata duopol krijon angazhim më të madh në monitorimin e tregut përkatës pas transaksionit të ndodhur dhe kalimit të tregut nga *tre* në *dy* ofrues mobile. Pothuajse të gjitha praktikatat e ndërhyrjeve rregullatore të fushës në tregjet e nivelit të pakicës për kontroll dhe rregullim tarifash, kryesisht ilustrohen me rastet e situatave duopol në tregjet përkatëse, dhe vetëm në raste të rralla mundet të ekzistojnë ndërhyrje *ex-ante* në tregjet e nivelit të pakicës kur tregu ka më shumë se dy aktorë ndërveprues në ofrim rrjete/shërbimesh përkatëse në telefoninë celulare.

142. Adresimi i problematikës së mundshme në tregjet e natyrës duopol, pra për tregjet e nivelit të pakicës tek Autoriteti i Konkurrencës, si ndërhyrje e cila mbështetet ligjërisht në rolin *ex-post* në një masë të konsiderueshme, duhet vlerësuar si ndërhyrje në një pistë të veçantë e ndryshme nga qëllimi i ndërhyrjeve *ex-ante* të rregullatorit të fushës AKEP. Praktikatat më të mira ndërkombëtare të rregullimit të tregjeve të shërbimeve celulare janë të fokusuar në ndërhyrje në tregje të shumicës, me qëllim transferimin e konkurrueshmërisë në vertikalitet në tregjet e pakicës të shërbimeve celulare. Por efekti i ndërhyrjeve *ex-ante* në rastin e situatës aktuale në Shqipëri varet shumë edhe nga faza në të cilën ndodhen implementimi i masave rregullatore *ex-ante* dhe efektet e pritshme të tyre, një ndër masat rregullatore kryesore e përdorur nga ndërhyrjet *ex-ante* është rregullimi i tarifës së terminimit (MTR). Në procesin e rregullimit të ndjekur ndër vite nga AKEP, duke filluar nga viti 2006 e në vijim për rregullimin e shërbimit të terminimit janë përdorur metoda të ndryshme të rregullimit të saj dhe aktualisht MTR është drejt orientimit të saj në koston efiçente të ofrimit të këtij shërbimi, rrjedhimisht efektet e pritshme që mund të krijonte kjo masë rregullatore janë pothuajse të papërfillshme. Autoriteti i Konkurrencës në fushëveprimin e tij që synon mbrojtjen e konkurrencës, kryesisht nënkupton ndëshkimin e marrëveshjeve të ndaluara, domethënë në rastet kur sipërmarrës të ndryshëm apo bashkime sipërmarrësish vendosin për të fiksuar çmimet ose për të ndarë tregjet, pra kontrolli i tregut në vendosjen dhe fiksimin e çmimeve të cilat cenojnë interesat e konsumatorëve, por efektet të tilla negative në treg janë në fokus në periudhën pasi ka ndodhur cenimi i konkurrueshmërisë dhe i interesit konsumator. Aktualisht tregu i rrjeteve/shërbimeve celulare në Shqipëri zotërohet nga dy operatorë të cilët mund të paraqesin risqe në zhvillimin e konkurrencës, si në rritjen e çmimeve për produktet/shërbimet që ofrojnë duke reduktuar përfitimet e konsumatorit.
143. Roli rregullator i AKEP, në aspektin e monitorimit të tregut celular, nga situata duopol e krijuar do të marrë një rëndësi të veçantë, kryesisht e impaktuar nga faktorë të tillë si:
- Ndërhyrje *ex-ante* në rregullimin e shërbimit të terminimit dhe transmetimi i kufizuar i efektit në tregun celular me pakicë nga reduktimi në vijim i tarifës së terminimit (MTR), e

cila aktualisht ndodhet afër kostos eficiente të ofrimit të këtij shërbimi, pasi është e lidhur ngushtësisht edhe me vlerën e MTR, sepse në kushtet kur MTR ka një vlerë shumë të ulët, efekti që do të vinte do të ishte i papërfillshëm;

- Implementimi i detyrimit të mosdiskriminimit, duke e konsideruar si një masë rregullatore që mbart një rëndësi të veçantë, pasi ndikon në zbehjen e efektit negativ në përcjelljen e dominancës së rrjeteve nga niveli i shumicës (*në terminim*), duke transmetuar efekte negative në tregjet e shërbimeve të nivelit të pakicës dhe për rrjedhojë duke ulur efektin e “setit të masave rregullatore” të vendosura në nivelin e shumicës, përfshirë këtu edhe reduktimin e MTR.
- Në situatën duopol të krijuar ndikojnë edhe një grup faktorësh të tjerë të lidhur me vetëformimin, i cili është karakteristikë thelbësore në rrjetet celulare, dimensionin e bazës së pajtimtarëve, mungesa e MVNO-ve të cilët do të shërbenin si ndërmjetës në ofrimin e shërbimeve që lidhin dy nivelet e tregjeve, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në transferimin e dominancës në tregun e terminimit në nivel shumice tek shërbimet e telefonisë celulare në tregun e pakicës. Mungesa e një “luftë për konkurrencë” në situatën aktuale në Shqipëri, që sjell mungesa e prezencës së MVNO-ve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, krijon lehtësi dhe favore për shtrirjen e efektit negativ nëpërmjet shërbimit të vetë furnizimit, duke u ndjerë të pacenuar në zinxhirin e shpërndarjes së produkteve/shërbimeve në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.
- Politika sektoriale duhet të konsiderojë faktorë të tjerë, me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e stimulimit të mundshëm, të konkretizohen nëpërmjet instrumenteve ligjore në kuadrin e ndryshimeve të legjislacionit në përputhje me direktivat e BE-së, të lidhura me reduktimin e barrierave potenciale që pengojnë hyrjen në treg të ofruesve të shërbimeve mobile. Qoftë edhe në stimulim të prezencës së MVNO-ve për të ndryshuar sjelljen e mundshme të ofrimit të produkteve/shërbimeve nga vetëm dy operatorë të mbetur në këtë treg, duke marrë në konsideratë edhe numrin e popullsisë për të cilën shërbehet, efikasitetin e mekanizmave rregullatore aktive në zhvillimin e konkurrencës dhe përmirësimin e tyre në përshtatje me situatën e krijuar duopol etj.
- Struktura e tregut me një numër të kufizuar lojtarësh, përveç asaj çfarë përcakton teoria ekonomike, edhe në një treg me dy lojtarë mund të impaktojë sjelljen e konkurrueshmërisë, vetëm duke përdorur instrumente rregullues specifike, siç është rasti i ndërhyrjeve periodike *ex-ante* (rasti i Shqipërisë ndërhyrje edhe në tregun me pakicë në vitin 2008). Përdorimi i instrumenteve monitoruese dhe rregulluese bën të mundur reduktimin e efekteve potenciale negative që sjell struktura aktuale duopol, duke e bërë sjelljen e duopolit me ndikimin negativ të papërfillshëm. Me probabilitet të lartë, tregu në situatë ku ka numër të kufizuar lojtarësh mbetet konkurrues, vetëm nëse roli rregullator i fushës AKEP përforcohet në aspektin e ndryshimeve ligjore për ndërhyrjet *ex-ante*, pasi një situatë e tillë, veçanërisht situata duopol në tregun celular, krijon mundësinë e risqeve të reja për prezencën e sjelljeve bashkërenduese ndërmjet ndërmarrjeve në treg në dëm të konkurrencës. Sjelljet bashkërenduese mund të shfaqen kryesisht nëpërmjet strategjive të çmimit dhe rritjes së

dysshemesë së çmimit për të njëjtin shërbim, përfshirë këtu edhe tarifimin e shërbimeve të tjera shtesë që impaktojnë drejtpërdrejtë shërbimin parësor të kontraktuar nga pajtimtari, shërbime të cilat janë jashtë sferës së rregullimit dhe fokusit të ndërhyrjeve *ex-ante* të rregullatorit të fushës.


- Efekti potencial negativ në situatën duopol të krijuar, ndikohet edhe nga faza e maturimit të tregut celular, pasi “beteja e mundshme” për të ndryshuar bazën e pajtimtarëve në një treg të vlerësuar me mungesë rritjeje të bazës së pajtimtarëve, do të fokusohet kryesisht për të njëjtën bazë konsumatore të cilën aktualisht e zotërojnë dy rrjetet. Një faktor që mund të ndikojë në situatë është edhe mungesa potenciale e interesit të kalimit të pajtimtarëve nga një rrjet në tjetrin (portimi), do të minimizohet nëse operatorët celularë do të reduktojnë stimujt e mundshëm për diversifikimin e portofolit të produkteve/shërbimeve dhe nxitjen e novacionit. Një gjë e tillë rrjedhimisht do të orientojë rrjetet në reduktim të kostos që do të adresohet për këtë qëllim, duke impaktuar negativisht edhe zhvillimin e elasticitetit të kërkesës/ofertës në treg, pasi produktet në treg në dy rrjetet ofertuese do jenë të natyrës homogjene, të ngjashme në karakteristika funksionale pa ndonjë diferencë të dukshme nga njëri rrjet tek tjetri.



5. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare

144. Terminimi është një nga shërbimet e interkoneksionit të analizuar në mënyrë periodike nga viti 2006 e në vijim, ndaj si i tillë, edhe në këtë analizë mbart me vete aspekte teorike dhe arsyetime të trajtuara edhe më parë në dokumentet e analizave të sipërcituara, duke mos e konsideruar të nevojshme risjelljen e të njëjtave argumente të trajtuara më parë, ndaj dhe çdo i interesuar mund të referohet në dokumentet e mëparshme të analizave që kanë trajtuar këtë shërbim.

Figura 13: Ecuria e tarifave të MTR 2010 -2022



Burimi: AKEP

145. Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular është një shërbim interkoneksioni i përcaktuar edhe në ofertën referencë të operatorëve celularë, si dhe në Marrëveshjet e Interkoneksionit (MI) të lidhura ndërmjet operatorëve celularë, i cili duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet që sjell aplikimi i shërbimit të portimit të numrit në përputhje me aktet rregullatore të lidhura me këtë shërbim, ndryshimet e përafuara kanë sjellë disa ndryshime në ofertat referencë të interkoneksionit për përkufizimin e termave të terminimit dhe abonent/pajtimtar si më poshtë:

“Shërbimi i Terminimit në rrjetin e operatorit celular X”

Shërbimi nëpërmjet të cilit operatori celular X, në emër të Operatorit Përfitues përcjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit për në një Pikë fundore të Rrjetit të tij në Republikën e Shqipërisë, të identifikuar nëpërmjet numrave të abonentëve/pajtimtarëve të operatori celular X.

“Abonent/pajtimtar i rrjetit operatori celular X”: Abonentët/pajtimtarët që:

Kanë numër celular që i përket serive numerike 06Y xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, numër i cili nuk është portuar në rrjetin e një operatori tjetër, ose

Kanë numër që nuk i përket serive numerike 06Y xx xxxxx të alokuar nga AKEP operatorit celular X, por që është portuar në rrjetin e operatorit celular X.

146. Terminimi i thirrjeve në rrjetet celulare është një shërbim me shumicë, i cili përbën një input të domosdoshëm për operatorët e rrjeteve të tjerë (fikse dhe celulare) që t'u ofrojnë thirrje përdoruesve të rrjetit të vet drejt përdoruesve të një rrjeti celular.
147. Terminimi i thirrjeve në rrjetet e operatorëve celularë në Shqipëri është kryer dhe kryhet nëpërmjet interkoneksionit direkt midis operatorëve, ose nëpërmjet interkoneksionit indirekt, duke bërë tranzitim nëpërmjet rrjeteve të tjera të cilat mundësojnë shërbimin e tranzitimit.

5.1 Përcaktimi i tregut përkatës për terminimin e thirrjeve celulare

148. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale të lëvizshme, është pjesë e listës së tregjeve të miratuara në rregulloren e AKEP nr. 9, datë 17.7.2009 "Për Analizën e Tregut", e ndryshuar. Për këtë arsye AKEP nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të tre kritereve nëse ky treg është treg përkatës i justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante*. Përkufizimi i këtij tregu si treg i justifikueshëm për ndërhyrje *ex-ante* është tashmë një praktike rregullatore e konsoliduar dhe e aplikuar nga të gjithë vendet anëtare dhe kandidatet të BE, si edhe me gjerë.
149. Në të gjitha raundet e Analizave të Tregut celular për terminimin e thirrjeve, AKEP ka përcaktuar tregje përkatëse të veçanta për terminimin e thirrjeve në secilin rrjet celular të operatorëve aktivë në treg në periudhat përkatëse: One Telecommunications (më parë Telekom Albania), Vodafone Albania, Altelecom (viti 2010 e në vijim), dhe Plus Communication (viti 2012 e në vijim).
150. Duke iu referuar dhe rekomandimeve të KE, tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive të rrjeteve celulare: 2G/GSM, 3G-UMTS edhe 4G-LTE, dhe nuk ndikojnë në përkufizimin e tregut përkatës.
151. AKEP në lidhje me përkufizimin e tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë parimin Pala Thirrëse Pagan (CPP-Calling Party Pays) në konkluzionet e arritura në analizat pararendëse. Për këto arsye AKEP edhe gjatë hartimit të këtij dokumenti nuk e konsideron të nevojshme të bëjë një analizë të testit të tre kritereve apo të produkteve/shërbimeve të përfshira në këtë treg, duke konkluduar sa me poshtë:
- *Shërbimi i terminimit të thirrjeve zanore në rrjet celular është një treg i veçantë për secilin operator rrjeti celular aktiv në treg;*
 - *Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve zanore në një rrjet celular përfshin të gjitha llojet e topologjive/teknologjive/standardeve të rrjeteve celulare: GSM, UMTS dhe LTE, pra përfshirë çdo lloj topologjie/teknologjie apo rrjeti celular të mundshëm;*
 - *Terminimi i SMS-ve nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular;*
 - *Dimensioni gjeografik i shërbimit të terminimit në secilin nga rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) është kombëtar, d.m.th., territori i Republikës së Shqipërisë.*
152. Bazuar në Analizat e Tregut deri në vitin 2019, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës, si edhe terminimi i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik, por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve

kombëtare ose ndërkombëtare. Theksojmë se për shkak të natyrës monopoliste që ka tregut i terminimit të thirrjeve, edhe në kushtet e reja në tregun e telefonisë celulare me kalimin nga tre, në dy operatorë, të dy operatorët vazhdojnë të jenë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregjet përkatëse të terminimit.

5.2 Përcaktimi i sipërmarrësve me FNT

153. Përcaktimi i Fuqisë së Ndjeshme në Treg është dhënë në nenin 33, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, ku përcaktohen kriteret kryesore që duhet të merren në konsideratë për analizën për FNT, duke bërë një ndarje për rastet kur në treg dyshohet për një sipërmarrës me FNT, që do të thotë dominancë individuale dhe për raste kur dyshohet për më shumë se një sipërmarrës me FNT apo dominancë e bashkuar, në këtë nen citohet se:

Një sipërmarrës vlerësohet me fuqi të ndjeshme në treg nëse, i vetëm, apo së bashku me të tjerë, zotëron një pozitë të tillë ekonomike, që i mundëson një zgjerim të ndjeshëm, pavarësisht nga konkurrentët, klientët apo përdoruesit fundorë.

154. Bazuar në përcaktimet e nenit 33, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, rregulloren nr.9/2009 e ndryshuar, dhe vlerësimet e tjera të kryera në këtë dokument, AKEP përcakton:

- *Sipërmarrësin One Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm One Albania;*
- *Sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone Albania.*

Sipas ligjit 9918/2008, i ndryshuar, neni 34: *“Nëse AKEP-i përcakton se një ose disa sipërmarrës kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregun përkatës, pra nuk ka konkurrencë efektive, atëherë ai vendos ndaj tyre një, disa ose të gjitha detyrimet e veçanta të nevojshme, të cilësuar në nenet 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45 e 56 të këtij ligji”.*

5.3 Rregullimi i MTR kombëtare

155. Siç është evidentuar në seksionin e Hyrjes, AKEP (më parë ERT) përgjatë viteve 2006-2020 ka përdorur një sërë mënyrash të rregullimit të tarifave në rrjetet celulare:

- i. nëpërmjet procedurave të zgjidhjes se mosmarrëveshjeve duke përcaktuar çmime maksimale për tarifën e terminimit celular;
- ii. nëpërmjet statusit të FNT dhe rregullimit të nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, bazuar:
 - Në nivelet mesatare të tarifave të terminimit në vendet e BE dhe/ose normës së ndryshimit të tyre;
 - Në rezultatet e modelit të kostove BULRAIC + të përgatitur në vitin 2010;
 - Në nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet europiane që kanë aplikuar modelin e kostove Pure BULRAIC, viti 2014 e në vijim;
 - Në përdorimin e reduktimit të përshkallëzuar (*glide path*) për të arritur në nivelin e synuar (*benchmark* ose kosto BULRAIC).

- Gjithashtu, me synim përcaktimin e MTR-ve kombëtare, në vitin 2021 është përgatitur Modeli i kostove BULRIC, si dhe janë publikuar rezultatet e këtij modeli për përcaktimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular.
156. Në analizat e mëparshme të tregut, rregullimi i tarifave të terminimit nga AKEP është kryer nëpërmjet përdorimit të metodologjisë *benchmark*, siç parashikohet në pikën 12 të Rekomandimit të KE i datës 7 maj 2009, ku trajtohet rasti i vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si *benchmark*), por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të mëdha se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër.
 157. Sipas këtij rekomandimi, në pikat 1 dhe 2 parashikohet përcaktimi i tarifave të terminimit sipas kostove të një operatori eficient, të cilat duhet të jenë simetrike, dhe vlerësimi i kostove eficiente bazohet në kostot aktuale dhe përdorimin e një modeli “bottom up” që përdor kostot inkrementale afatgjata (LRIC). Për këtë qëllim, AKEP në vitin 2020 ndërmori projektin me asistencë ndërkombëtare për hartimin dhe zbatimin e modelit të kostove të trafikut në rrjete celulare sipas metodologjisë Long Run Average Incremental Cost (LRAIC) për përcaktimin e kostove të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve sipas rekomandimit të 2009/396/EC (modeli Pure LRIC për terminimin e thirrjeve), si dhe kostove të shërbimeve celulare të tjera me shumicë dhe në vitin 2021, pas kryerjes së këshillimeve publike me operatorët celularë, me anë të vendimeve përkatëse miratoi modelin e kostove BULRIC si dhe publikoi rezultatet e këtij modeli për përcaktimin e tarifave të terminimit për thirrjet kombëtare.
 158. AKEP nëpërmjet vendimeve të Analizës së Tregut në nëntor 2014 rishikoi grafikun e reduktimit të përshkallëzuar (*glide path*) të përcaktuar në mars 2014, duke përshpejtuar arritjen e nivelit benchmark prej 1.48 lekë/minutë për Vodafone Albania, One Telecommunications (më parë Telekom Albania) dhe Albscom. Ndërsa me vendimet e analizës së tregut në tetor 2018 vendosi rishikimin e *glide path* në dy faza me arritjen e nivelit *benchmark* 1.11 lekë/minutë për të tre operatorët celularë.
 159. Detyrimet e vendosura për FNT në analizën e mëparshme të tregut janë përshkruar në këtë dokument të analizës së tregut 2023, përfshirë efektin pozitiv në tregun me pakicë në lidhje me trafikun dhe tarifën e thirrjeve *on-net/off-net*, por edhe mosdhënie efektesh në lidhje me pjesët e tregut, si dhe duke marrë në konsideratë edhe ndryshimet mjaft të rëndësishme në strukturën e tregut të telefonisë celulare me kalimin nga tre operatorë në dy operatorë celularë duke filluar nga data 1 janar 2023: Vodafone Albania dhe One Albania si rezultat i bashkimit me përthithje të dy operatorëve One Telecommunications dhe Albscom.
 160. AKEP vlerëson së këto efekte pozitive kanë ardhur si pasojë e zbatimit të detyrimit të mosdiskriminimit në tarifën *on-net/off-net*, shoqëruar me reduktime të ndjeshme të tarifave të terminimit të operatorëve celularë.

5.4 Metoda e rregullimit të MTR

161. Në përputhje me përcaktimet e nenit 57 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, rregullimi i tarifave bëhet duke zbatuar rregullimin e tyre nëpërmjet metodave të mëposhtme:
 - a) Përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave;

- b) *Korrigjimit të ecurisë së tarifave, duke përcaktuar kushte të tilla si:*
- i) *kufirin maksimal të normës së ndryshimit (rritjes/uljes) të mundshëm të tarifës brenda një periudhe të caktuar kohe;*
 - ii) *raportin maksimal të rritjes së tarifës, që imponohet nga rritja e çmimeve të elementeve përbërës (inputeve), brenda një periudhe kohe të caktuar;*
 - iii) *procedura që do të përdoret për përcaktimin ose llogaritjen e tarifës, përfshirë detyrimin për orientimin në kosto, përcaktimin e kostove eficiente, që mundëson realizimin e një fitimi të arsyeshëm;*
- c) *përcaktimin e një periudhe kohore, në asnjë rast më të gjatë se 12 muaj, gjatë së cilës ndalohet rritja e tarifave mbi nivelin aktual të tyre në një treg përkatës.*

Në rregullimin e tarifës, bazuar në pikën 1 të këtij neni, AKEP-i vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

- c) *praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;*
- d) *tarifat mesatare të vendeve të BE-së;*
- e) *tarifat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;*
- f) *raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;*
- g) *normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.*

Metodat e rregullimit të tarifave mund të jenë të kombinuara.

162. AKEP vlerëson se mënyra më efikase dhe më e mirë për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare është metoda e përcaktimit të nivelit maksimal të tyre, pra sipas pikës1/a të nenit 57, të ligjit 9918/2008. Në lidhje me informacionin që duhet të përdoret për përcaktimin e nivelit maksimal të tarifave të terminimit celular, AKEP ka ndërtuar modelin e kostove për shërbimet mobile që përputhet me karakteristikat e vendit, dhe publikoi rezultatet e modelit BULRIC për kostot e shërbimeve celulare me shumicë, si dhe sugjerimin e konsulentit ndërkombëtar për reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit kombëtar, bazuar në rezultatet e këtij modeli. Për sa vijon, AKEP gjykon se tarifat e terminimit në rrjetet celulare duhet të jenë të orientuara në koston eficiente të ofrimit të përlllogaritura sipas modelit BU me metodologjinë LRIC të ndërtuar nga AKEP (me ndihmën e TERA Consultants), duke marrë në konsideratë Rekomandimin e EC 2009 dhe praktikën më të mirë ndërkombëtare. Rregullimi i tarifave sipas një modeli kostosh është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga ligji 9918/2008, neni 7, pika 1 dhe neni 57, pikat 1/a dhe 2 dhe neni 59.

Projekti dhe Modeli i kostove

163. Në lidhje me zgjedhjen e mësipërme, në dhjetor 2019 AKEP inicioi procedurat e prokurimit publik dhe përzgjedhje bashkimin e operatorëve “AIR Communications sh.p.k.” dhe “Tera Consultants sh.a.”. Objekti i këtij projekti ishte hartimi dhe zbatimi i modelit të kostove të trafikut në rrjete celulare sipas metodologjisë Long Run Average Incremental Cost (LRAIC) për përcaktimin e kostove të interkoneksionit për terminimin e thirrjeve sipas rekomandimit të 2009/396/EC (modeli Pure LRIC për terminimin e thirrjeve), si dhe kostove të shërbimeve celulare të tjera me shumicë. Në përfundim të këtij procesi, AKEP hartoi dokumentin “Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile”

i cili sintetizon edhe komentet e operatorëve dhe rekomandimet e tyre të dhëna gjatë zhvillimit të Këshillimit Publik përkatës.

164. Për llogaritjen e orientimit të tarifave drejt kostove të terminimit të thirrjeve kombëtare (MTR), AKEP gjatë analizave të fundit të terminimit të thirrjeve mobile është mbështetur në metodën e *benchmarking* të vendeve të BEREC, bazuar në modelet e kostove që kanë aplikuar metodën 'Pure LRIC', në përputhje me Rekomandimin e Komisionit Europian të 7 majit 2009, mbi Rregullimin e Tarifave të terminimit në rrjetet fikse dhe ato mobile në BE (2009/396 / KE). Ndërsa kjo qasje ka provuar të jetë një mënyrë efikase për të përcaktuar MTR në Shqipëri, AKEP ka zhvilluar modelin e tij të kostos, në mënyrë që të sigurojë që MTR të pasqyrojë me saktësi kushtet dhe karakteristikat e tregut shqiptar.
165. AKEP, me ndihmën e TERA Consultants ka krijuar një model të rrjetit celular nga poshtë-lartë (Bottom Up) në të cilin karakteristikat kryesore vijuese zbatohen në përputhje me kornizën konceptuale:
- Modeli nga poshtë-lartë, duke marrë në konsideratë qasjen gjeotipe;
 - Dimensionimi i rrjetit bazohet në një qasje të modifikuar *scorched node*;
 - Modelimi i HEO (Operatori Eficient Hipotetik) me një shkallë 33%;
 - Pasuritë e vlerësuara të rrjetit bazuar në koston aktuale;
 - Qasja LRIC+ për të gjitha shërbimet celulare dhe Pure LRIC për shërbimet e rregulluara për terminimin e zërit (sipas rekomandimit të EC);
 - Anuitetet e përlogaritura sipas përjasjes vjetore;
 - Metodatat e kërkuara të alokimit të kapacitetit për kostot e përbashkëta të rrjetit;
 - Alokimi i EPMU për kostot e paatribueshme;
 - Llogaritje e WACC bazuar në qasjen CAPM.

166. Për të zhvilluar këto modele, AKEP mbledhi të dhënat e nevojshme nga tre operatorët përmes dy fazave të proceseve të mbledhjes së të dhënave. Gjatë periudhës maj-qershor 2021 AKEP zhvilloi një Këshillim Publik në lidhje me rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare, duke përfshirë një paraqitje të modelit të kostove me inputet dhe supozimet kryesore, dimensionimin e rrjetit dhe llogaritjet e kostove. Këshillimi përfshinte dhe çështjet e analizës së ndjeshmërisë si dhe përcaktimin e një *glide path*-i të tarifave të terminimit në rrjetet celulare. AKEP, në përfundim të këtij projekti publikoi rezultatet finale të cilat gjenden të detajuara në vendimin e KD të AKEP, nr.10/2021.

167. Bazuar në rezultatet e modelit të kostove, konsulentët e TERA Consulting kanë dhënë rekomandime për implementimin e rezultateve në përcaktimin e tarifave të terminimit për operatorët celulare, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 14: Rezultatet e modelit të kostos për reduktimin e përshkallëzuar të MTR

	2021_	2022_	2023_	2024_
Vodafone Albania/One Albania/Albtelecom	1.11	1.02	0.89	

Orientimi në kosto i tarifave të terminimit nëpërmjet reduktimit të përshkallëzuar

168. Bazuar në përcaktimet e ligjit 9918/2008, rekomandimet e KE dhe praktikën më të mirë në vendet e BE dhe të rajonit, AKEP gjykon se tarifave të terminimit në rrjetet celulare duhet të jenë të orientuara në koston efiçente të ofrimit të përlogaritur sipas modelit BU me metodologjinë LRIC të ndërtuar nga AKEP (me konsulencën e TERA Consultants).
169. Bazuar në rezultatet dhe rekomandimet e TERA Consultants për tarifave të terminimit në rrjetet celulare sipas rezultateve të modelit BULRIC, AKEP në seksionet në vijim, paraqet vlerësimin për orientimin në kosto të tarifave të terminimit në rrjetet celulare.
170. Në rekomandimet për orientimin në kosto të tarifave të terminimit nga KE dhe BEREC, si dhe nga praktikatat rregullatore në vende të BE, vihet re se orientimi në kosto rekomandohet të kryhet nëpërmjet një reduktimi të përshkallëzuar. Për të kryer një reduktim të tillë *glide path* është një mjet rregullator i përshtatshëm që përdoret nga rregullatorët për reduktimin e çmimeve gjatë një periudhe të shtrirë në kohë, në nivelin e llogaritur drejt koston së orientuar. Në praktikën rregullatore *glide path* janë konsideruar të zakonshme në caktimin e tarifave të orientuara drejt koston, arsye më të zakonshme që lidhen me përdorimin e tyre shoqërohen me nevojën për t'u dhënë kohë operatorëve për të rregulluar gradualisht planet e tyre të biznesit, duke shmangur ndërprerjet e menjëhershme në treg, veçanërisht kur ndryshimi midis MTR ekzistuese dhe MTR të orientuar drejt koston është i lartë.
171. AKEP e konsideron gjithashtu *glide path* si një mjet të rëndësishëm për zbatimin e nivelit të ri të MTR-së zanore të orientuar drejt koston në rastet kur normat mesatare aktuale të terminimit janë dukshëm më të larta se niveli i vlerësuar i koston efiçente.
172. Në këtë drejtim, dy parametra kryesorë sigurojnë një zbatim të qetë të tarifave të reja të orientuara drejt koston:
- ▶ Hendeku midis niveleve të terminimit aktualisht në fuqi në Shqipëri dhe që llogaritet nga modeli i koston;
 - ▶ Kohëzgjatja e zbatimit të *glide path*.
173. Tarifa aktuale e terminimit në Shqipëri është 1.11 lekë/minutë, ndërsa modeli vlerëson normat e terminimit zanor prej 0.751 lekë për thirrjet hyrëse kombëtare dhe 0.762 lekë/minutë për thirrjet hyrëse ndërkombëtare, e cila përfaqëson një rënie me rreth 31% / 32%. AKEP konsideron se ky hendek është i rëndësishëm, dhe kërkon zbatimin e një *glide path* për MTR.
174. Kohëzgjatja e *glide path* është një parametër kyç që mundëson zbatimin e tarifave sipas orientimit nga kosto në mënyrë të zbutur: duke pasur parasysh hendekun prej 31% / 32%. *Glide path* janë përdorur gjerësisht në vendet e ndryshme të Evropës në përcaktimin e MTR, kryesisht kur ata filluan të kalonin nga metodat e vjetra të llogaritjes së MTR, në LRIC të pastër, sipas rekomandimit të EC 2009 (kryesisht në periudhën midis 2009 dhe 2013 apo edhe 2015). Së fundmi Komisioni Europian ka përdorur përdorimin e një *glide path* brenda kornizës së niveleve të terminimit të thirrjeve zanore në të gjithë BE.

175. Gjithashtu, në lidhje me asimetrinë, KE rekomandon që tarifat e terminimit duhet të jenë simetrike, pasi sipas parimit të kostove eficiente të një operatori në treg konkurrues, nuk duhet të ketë dallim në koston/tarifën e aplikuar. Me ndryshimet e reja të strukturës së tregut celular në Shqipëri, pas bashkimit të dy operatorëve One Telecommunications dhe Albtelecom, ku që nga data 1 janar 2023, në tregun e telefonisë celulare tashmë operojnë vetëm dy operatorë celularë, vazhdimi i aplikimit të simetrisë së tarifave të terminimit është mëse i justifikueshëm.
176. AKEP, në dokumentin final miratuar me VKD nr.11, datë 16.6.2020, pas Këshillimit Publik mbi Analizën e Tregut të Terminimit të Thirrjeve në Rrjetet Celulare, vendosi ndër të tjera të lërë në fuqi tarifën maksimale të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73, të datës 1.10.2018, në përputhje dhe me objektivat rregullatorë të parashikuara në nenin 7, të ligjit 9918/2008, si dhe rekomandimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit European dhe BEREC.
177. Bazuar në analizën dhe përfundimet e mësipërme, AKEP ka vendosur se në kushtet e publikimit të rezultateve në përfundim të projektit të asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e Modelit të Kostos për Terminimin me shumicë të thirrjeve në rrjetet celulare, të miratuara me vendim të AKEP nr.10, datë 22.7.2021, të përcaktojë tarifat e reja të terminimit me shumicë të thirrjeve kombëtare mbi Modelin e Kostos BULRAIC për të dy operatorët celularë Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a.
- Sipërmarrësi One Albania sh.a., përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular One Albania;
 - Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania.

Duke vlerësuar qëndrimet e operatorëve të rrjeteve celularë gjatë procesit të ndërtimit të modelit të kostove BULRIC, si dhe bazuar në rezultatet e përfundimit të projektit të asistencës teknike për Modelin e Kostove, trajtimin dhe analizën e tregjeve të ofrimit të shërbimeve mobile në këtë dokument AKEP ka vendosur që MTR kombëtare për të dy operatorët të rishikohet sipas tabelës së mëposhtme, nëpërmjet reduktimit të përshkallëzuar *glide path* për zbatimin e ri të MTR kombëtare.

Tabela 15: Afajet dhe tarifat maksimale të vendosura për aplikimin e MTR kombëtare

	1.12.2019	1.10.2024_	1.4.2025_	1.10.2025_
Vodafone Albania/One Albania	1.11	1.02	0.89	0.75

Shënim: Tarifat në lekë/minutë pa TVSH

5.4 Rregullimi/derregullimi i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare

178. Tarifat e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare dhe fikse kanë qenë nën rregullim nga AKEP në periudhën shtator 2008 - shkurt 2012. Rregullimi i tarifës së terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në periudhën e cituar është kryer nga AKEP duke i përcaktuar ato të barabarta me MTR për thirrjet kombëtare.
179. AKEP, me vendimet nr.1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi nxjerrjen nga rregullimi të tarifave të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare me efekte nga data 1.2.2012.
180. Në Analizën e Tregut të vitit 2012, AKEP, me vendimet nr.2119, 2120, 2121 dhe 2122, datë 4.7.2012 kreu derregullimin e plotë të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke e nxjerrë këtë shërbim nga përkufizimi i tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare duke hequr edhe detyrimet e tjera për FNT si dhënie akses, mosdiskriminim dhe transparencë, me efekt nga data 1.9.2012. Ky qëndrim është mbajtur nga AKEP edhe në analizat e tregjeve të radhës të viteve 2014, 2016, 2018. Me anë të Vendimit nr.11, datë 16.6.2020, Këshilli Drejtues i AKEP vendosi të mbajë nën vëzhgim tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare duke e lënë atë të derregulluar.

5.4.1. Praktika e Komisionit European dhe vendeve të rajonit për përcaktimin e tregut përkatës

181. Bazuar në parashikimet e nenit 75 të Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane (EECC), duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 117 të EECC, Komisioni European ka adaptuar një akt për të mbështetur këtë direktivë për vendosjen e një tarife të vetme maksimale për secilin nga shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe ato mobile, të cilat do të vendosen në të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të BE-së.
182. Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtarë (NRAs) pas hyrjes në fuqi të tarifave nuk do të mund të vendosin masa rregullatore për kontrollin e tarifave për shërbimet celulare ose fikse në territorin e tyre kombëtar, por mund të përdorin vetëm instrumentin e masave të palidhura me rregullimin e tarifave/çmimeve (*non-price related obligation on the termination providers*).
183. Në vijim të sa më sipër, KE ka miratuar Rregulloren (*Delegated Regulation*) 2021/654, datë 18.12.2020 "Mbështetje e Direktivës (EU) 2018/1972". Kjo rregullore, ndër të tjera përcakton detyrimin për aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve celulare (MTR) dhe një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve nga rrjetet fikse (FTR) dhe do të jenë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha vendet e Unionit. Për sa i përket thirrjeve të origjinuara nga vendet e tjera dhe të terminuara në vendet e unionin apo anasjelltas thirrjet e origjinuara nga vendet e Unionit dhe të terminuara në vendet e tjera, kjo rregullore parashikon dy skenarë, të cilët bazohen në parimet e reciprocitetit.
- a. Tarifat e rregulluara aplikohen gjithashtu për thirrjet e origjinuara nga një numër i një vendi të tretë (jashtë EU) dhe të terminuara në një numër të një vendi anëtar të Unionit kur plotësohet një nga dy kushtet si më poshtë:
1. Ku ofruesi i shërbimit të terminimit të thirrjeve në një vend të tretë aplikon për thirrjet e origjinuara nga numrat e vendeve të BE-së, tarifa të terminimit celular ose


fiks të njëjta ose më të ulëta se tarifatat maksimale të terminimit të përcaktuara në këtë rregullore për secilin vit dhe çdo vend anëtar, mbi bazën e tarifave të aplikuara ose propozuara nga ofruesit e shërbimit të terminimit në vendet e treta kundrejt ofruesve/operatorëve të shërbimit të terminimit në BE, ose:

2. Kur Komisioni përcakton se, mbi bazën e informacionit të ofruar nga një vend i tretë, tarifatat e terminimit të zërit për thirrjet e origjinuara nga numrat në BE dhe të terminuara drejt numrave të vendeve të treta (jo anëtare) janë të rregulluara në përputhje me parimet ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 75 të Direktivës së BE-së 2018/1972 dhe Aneksi III i saj; dhe që vendi i tretë (jo në BE) është i listuar në këtë Aneks.
 - b. Për thirrjet e origjinuara nga numrat e operatorëve të vendeve të treta (jashtë Unionit) dhe të terminuara në një nga numrat e operatorëve të vendeve të Unionit ose anasjelltas, nëse operatori i vendit të tretë aplikon tarifa të terminimit më të larta se tarifatat e Unionit 'Single maximum Union-Wide voice termination rates' ose kur këto tarifa nuk janë rregulluar në përputhje me parimet e kostove të operatorit eficient, të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 75 dhe Aneksin 3 të EECC, atëherë këto thirrje janë të përjashtuara nga qëllimi i rregullimit të kësaj rregulloreje.
184. Rregullatori Britanik OFCom ka përcaktuar se, për thirrjet që origjinohen nga jashtë vendit, operatorët britanikë nuk duhet të aplikojnë tarifa më të larta se ato të aplikuara nga kundërpala ndërkombëtare për rastet kur këto tarifa janë më të larta se tarifatat kombëtare të aplikuara në Britani.
185. Për sa i përket praktikës së ndjekur në vendet e rajonit (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Serbi), aplikimi për rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile aplikohet vetëm për trafikun e origjinuar brenda vendit, dhe trafiku ndërkombëtare është lënë i parregulluar.

5.4.2. Impakti i terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare

186. Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e trafikut të terminuar në rrjetet celulare sipas origjinës, kombëtare dhe ndërkombëtare, për periudhën 2018-2022 për tre operatorët celularë.


Figura 10: Terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare 2018-2022



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

187. Bazuar në të dhënat e paraqitura sa më sipër, vërehet qartë një rënie e minutave të komunikimit të thirrjeve ndërkombëtare nga viti 2018 në vitin 2022, me përjashtim të sipërmarrësit Vodafone Albania i cili ka pasur rritje të thirrjeve ndërkombëtare të terminuara gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018, por pas vitit 2019 rënia ka qenë e ndjeshme edhe për këtë sipërmarrës.
188. Rënia e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare i atribuohet ndër të tjera edhe rritjes së përdorimit të internetit me anë të telefonave celularë, nëpërmjet të cilit konsumatorët komunikojnë duke përdorur aplikacionet, etj.
189. Për sa i përket terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare, në ndryshim nga ato ndërkombëtare vërehet se sasia e këtyre thirrjeve ka qenë më e qëndrueshme përgjatë këtyre viteve.
190. Figurat e mëposhtme paraqesin ecurinë e të ardhurave me shumicë të operatorëve celularë nga terminimi i thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Pavarësisht reduktimit të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare, të ardhurat nga terminimi i këtyre thirrjeve kombëtare kanë një rritje të ndjeshme në vitet 2015 dhe 2016 për shkak të rritjes së madhe të trafikut *off-net*.


Figura 11: Ecuria e të ardhurave nga terminimi në rrjetet celulare



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

191. Në grafikun sa më sipër është bërë paraqitja e të ardhurave totale nga terminimi i thirrjeve, si edhe krahasimi i të ardhurave të gjeneruara nga shërbimet e terminimit të thirrjeve celulare me shumicë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për të krijuar një panoramë më të plotë të ecurisë së të ardhurave të gjeneruara nga këto shërbime, periodha krahasimore është marrë që nga viti 2014. Siç vërehet, pesha e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në të ardhurat e totale të tregut ka qenë dukshëm më e lartë përgjatë periudhës 2014 – 2016, dhe që pas asaj kohe të ardhurat e gjeneruara nga terminimi kombëtar janë pothuajse në të njëjtin nivel me atë ndërkombëtarë, madje përgjatë viteve 2021 – 2022 ka pasur një tejkalim të tyre.

Figura 12: Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare 2014-2022



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

192. Nga të dhënat e paraqitura në figurën sa më sipër, vërehet se të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare kanë pësuar rënie të ndjeshme, për të gjithë operatorët e tregut aktivë gjatë periudhës përkatëse. Sipërmarrësi me peshën më të madhe në këtë treg është Vodafone, i ndjekur nga ONE, por siç evidentohet, të ardhurat e tyre janë reduktuar ndjeshëm që nga viti 2014.
193. Rënia në të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare ka ardhur edhe si rezultat i largimit të pajtimtarëve nga përdorimi i SMS-ve dhe thirrjeve zanore ndërkombëtare tradicionale duke kaluar te zëvendësuesit OTT (WhatsApp, Viber Messenger, Skype etj.), duke vënë nën presion të ardhurat e sipërmarrësve nga thirrjet ndërkombëtare.

194. Të ardhurat nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare mobile përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash me shumicë për operatorët dhe janë të lidhura ngushtë me trafikun hyrës ndërkombëtar, si edhe tarifës që operatorët aplikojnë për këto thirrje që arrin deri në 30 eurocent/minutë apo 40 lekë/minutë, që është shumë herë më e lartë (rreth 27 herë) se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare.
195. Nga të dhënat për tre operatorët aktualisht aktiv në treg, deri në vitin 2022, vihet re se:
- a) Pesha e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara është reduktuar ndjeshëm për shkak të rënies së trafikut hyrës ndërkombëtar, por edhe për shkak të rritjes së ndjeshme të trafikut *off-net*;
 - b) Pesha e të ardhurave nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në totalin e të ardhurave nga terminimi ka rënë ndjeshëm përgjatë periudhës së marrë në analizë (figura sa më sipër), ku nga rreth 81% në vitin 2014 ka arritur në rreth 49% në vitin 2022;
 - c) MTR ndërkombëtare gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje krahasuar me vitet 2019 – 2021, periudhë gjatë të cilës ka qenë në nivelet më të ulëta, megjithatë, MTR e vitit 2022 (20.47 lekë/minutë) është më e ulët se ajo e viteve 2015 – 2018. Edhe treguesi mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) për vitin 2022 është 2.19 lekë/minutë, gati dyfish më i lartë se MTR kombëtar (1.11 lekë/minutë).

5.4.3 Argumente kundër rregullimit të MTR ndërkombëtare

196. AKEP ka qenë transparent në argumentet e dhëna në rastet e rregullimit dhe derregullimit të tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, duke analizuar avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej alternativave, sa kohë edhe në vendet e BE dhe jashtë saj ka qasje të ndryshme për këtë problematikë.
197. AKEP ka konsultuar çdo dokument të analizës së tregjeve me palët e interesuara, kryesisht operatorët e rrjeteve celulare dhe sipërmarrësit e autorizuar për terminimin/tranzitimin e thirrjeve ndërkombëtare duke i pasqyruar të plota komentet e tyre dhe duke bërë transparente vendimmarrjen e vet.
198. AKEP, në dokumentin “Analizë e Tregut Celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe akses/origjinimit - *Dokumenti Përfundimtar*”, miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr.2118, datë 4.7.2012, e ka trajtuar në një seksion të veçantë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare hyrëse. AKEP, bazuar edhe në komentet e operatorëve si dhe në informacionin nga vendet e rajonit në raportin e mars 2012 të Cullen International, në të cilin evidentohet që terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të mos jetë pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse në një rrjet celular, pra që shërbimi ku operatori është me FNT të përfshijë vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare, dhe se dhënia e aksesit dhe tarifa e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në një rrjet celular është objekt i negociatave komerciale midis palëve, ku në të gjitha vendet e rajonit tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare përcaktohen në marrëveshje kondifenciale dhe janë jashtë rregullimit. Në bazë të këtij përfundimi, AKEP, në vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të operatorëve celularë, ka hequr detyrimet e operatorëve celularë për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare.
199. Gjithashtu, në dokumentin e Analizës së Tregut të vitit 2014, miratuar me VKD nr.2522, datë 6.11.2014, AKEP ka sqaruar se në vijim të përfundimeve të Analizës së Tregut 2012, tregu përkatës i terminimit përfshin vetëm terminimin e thirrjeve kombëtare. Në Analizën e Tregut

Celular, të miratuar me VKD nr. 2118, datë 4.7.2012, AKEP ka përfshirë një seksion të veçantë (Seksioni III.3.III) për diskutimin në lidhje me detyrimet për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, duke përfshirë dhe kronologjinë e derregullimit të këtij shërbimi. Në këtë dokument AKEP përcaktoi që terminimi i thirrjeve ndërkombëtare në një rrjet celular nuk është pjesë e tregut përkatës të terminimit të thirrjeve në rrjet celular, pra statusi me FNT dhe gjithë detyrimet e tjera për FNT për terminimin e thirrjeve janë të zbatueshme vetëm për terminimin e thirrjeve hyrëse kombëtare. AKEP arriti në këtë përfundim pas procesit të Këshillimit Publik të Analizës së Tregut, ku dhe Neofone ka qenë pjesëmarrës në proces me komente, dhe ndër argumentet pro derregullimit ishte dhe fakti se terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është input për tregjet me pakicë në vendet e huaja dhe jo në Shqipëri, pra që nuk kanë ndikim në tregun vendas. AKEP gjykojti ndër të tjera se alternativa e duhur për derregullimin ishte alternativa 'c' e pyetjes 5 të Këshillimit Publik: Detyrimet e operatorëve me FNT për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare duhet të derregullohen plotësisht: operatorët celularë të mos kenë detyrim të japin akses, pra dhënia e aksesit dhe tarifa të jenë komerciale kur kanë interes të dy palët.

200. Disa argumente pro që mbështesin vendimet dhe qëndrimet e AKEP për derregullimin e këtij tregu janë:
- Reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet celulare ka mundësi të mos transmetohet në reduktime të tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, por vetëm shkon si fitim i tepërt për tranzituesit apo operatorët origjinues;
 - Reduktimi i cilësisë së thirrjeve në rrjetet celulare apo edhe fikse për shkak të përdorimit në masë të madhe të VoIP me cilësi jo të lartë;
 - Efekte negative të konsiderueshme direkt në të ardhurat e operatorëve celularë dhe indirekt në buxhetin e shtetit, por edhe në tarifatat me pakicë të shërbimeve celulare (*waterbed effect*);
 - Efekte negative në mundësinë e operatorëve për të investuar në rrjete dhe teknologji të avancuara si rezultat i rënies së të ardhurave (një pjesë e konsiderueshme e të cilave vjen nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare);
 - Aplikimi nga operatorët e vendeve të tjera apo i *carrierave* ndërkombëtare të tarifave të terminimit për thirrje ndërkombëtare më të larta se terminimi për thirrjet kombëtare dhe më të larta se terminimi në Shqipëri;
 - Derregullimi i këtij shërbimi në shumë vende të BE-së për thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga jashtë EU/EEA në vitet e fundit.
201. Një faktor tjetër në favor të derregullimit të tarifës dhe të aksesit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare është trajtimi nga Komisioni Europian (KE) i *roaming*-ut ndërkombëtar. KE bazuar në problemet e tarifave të larta të *roaming*-ut për thirrjet dhe të dhënat për përdoruesit, ka vendosur nënregullim tarifave të *roaming*-ut ndërkombëtar (me pakicë dhe me shumicë) në vendet e BE, duke imponuar tarifa maksimale (çmime tavan) për operatorët në vendet e BE, por vetëm në marrëdhëniet midis operatorëve të vendeve të BE: tarifatat e *roaming*-ut që operatorët e vendeve të BE i paguajnë njëri-tjetrit janë nënregullim, por tarifatat që paguajnë operatorët jashtë vendeve të BE operatorëve të vendeve të BE për *roaming* ndërkombëtar nuk janë nënregullim. Pra, vetë KE ka bërë një ndarje midis vendeve të BE dhe jo të BE, pasi masat e marra kanë impakt për përdoruesit në vendet e BE.
202. AKEP, në lidhje me çështjen e përcaktimit të tregut të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka përcaktuar si treg më vete thirrjet e origjinuara në Republikën e Shqipërisë

(thirrjet kombëtare), pra terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk përfshihet si pjesë e këtij tregu përkatës. Në Analizat e Tregut të Telefonisë Celulare 2016 - 2018, AKEP ka vlerësuar se nuk është e nevojshme të kryhen ndryshime në përcaktimin e tregut përkatës, pasi kjo zgjidhje është analizuar më parë nga AKEP dhe është pranuar tashmë nga tregu. Gjithashtu, edhe në vendet e BE-së tendenca e viteve të fundit tregon se shumë vende anëtare të BE-së kanë filluar të trajtojnë në mënyrë të ndryshme terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare të origjinuara nga vendet anëtare të BE dhe EEA (European Economic Area) dhe thirrjet hyrëse ndërkombëtare të origjinuara nga vendet e tjera. Sipas informacionit të publikuar nga Cullen International, deri në dhjetor 2017, në 22 nga 32 vende evropiane, rregullimi i terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare nuk përfshin thirrjet ndërkombëtare të origjinuara jashtë zonës EU/EEA, dhe në disa vende aplikohet vetëm rregullimi i terminimit të thirrjeve kombëtare (Dokumenti “Analiza e Tregut të Telefonisë Celulare”, VKD nr.11, datë 22.2.2018). Edhe në vendimin e Analizës së Tregut të vitit 2020 AKEP, pas këshillimit publik dhe marrjes së mendimeve të operatorëve për këtë çështje, vendosi të mbajë nën vëzhgim tregun e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare duke e lënë të derregulluar.

203. Një argument tjetër mbështetës për arsyetimin e AKEP për përcaktimin si dy tregje të ndara për terminimin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare është edhe arsyetimi i mungesës së kompetencës ligjore për të ndikuar në politikat e rregullimit të vendeve jashtë Republikës së Shqipërisë. Shembull: Nëse AKEP i përcakton njësoj të dy tregjet e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare dhe nëpërmjet këtij përcaktimi detyron operatorët vendas të rregullojnë edhe tarifat e terminimit ndërkombëtar duke i ulur ato, kjo do të rezultonte vetëm në ulje të të ardhurave të terminimit ndërkombëtar për operatorët që operojnë brenda Republikës së Shqipërisë (si rrjedhim, më pak të ardhura në buxhet dhe potencialisht “waterbed effect”), ndërkohë që operatorët të cilët operojnë jashtë territorit të RSH dhe që kryejnë trafik të thirrjeve me operatorët në RSH do të vazhdonin të operonin mbi bazën e kushteve rregullatore të aplikuara sipas vendit të origjinës, pra nuk do t’i ndryshonin tarifat. Pra, palë të dëmtuar do të rezultonin operatorët vendas dhe, si rezultat, të ardhurat në buxhetin e shtetit (pakësim) dhe konsumatorët shqiptar si përdorues fundor të këtyre shërbimeve.

5.4.4. Argumente pro rregullimit të MTR për thirrjet ndërkombëtare

204. Në dokumentin e nxjerrë për Këshillim Publik, AKEP ka dhënë një përmbledhje të argumenteve (PRO) që mbështesin rregullimin edhe të tarifave të terminimit ndërkombëtar, si dhe më pas disa argumente (KUNDËR) që kundërshtojnë këtë qëndrim dhe rregullim, argumente të parashtruara kryesisht nga operatorët celularë.
- *Operatori është monopolist në ofrimin e terminimit të thirrjeve në rrjetin e vet, përfshirë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare;*
 - *Detyrimet për mosdiskriminim dhe orientim në kosto;*
 - *Në treg konkurrues dhe të liberalizuar tarifat e terminimit nuk kanë dallim nga origjina e thirrjeve, për shkak të presioneve që krijon arbitrazhi;*
 - *Rregulla të thjeshtuara për terminimin e thirrjeve;*
 - *Përfitime për konsumatorët vendas dhe të huaj.*
205. Është e qartë se ka një risk që tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare të mos jenë reciproke për shkak të qasjes së ndryshme që përdorin vendet e BE-së dhe ato të rajonit, por

praktikat më të mira sugjerojnë trendin rënës të tarifave të terminimit, Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë me BE-në.

206. Praktika ka treguar se diferencimet e larta mes tarifave të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare me ato kombëtare janë bërë shkak për ofruesit/tranzituesit për të maskuar origjinën e thirrjeve duke manipuluar ose hequr Identifikimin e Thirrjes (CLI). Shembull: Rasti i procedimit administrativ filluar me VKD nr.44, datë 19.6.2018, për “Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.” ku u vendos pranimi i pjesshëm i kërkesës së “Albtelecom sh.a.” “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Albtelecom sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a.”; dhe Vodafone të marrë masat për sa parashikohet në këtë Vendim, si dhe për minimizimin e mëtejshëm të trafikut të gjeneruar nga CLI brenda një afati prej 2 muajsh nga data e marrjes së këtij Vendimi.
207. Një parim tjetër në favor të rregullimit të tarifave të thirrjeve ndërkombëtare është thjeshtimi i tarifave dhe rregullimit të tregjeve të ndryshme gjeografike në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, ndërsa nuk imponon më shumë ngarkesë rregullatore sesa duhet. Diferencat e larta (1 euro cent vs 27-30 euro cent) për terminimin e një minutë thirrje në rrjetet celulare mes thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare kanë krijuar diferencime në trajtimin e marrëdhënieve mes operatorëve të rrjeteve celulare dhe sipërmarrësve që ofrojnë terminimin e thirrjeve ndërkombëtare. Ndërkohë që për një pjesë të konsiderueshme të sipërmarrësve të autorizuar nga AKEP ky shërbim nuk ofrohet (refuzim aksesi) nga operatorët e rrjeteve celulare me argumentin se tregu është i derregulluar nga AKEP.
208. Një tjetër faktor që duhet pasur parasysh është gjithashtu dhe procesi i Roaming Rajonal (Western Balkan Roaming), për heqjen e çmimeve të shërbimeve *roaming* për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme. Nga data 1 korrik 2021 ka hyrë në fuqi modeli i plotë i RLAH midis të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina), dhe tarifa e terminimit ndërkombëtar e lidhur me *roaming* është përcaktuar nën rregullim sipas një *glide path*-i në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes Rajonale. Për këtë qëllim, Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr.107/2018, datë 20.12.2018, vendosi që në ligjin datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet shtesa:
Në nenin 55, pika 2, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:
“c) shërbimet e *roaming*-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime”.
209. Gjatë vitit 2018 Shqipëria, në kuadër të proceseve integruese në Bashkimin Europian, është bërë pjesë e iniciativës për uljen e tarifave të *roaming* në vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina). Ky proces synon uljen e tarifave të shërbimeve *roaming* sipas modelit RLAH (*Roam Like At Home*) i aplikuar tashmë në vendet e BE.
210. Me datë 6 dhjetor 2022 u mbajt në Tiranë takimi BE - Ballkani Perëndimor, ku nga ana e një sërë operatorësh të telefonisë celulare të BE dhe Ballkanit Perëndimor u nënshkrua deklarata e përbashkët për reduktimin e tarifave të shërbimit *roaming* midis operatorëve celularë të BE-së dhe atyre të Ballkanit Perëndimor, e cila në thelb synon që duke filluar nga data 1 tetor

2023 operatorët celularë të angazhohen në uljen graduale të tarifave *roaming* midis vendeve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor deri në zerim të tyre.

211. Procesi i reduktimit të tarifave për shërbimet *roaming* midis BE dhe BP, vjen si vazhdimësi e zbatimit me sukses të modelit të zerimit të tarifave *roaming* midis gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilëve, duke filluar nga data 1 korrik 2021, udhëtojnë në këto vende dhe komunikojnë në *roaming* njësoj si në shtëpi (RLAH).
212. Një dokument i rëndësishëm është edhe Akti i miratuar nga Komisioni Europian “Delegated Regulation 2021/654²¹” i cili ka përcaktuar një tarifë unike maksimale të terminimit për thirrjet e terminimit fiks dhe celular në vendet e BE-së. Kjo rregullore, ndër të tjera përcakton detyrimin për aplikimin e një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve celulare dhe një tarife të vetme për terminimin e thirrjeve nga rrjetet fikse dhe do të jenë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha vendet e unionit.
213. Për sa i përket thirrjeve të origjinuara nga vendet e tjera dhe të terminuara në vendet e unionit apo anasjelltas, thirrjet e origjinuara nga vendet e unionit dhe të terminuara në vendet e tjera, kjo rregullore parashikon dy skenarë, të cilët bazohen në parimet e reciprocitetit.
- a. Tarifat e rregulluara aplikohen gjithashtu për thirrjet e origjinuara nga një numër i një vendi të tretë (jashtë BE) dhe të terminuara në një numër të një vendi anëtar të unionit kur plotësohet një nga dy kushtet si me poshtë:
- ✓ *Kur ofruesi i shërbimit të terminimit të thirrjeve në një vend të tretë aplikon për thirrjet e origjinuara nga numrat e vendeve të BE-së, tarifa të terminimit celular ose fiks të njëjta ose me të ulëta se tarifat maksimale të terminimit të përcaktuara në këtë rregullore, për secilin vit dhe çdo vend anëtar, mbi bazën e tarifave të aplikuara ose propozuara nga ofruesit e shërbimit të terminimit në vendet e treta kundrejt ofruesve/operatorëve të shërbimit të terminimit në BE; ose:*
 - ✓ *Kur Komisioni përcakton se, mbi bazën e informacionit të ofruar nga një vend i tretë, tarifat e terminimit të thirrjeve zanore për thirrjet e origjinuara nga numrat në BE dhe të terminuara drejt numrave të vendeve të treta (jo anëtare) janë të rregulluara në përputhje me parimet ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 75 të Direktivës së BE-së 2018/1972 dhe Aneksi III i saj; dhe që vendi i tretë (jo në BE) është i listuar në këtë Aneks.*
- b. Për thirrjet e origjinuara nga numrat e operatorëve të vendeve të treta (jashtë unionit) dhe të terminuara në një nga numrat e operatorëve të vendeve të unionit ose anasjelltas, nëse operatori i vendit të tretë aplikon tarifa të terminimit më të larta se tarifat e unionit ‘*Single maximum Union-wide voice termination rates*’ ose kur këto tarifa nuk janë rregulluar në përputhje me parimet e kostove të operatorit eficient, të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në nenin 75 dhe Aneksin 3 të EECC, atëherë këto thirrje janë të përjashtuara nga qëllimi i rregullimit të kësaj rregulloreje.

²¹ *Commission Delegated Regulation (EU) 2021/654 of 18 December 2020 supplementing Directive (EU) 2018/1972 of the European Parliament and of the Council by setting a single maximum Union-wide mobile voice termination rate and a single maximum Union-wide fixed voice termination rate.*

214. Bazuar në parimet e njëjta me ato të përcaktuara në nenin 75 dhe aneks III të EECC, Komisioni, në bazë të informacionit të paraqitur nga ai vend i tretë dhe pas një vlerësimi të duhur, mund ta përfshijë atë vend në listën e vendosur në Shtojcën e Rregullores së Deleguar, për të cilin do të zbatohen tarifat e terminimit.

5.4.5 Konkluzione mbi terminimin e thirrjeve ndërkombëtare

215. AKEP e mbështet veprimtarinë e tij në promovimin e konkurrencës efektive në tregjet e komunikimeve elektronike dhe mbrojtjen e konsumatorit. Këto parime janë në përputhje me direktivat e BE-së në fushën e komunikimeve elektronike që përfshijnë promovimin e konkurrencës në sigurimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik:

- a. promovimin e interesave të të gjithë konsumatorëve;
- b. inkurajimin e sigurimit të aksesit në rrjet dhe ndërveprimin të shërbimit në masën që konsiderohet e përshtatshme për qëllimin e sigurimit:
 - i) efikasitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme;
 - ii) investime eficiente dhe inovacion;
 - iii) përfitimi maksimal për klientët e ofruesve të komunikimit.

216. Pas përfundimit të projektit për ndërtimin e modelit të kostos BULRIC për shërbimet celulare dhe publikimit të rezultateve të modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare, miratuar me vendimin nr.10, datë 22.7.2021, nga përlllogaritjet ka rezultuar se për terminimin e thirrjeve celulare, ky shërbim ka afërsisht të njëjtën kosto pavarësisht origjinës së thirrjes (kombëtare apo ndërkombëtare). Gjithashtu, Komisioni Europian miratoi Rregulloren e Deleguar 2021/654 për aplikimin e një tarife të njëjtë terminimi në të gjitha vendet e zonës ekonomike të përbashkët të Evropës. Duke filluar nga data 1.7.2021 në të gjithë vendet e zonës ekonomike të përbashkët të Evropës (EEA) aplikohet e njëjta tarifë terminimi, e cila pritet të jetë 0.2 Eurocent/minutë për thirrjet në rrjetet celulare dhe 0.07 Eurocent/minutë për thirrjet e terminimit në rrjetet fikse.

217. Referuar analizave pararendëse të tregut, aplikimit të një tarife të njëjtë terminimi celularë në të gjitha vendet e zonës ekonomike të përbashkët të Evropës nga Komisioni Evropian, implementimit të RLAH midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, AKEP në dokumentin e përgatitur për Këshillim Publik parashtroi alternativat për rregullimin e mëtejshëm apo mosrregullimin e thirrjeve ndërkombëtare apo marrëdhënieve midis operatorëve për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare:

1. *Përfshirja e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare), shpalljen FNT të të tre operatorëve dhe rregullimin e tarifave në mënyrë proporcionale me balancat in-out nga terminimi thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare:*
 - a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy llojeve thirrjeve (menjëherë ose me *glide path*);
 - b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
2. *Me përkufizim si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje ex-ante dhe FNT:*

- a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me *glide path*);
 - b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesit dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
3. *Aplikimin e një reduktimi të veçantë nëpërmjet glide path edhe për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare duke synuar në afat mesëm orientimin drejt MTR kombëtar;*
 4. *Lënie në derregullim siç është aktualisht.*
218. Reduktimi i tarifës së terminimit në rrjetet celulare ka mundësi të mos transmetohet në reduktime të tarifave të thirrjeve drejt Shqipërisë, por vetëm shkon si fitim i tepërt për tranzituesit apo operatorët origjinues;
219. Efekte negative të konsiderueshme direkt në të ardhurat e operatoreve celularë dhe indirekt në buxhetin e shtetit, por edhe në tarifën me pakicë të shërbimeve celulare (*waterbed effect*), duke çuar në efekte negative në mundësinë e operatorëve për të investuar në rrjete dhe teknologji të avancuara si rezultat i rënies së të ardhurave (një pjesë e konsiderueshme e të cilave vjen nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare);
220. Një argument mbështetës për arsyetimin e AKEP për përcaktimin si dy tregje të ndara për terminimin e thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare është edhe arsyetimi i mungesës së kompetencës ligjore për të ndikuar në politikën e rregullimit të vendeve jashtë Republikës së Shqipërisë.
221. Një faktor tjetër në favor të derregullimit të tarifës dhe të aksesit për thirrjet hyrëse ndërkombëtare është trajtimi nga Komisioni Evropian (KE) i *roaming*-ut ndërkombëtar. KE bazuar në problemet e tarifave të larta të *roaming*-ut për thirrjet dhe të dhënat për përdoruesit, ka vendosur nënregullim tarifave të *roaming*-ut ndërkombëtar (me pakicë dhe me shumicë) në vendet e BE, duke imponuar tarifën maksimale (çmime tavan) për operatorët në vendet e BE, por vetëm në marrëdhëniet midis operatorëve të vendeve të BE: tarifën e *roaming*-ut që operatorët e vendeve të BE i paguajnë njëri-tjetrit janë nënregullim, por tarifën që paguajnë operatorët jashtë vendeve të BE operatorëve të vendeve të BE për *roaming* ndërkombëtar nuk janë nënregullim. Pra, vetë KE ka bërë një ndarje midis vendeve të BE dhe jo të BE, pasi masat e marra kanë impakt për përdoruesit në vendet e BE.
222. **AKEP pas përfundimit të procesit të Këshillimit Publik, duke konsideruar faktorët “pro dhe kundër” të referuar në dokumentin e Analizës për Shërbimin e Terminimit të Thirrjeve Mobile, karakteristikat dhe rrethanat kombëtare, qasjen e Komisionit Evropian për mosrregullimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare nga dhe drejt vendeve të treta (jashtë BE-së), vlerëson lënien në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare siç është aktualisht, deri në fazën e ardhshme të Analizës së Tregut ku do të analizohet edhe mundësia për të orientuar tarifën drejt një euro tarifë të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në Shqipëri, njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së në tregjet e terminimit.**

ANEKS 1. KOMENTET E PALËVE DHE QËNDRIMI AKEP

AKEP me VKD nr.16, datë 16.11.2023 miratoi publikimin e dokumentit “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) - Këshillim Publik*”. Dokumenti u publikua në faqen e Internetit të AKEP²² dhe Këshillimi Publik u krye për një periudhë 60 ditore, më 16.11.2023 – 16.1.2024.

Në përfundim të Këshillimit Publik në AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si vijon:

- Vodafone Albania sh.a., me shkresën LEA/001/LR, JL, datë 8.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/7 prot., datë 12.1.2024);
- One Albania sh.a., me shkresën nr.108 prot., datë 15.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/8 prot., datë 15.1.2024);
- Neofone sh.p.k., me shkresën nr.380 Prot., datë 12.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/9 prot., datë 16.1.2024);
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr.41/2 Prot., datë 16.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/10 prot., datë 22.1.2024).

AKEP i falënderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces Këshillimi Publik për komentet dhe sugjerimet e dhëna për dokumentin e nxjerrë për Këshillim Publik.

Aneksi më poshtë përmban komentet e dërguara nga palët e interesuara dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet: Për orientim dokumenti më poshtë është strukturuar në këtë mënyrë:

- pyetjet e hartuar nga AKEP në Këshillim Publik;
- aspektet kryesore të komenteve të sjella mbi këto pyetje, si dhe
- qëndrimin e mbajtur nga AKEP për komentet përkatëse.

• **Komente të përgjithshme dhe qëndrimi AKEP**

Kjo pjesë përmban komentet e dhëna nga palët e interesuara në vija të përgjithshme për dokumentin, dhe jo në mënyrë specifike për pyetjet e Këshillimit Publik, si dhe qëndrimi i AKEP për komentet e përgjithshme.

• **Komentet sipas pyetjeve të Këshillimit Publik dhe qëndrimi i AKEP**

Kjo pjesë përmban komentet e palëve të interesuara sipas pyetjeve të Këshillimit Publik dhe qëndrimi i AKEP për komentet për çdo pyetje.

²² <https://akep.al/wp-content/uploads/2023/11/Keshillim-publik-Dokumenti-Analiza-e-tregut-te-terminimit-te-thirrjeve.pdf>

I. Komente të përgjithshme dhe qëndrimi i AKEP

Autoriteti i Konkurrencës:

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës është shprehur me vendimin nr.1048, datë 16.1.2024 “Për dhënien e disa rekomandimeve Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin për Këshillim Publik “*Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)*””.

Komisioni i Konkurrencës në vendimin e sipërcituar, duke ju referuar dokumentit të nxjerrë për Këshillim Publik ka parashtruar një panoramë të përgjithshme të ecurisë së tregut të shërbimeve celulare, proces në përfundim të të cilit ka vendosur t’i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:

- i. Në kushtet e ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu;
- ii. Për përcaktimin e tarifave të terminimit të implementojë metodologjinë e vende të BE duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos.

Qëndrimi i AKEP

Bashkëpunimi ndërmjet AKEP dhe AK është një praktikë e mirë e ndërtuar ndër vite, e cila mbështetet në përcaktimet e ligjit nr.9918 dt. 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar (*nenit 38-të*), sipas të cilit AKEP-i duhet të bashkëpunojë me Autoritetin e Konkurrencës, por edhe nga mirëkuptimi ndërinstitucional i formalizuar nga Memorandum Mirëkuptimi në vitin 2007, si dhe rishikimi i tij në vitin 2018. Në këtë aspekt AKEP, periodikisht i ka kërkuar AK të shprehë opinionin e vet në lidhje me dokumentet e nxjerrë në Këshillim Publik, duke qenë i përfshirë me komente/opinione/rekomandime përkatëse mbi konstatimet dhe gjetjet në dokumentet e konsultuara.

- Mbi rekomandimin përkatës të AK, për pikën (i) sqarojmë se:

AKEP synon rregullimin e tregjeve në nivel të shumicës, sipas përcaktimeve të Kapitullit VI-të të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në funksion të arritjes së objektivave rregullatore mbi zhvillimin e tregjeve përkatëse, bazuar në praktikat më të mira të vendeve anëtarë të BE dhe BEREC, për përcaktimin e tregjeve që justifikojnë rregullimin, analizën dhe përcaktimin e sipërmarrësve që kanë fuqi të ndjeshme në treg, me qëllim që rregullimi i kryer të impaktojë me rezultate të dëshiruara edhe në shërbimet/produktet e ofruara nga sipërmarrësit në tregjet me pakicë, pa qenë i detyruar AKEP të ndërhyjë direkt në tregjet e pakicës. Ky qëllim synohet të arrihet duke u kujdesur që të konsumohen të gjitha instrumentet ligjore dhe rregullatore të mundshme në tregjet e nivelit me shumicë, për të mos pasur sjellje strategjike antikonkurrese apo diferencime të ndryshme të cilat do të bënin të nevojshme ndërhyrjen në tregun me pakicë. Masat rregullatore në tregjet e nivelit të shumicës që përdoren nga AKEP justifikojnë ndërhyrjet *ex-ante*, duke

konsideruar edhe mundësinë e inicimit të rasteve për ndërhyrje *ex-post* nga AK, rast pas rasti të shfaqur, për të cilat justifikohen ndërhyrje të tilla. Në këtë kuptim, bazuar në përcaktimet e pikës 4, të nenit 34, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar, përcaktimi i tregjeve, analiza e tyre si dhe përcaktimi i sipërmarrësve që kanë fuqi të ndjeshme në treg, në tregjet përkatëse të analizuara, bëhet nga AKEP-i në mënyrë periodike, sipas listës së tregjeve përkatëse në përputhje me përcaktimet e Rregullores nr. 9, datë 17.7.2009, “Për Analizën e Tregut”, e ndryshuar. Lista e tregjeve nën rregullim ka në përbërje të saj kryesisht tregje të përcaktuara për rregullim nga Rekomandimet dhe Direktivat e BE-së, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e analizimit të tregjeve të cilat përfshihen në tregun e komunikimeve elektronike për rrethana specifike kombëtare.

- Mbi rekomandimin për pikën (ii) “Për përcaktimin e tarifave të terminimit të implementojë metodologjinë e vende të BE duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos”, sqarojmë së:

AKEP ndodhet në një fazë më të avancuar se rekomandimi i dhënë, pasi aktualisht përdor rezultatet e kostove eficiente të shërbimit përkatës për përcaktimin e tarifës së terminimit, rezultate të cilat janë përfituar në vitin 2021 nga modeli i kostove BULRIC, miratuar me Vendimin nr.3, datë 1.4.2021 të Këshilli Drejtues të AKEP për miratimin e dokumentit “*Modeli i referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile*”. Gjithashtu, me Vendimin nr.10, datë 22.7.2021 për “*Miratimin e dokumentit – Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare*”, AKEP miratoi dhe publikoi rezultatet e modelit të kostove të pastra mesatare të LRIC për tarifën e terminimit për periudhën 2022 - 2024. Përdorimi i kostove eficiente për ofrimin e shërbimit të terminimit për përcaktimin e tarifave përkatëse, duke marrë në konsideratë rrethanat dhe karakteristikat e tregut vendas përbën zgjedhjen e parë për çdo rregullator në rast se posedohen rezultate të tilla dhe AKEP aktualisht ka propozuar rregullimin bazuar në këto rezultate.

Pavarësisht sa më sipër, AKEP do të vijojë bashkëpunimin dhe evidentimin e rasteve të dyshuara për praktika të pandershme në tregjet e nivelit të pakicës, duke i adresuar ato tek Autoriteti i Konkurrencës për vlerësime dhe hetime të thelluara, dhe referimin e tyre për ndërhyrje sipas fushës dhe përgjegjësisë përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, nenit 38 dhe nenit 61 ku specifikohet se: *AKEP-i, me nismën e vet, ose nëpërmjet njoftimit nga sipërmarrës të tjerë apo palë të tjera të interesuara, gjykon se sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg po abuzon me pozitën e tij, e parashtron rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.*

Komentet e Vodafone Albania

Vodafone Albania me anë të shkresës LEA/001/LR, JL datë 8.1.2024 (referencë AKEP nr.2024/7 prot., datë 12.1.2024) ka paraqitur komentet për Dokumentin e Këshillimit Publik “*Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)*”.

Nga pikëpamja e kontekstit Vodafone Albania shprehet se:

- Analiza zhvillohet në një strukturë tregu të telefonisë së lëvizshme tashmë të stabilizuar, ku pas dinamikave të 4 viteve të fundit, struktura e tregut ka ndryshuar rrënjësisht nga 4 në 3 operatorë dhe rishtazi në dy operatorë mobile. Kjo panoramë e qëndrueshme ofron një bazë të dhënash të sakta, të përditësuara dhe të besueshme mbi situatën dhe projektimet e ardhshme, që do të shërbejë për analiza që i përkojnë situatës aktuale, që i mundësojnë AKEP-it të marrë vendimet e duhura për rregullim apo derregullim të tij.
- Analiza e MTR-ve vjen pas një hendeku kohor 5-vjeçar që nga analizat e fundit të vitit 2018. Kjo periudhë është karakterizuar nga ndryshime strukturore të tregut lokal, ndryshimet dinamike në sjelljen konsumatore drejt përdorimit nga zgjedhje alternative si zgjedhje e parë e platformave OTT përkundrejt shërbimeve tradicionale të telekomunikimit voice dhe sms. Për këto arsye, sipas Vodafone Albania studimi duhet të kryhet në formë holistike se çfarë impakti do të sjellë ndryshimi i MTR në shëndetin e industrisë dhe në aftësinë e saj për të mbështetur investime serioze e të qëndrueshme në drejtim të përmirësimit të eksperiencës së klientit dhe aksesit të popullatës në teknologjinë inovative.

Nga pikëpamja përmbajtësore Vodafone Albania e gjen dokumentin të mirëstrukturuar dhe ezaurues në problematikat që synon të trajtojë, por duke sjellë në vëmendjen e AKEP disa elementë për t'u pasur në konsideratë:

- Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave të përdorura janë të vitit 2019 ku tregu operonte me 3 operatorë të papërditësuara, dhe si rrjedhojë të papërshtatshme, që bazohen kryesisht në të dhëna të vitit 2018-2019. Sipas Vodafone, shumica e të dhënave tabelare i referohen një periudhe kohore ku tregu operonte me 3 operatorë. Në një pjesë të konsiderueshme të Dokumentit referohen të dhëna të kryera nga Studimi i Konsulentit Terra i kryer në vitin 2019, me të dhëna të mbledhura gjatë viteve 2015-2019, të cilat Vodafone i konsideron të vjetra, të papërshtatshme dhe nuk pasqyrojnë panoramën e tregut të konsoliduar në dy operatorë që nga viti 2023.

Vodafone Albania shprehet se Analizat e Tregut duhet të zhvillohen mbi të dhëna të sakta dhe të përditësuara që reflektojnë drejt pjesët takuese të secilit operator, të ardhurat, numrin e pajtimtarëve, etj. Kjo do të bënte të mundur që analizat të pasqyrojnë qartë peizazhin aktual të industrisë, për rrjedhojë, marrjen e masave të duhura rregullatore në funksion të konkurrencës së lirë, të ndershme dhe në dobi të gjithë aktorëve të tregut.

- Sipas Vodafone, referencat krahasuese me vendet e BE-së nuk janë relevante për Shqipërinë. Dokumenti nuk përmban një analizë të mirëfilltë të treguesve statistikorë të tregut, por bën një analizë krahasimore të zhvillimeve historike të tregut në vend dhe në BE, duke marrë shembuj dhe praktika *benchmark*, të cilat nuk kanë asnjë relevancë për tregun e telekomunikacionit në Shqipëri, i cili ka specifikat e veta unike për nga struktura e tregut me dy lojtarë dhe sjellja konsumatore. Sipas vlerësimit të Vodafone, dokumenti duhet të paraqesë një analizë të mirëfilltë të treguesve statistikorë të tregut vendas, bazuar në parimet dhe udhëzimet e fundit të BE-së, lidhur me rolin e Rregullatorëve dhe

kompetencat e tyre për të ndërhyrë në treg nëpërmjet masave rregullore. Më tej Vodafone shprehet se qasja e BE-së po shkon gjithnjë e më shumë drejt vetërregullimit të tregut dhe ndërhyrjes vetëm kur është absolutisht e nevojshme në kushtet e një tregu jofunksional e me konkurrencë të deformuar, duke u reflektuar edhe nga heqja e disa tregjeve nga lista e tregjeve që janë të justifikuar për ndërhyrje.

- Vodafone vlerëson se studimi është mjaft i zgjeruar në disa aspekte të adresuara tashmë, si p.sh.: çështjet që kanë të bëjnë me tarifat e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, të ezazuara në konsultimet e mëparshme, ndërkohë që duke marrë parasysh rëndësinë, diskutimi duhet të ketë në fokus të veçantë tarifat e terminimit kombëtar.

Qëndrimi i AKEP

AKEP konstaton se komentet e natyrës së përgjithshme të Vodafone Albania, pa objektiv specifik në pjesën kryesore të tyre, mbi të dhënat e përdorura nga AKEP, përfshirja apo jo e Altelecom në segmentin kohor të analizuar, duke marrë si situatë faktike statusin aktual me dy operatorë, apo referencat e *benchmark* për çështje tashmë të trajtuara, konsiderimin apo jo tregjeve të cilat sipas Vodafone vendet e BE-së po “*orientohen drejt vetërregullimit dhe ndërhyrjes vetëm kur është absolutisht e nevojshme në kushtet e një tregu jofunksional e me konkurrencë të deformuar*” etj., nuk reflektojnë komente të natyrës unitare të aspekteve të trajtuara në dokumentin e këshilluar me palët, sepse:

- Analizat për ndërhyrje *ex-ante* përveç referencës me strukturimin e tregut dhe evidentimin e ndryshimeve të ndodhura në segmentin kohor që referohet analiza përkatëse, gjë e cila nuk mund të shmangte konsiderimin e Altelecom pasi ka qenë operator aktiv deri në fillim të vitit 2023, evidentimi i evoluimit të tregut mbi statistika reale të raportuara dhe të publikuara periodikisht nga AKEP, ndër të tjera synojnë të paraqesin pamjen reale të tregut, por edhe të konsiderojnë në këndvështrimin “*forward looking*” të pritshmërive që mund të sjellë tregu celular në afat shkurtër apo afat mesëm;
- Procesi i Analizës pararendëse të terminimit të thirrjeve mobile është zhvilluar përgjatë periudhës 2019 – 2020 (shiko paragrafët 8 dhe 9 fq.6), dhe dokumenti përfundimtar “*Mbi përfundimet e arritura pas përfundimit të Këshillimit Publik të dokumentit: “Analizë tregu i telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”*”, së bashku me vendimet përkatëse janë miratuar me datë 16.6.2020. Me anë të Vendimit nr.11/2020, Këshilli Drejtues i AKEP shpalli sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare tre operatorët Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom, dhe vendosi të mbajë tarifën maksimale 1.11 lekë/minutë për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare sipas *benchmarkut* Pure LRIC të BEREC, deri në përfundim të projektit në zbatim të asistencës teknike për Modelin e Kostove dhe analizën e radhës së tregjeve përkatëse;
- Të dhënat statistikore të përdorura në dokumentin e nxjerrë për Këshillim Publik mbulojnë në mënyrë tërësore të gjithë periudhën e marrë në analizë deri në fund të vitit 2022, dhe paraqesin situatën kronologjike të ecurisë së treguesve të analizuar;

- Analiza e tregut te terminimit ka fizionominë e saj në trajtimin e këtij shërbimi monopol për të gjitha rrjetet ofruese të këtij shërbimi në këtë treg, dhe si e tillë nuk përbën ndonjë risi as për AKEP (*tregje të analizuar pothuajse çdo dy vite që nga viti 2006 e në vijim nga AKEP*), njëlloj siç janë dhe praktikatat e ngjashme në të gjithë vendet e tjera, por diferencë mund të ketë vetëm në aspektin se kur mund të jetë momenti kohor, ku të gjitha vendet do të kenë si MTR një tarifë pothuajse unike dhe e orientuar në koston efiçiente të ofrimit të shërbimit të terminimit. Ndaj në këtë këndvështrim është parashtruar mundësia nga vendet e BE-së për “orientim drejt vetërregullimit dhe ndërhyrjes vetëm kur është absolutisht e nevojshme në kushtet e një tregu jofunksional e me konkurrencë të deformuar”, por Vodafone nuk citon faktin që ky vetërregullim nënkupton që tregjet e terminimit mund të mos jenë të nevojshme të analizohen, sepse kjo nënkupton që do të ketë një çmim tavan për tregjet e terminimit në celular dhe fiks, konkretisht në rrjetet celulare, pra për të aplikuar një euro tarifë të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore duke çuar në një reduktim deri në 0.2 euro cent/minutë, pa specifikuar origjinën e trafikut.

Në këtë këndvështrim AKEP ka referuar edhe një pyetje përkatëse në dokumentin e këshilluar me palët, proces i cili do të konsiderohet në vitet e ardhshme edhe për Shqipërinë njëjtë sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, praktikë e cila konsideron edhe ofrimin e shërbimeve roaming.

Komentet e One Albania

One Albania, me shkresën nr.108 prot., datë 15.1.2024 (referenca e AKEP nr. 2024/8 prot., datë 15.1.2024), ka dërguar komentet e saj për dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”. One Albania ka vlerësuar me kujdes dokumentin e Analizës së Tregut, propozimet e AKEP mbi *glide path*-in e tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare, opsionet e shtrura në lidhje me trafikun ndërkombëtar si dhe analizën përkatëse dhe arsyetimet e përdorura nga Autoriteti për të mbështetur këto propozime.

One Albania komenton se, përveçse ndikimit negativ në të ardhurat e shoqërisë One Albania, duhet që dhe tendencat dhe zhvillimet kryesore në tregun celular, evidentuar dhe nga AKEP në dokumentin e Analizës së Tregut, si: rënia drastike e trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar të terminuar në rrjetet e operatorëve celularë, rritja galopante e përdorimit të të dhënave (data) nga abonentët mobile *broadband*, si dhe ulja vit pas viti e të ardhurave në tregun celular dhe ulja e nivelit të investimeve të kryera, të jenë në fokus të politikave në fushën e komunikimeve elektronike dhe të çdo vendimmarrje të mundshme lidhur me tarifatat e terminimit të thirrjeve kombëtare, *glide path*-in dhe afatet e aplikimit të tyre si dhe me qasjen ndaj regjimit të trafikut ndërkombëtar.

Lidhur me çështjet kryesore të shtrura në dokumentin e analizës, One Albania shprehet:

- i. Reduktimi i tarifës së terminimit të thirrjeve kombëtare (MTR) sipas *glide path*-it të propozuar nga AKEP në dokumentin e Analizës, bazuar në rezultatet e modelit të koston, ndikon negativisht tek operatori ONE Albania nga dy operatorë që ka tregu celular;

ii. Prandaj, ONE Albania duke mirëkuptuar qëllimin e AKEP për përcaktimin e një *glide path*-i për implementimin e tarifës së terminimit të thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar të saj deri në barazimin me koston e shërbimit të terminimit të thirrjeve, kërkon nga AKEP shtyrjen në kohë të aplikimit të *glide path*-it të MTR, duke filluar nga 1.1.2025, dhe zgjerimin me 12 muaj pasi *glide path*-i i propozuar është shumë i shpejtë dhe nuk mundëson kohën e duhur për të përshtatur planet e biznesit dhe për të mitiguar pasojat negative nga ulja e të ardhurave.

iii. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk duhet të përfshihet në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular, për shkak se ky treg gëzon karakteristika të veçanta nga tregu i terminimit të thirrjeve të origjinuara brenda Shqipërisë dhe zona gjeografike e rregullimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Për më tepër ky shërbim është i ndërlidhur me politikat komerciale dhe konkurrencën mes operatorëve respektivë për klientët e tyre në tregjet me pakicë në vendet e huaja jashtë territorit të Shqipërisë, pra pa ndikim në tregun shqiptar.

Për sa i takon referencës në dokumentin e Analizës mbi aplikimin e MTR-së në vendet e BE-së sipas përcaktimeve të Delegated Act, theksojmë se aplikimi i një MTR-je të vetme në mbare Unionin është i përligjur pasi vendet anëtare janë pjesë e një entiteti të vetëm, dhe subjekt i të njëjtave politika ekonomike monetare, etj.

Ndërsa, Shqipëria nuk është ende pjesë e BE-së dhe procesi i anëtarësimit të saj mund të zgjasë me vite, ndaj dhe rregullimi i trafikut ndërkombëtar nuk ka pse të jetë çështje për diskutim për t'u implementuar në Shqipëri. Në rastin tonë, kjo iniciativë përkthehet drejtpërdrejtë në ulje të të ardhurave për sipërmarrësit e tregut celular dhe nuk sjell asnjë përfitim për tregun celular në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Thënë kjo, dhe duke konsideruar që rregullimi i tarifës së terminimit të trafikut ndërkombëtar impakton direkt financat tona, ONE Albania kërkon lënie në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, siç dhe është aktualisht.

iv. Heqja e masës rregullatore *on-net* vs *off-net*

Lidhur me masën rregullatore të mosdiskriminimit *on-net/off-net*, ONE Albania mendon se kjo masë nuk duhet të hiqet, pasi në çdo rast ruan konkurrencën e lirë dhe të ndershme në treg, dhe shmang stimujt për praktika antikonkurruese nga ana e operatorëve, duke kufizuar zgjedhjen e biznesit dhe duke lejuar potencialisht një lojtar të madh të dëmtojë konkurrencën.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP, konstaton se komentet e One Albania janë të lidhura kryesisht në përgjigje të pyetjeve të adresuara, duke qenë se këto çështje janë objekt i pyetjeve të ngritura në Këshillimin Publik të kësaj analize tregu, AKEP në vijim ka shprehur qëndrimin e tij mbi këto çështje sipas pyetjeve të Këshillimit Publik.

Komentet e Neofone

Neofone sh.p.k., me shkresën nr. 380 prot., datë 12.1.2024 (referenca e AKEP nr.2024/9 prot., datë 16.1.2024), ka dërguar komentet e saj për dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”.

Sipërmarrësi Neofone sh.p.k., në komentet e paraqitura mbi dokumentin për Këshillim Publik të publikuar nga AKEP, ka parashtuar ecurinë e komunikimeve të mëparshme me AKEP për procese të ngjashme analizash tregu, si edhe ka paraqitur përshkrimin e praktikës së ndjekur nga vendet e Bashkimit Europian mbi zbatimin e parashikimeve të Kodit të Komunikimeve Elektronike, veçanërisht për procesin e Analizës së tregjeve dhe nxitjes së konkurrencës.

Në mënyrë më specifike, sipërmarrësi Neofone ndër të tjera komenton se:

- Për shkak të rregullave të vendosura nga AKEP sipas Analizës së Tregut Celular paraardhëse, dhe praktikave të zbatuara nga operatorët celularë për përcaktimin e tarifave të thirrjeve ndërkombëtare në kushtet e liberalizimit të tregut përkatës të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare ka bërë që Neofone të jetë në një situatë pamundësie për ushtrimin e kësaj veprimtarie që prej vitit 2015 si dhe në mosmarrëveshje historike me këta operatorë dhe AKEP-in si organi rregullator kompetent;
- Në këndvështrimin e Neofone, Analiza e Tregut e kryer nga AKEP është një material shumë voluminoz nga pikëpamja teorike e bazës ligjore, por mungojnë statistikat, analizat individuale të detajuara për çdo shërbim, sipërmarrësit, proceset administrative dhe ligjore, bashkëpunimi i AKEP me Autoritetin e Konkurrencës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. AKEP, në dokumentin e Analizës së Tregut nuk përmend asnjë nga proceset ligjore me subjektin Neofone edhe subjekte të tjera, e sidomos procesin ligjor i cili është në shqyrtim nga Gjykata e Apelit, proces në të cilin Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin nr.952, datë 28.12.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania sh.a., në tregun e shërbimeve celulare: Tregu me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe dhënien e disa detyrimeve”, ka vërtetuar abuzimin me pozitën dominuese kundrejt Neofone nga sipërmarrësi Vodafone Albania. Ky vendim i Autoritetit të Konkurrencës, i lënë në fuqi edhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë, vërteton dështimin e masave parandaluese *ex-ante* të AKEP për të garantuar konkurrencën në tregun e telekomunikacioneve e cila përbën në vetvete rolin kryesor të AKEP në bazë të neneve 7 dhe 8 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar;
- AKEP nuk përmend dy shkresat me objekt “Ankim Administrativ” të Neofone datë 24.7.2023, në të cilën Neofone i ka kërkuar AKEP nxjerrjen e aktit rregullator Analizë Tregu si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe përcaktimin e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin Vodafone të tranzituara nga Neofone;
- Bazuar në shqetësimet e ngritura në komentet e saj, sipërmarrësi Neofone kërkon zbatimin e Udhëzimit 2002 / C 165/03 për kryerjen e Analizës së Tregut, Përcaktimin e Tregjeve me FNT edhe Vendosjen e Masave Rregullatore. Gjithashtu, Neofone i kërkon AKEP-it nisjen e hetimit për aplikimin e tarifave nën kosto për paketat (*bundles*) nga operatorët mobile, pasi

ofertat e ofruara nga operatorët mobilë janë nën kosto dhe të subvencionuara nga shërbime të tjera. AKEP edhe pse në dijeni të këtij fakti të pretenduar disa herë nga Neofone, është përgjigjur me mosveprim duke ju shmangur kompetencave që i ka ngarkuar ligji nr. 9918;

- Në përfundim të komenteve të paraqitura, Neofone kërkon vendosjen e masave rregulluese për sipërmarrësit të vlerësuar me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), operatorët celularë (Vodafone Albania dhe One (bashkimi i Telekom Albania dhe Altelecom)), për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun e akses-origjinimit të thirrjeve kombëtare, duke vendosur për të tre operatorët celularë të deklaruar me FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe në tregun përkatës të aksesit dhe origjinimit, detyrimet e veçanta sipas neneve 39, 40, 41, 42 dhe 45, të ligjit nr. 9918.

Qëndrimi i AKEP

Dëshirojmë të sqarojmë se rishikimi dhe rregullimi i tregjeve të komunikimeve elektronike është një proces mjaft teknik dhe kompleks, dhe si i tillë bazohet në implementimin e plotë të legjislacionit shqiptar, gjithashtu, merr në konsideratë edhe një sërë udhëzimesh dhe rekomandimesh të Komisionit Evropian për të vënë në zbatim praktikat sa më të mira në fushën e rregullimit të komunikimeve elektronike në vendet e Evropës dhe më gjerë, me qëllim nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike.

Pavarësisht volumit të komenteve të Neofone, të cilat përmbajnë një përsëritje të historikut të Analizave Celulare në këtë treg, si dhe praktikave ndërkombëtare për analizat e tregjeve, referon dispozita dhe praktika të cilat ndërtojnë një konfuzion për lexuesin, duke cituar referenca ligjore dhe praktika të ankimuara ndër vite sipas dokumenteve të analizës përkatëse në kohën kur janë zhvilluar, ankimime administrative, ankimime gjyqesore, etj., të cilat nuk lidhen në mënyrë korrekte me dokumentin përkatës të këshilluar me palët aktualisht (*kjo është arsyeja përse analizat e tregjeve bëhen në mënyre periodike, pasi nënkupton evoluim të tregjeve dhe gjetje të ndryshme në përputhje me rrethanat dhe zhvillimet e tregjeve në periudha kohore të ndryshme, etj.*). Përsëritjet e gjetjeve të analizave të mëparshme, të trajtuara ndër vite nga AKEP, në kohën e kryerjes së tyre dhe vendimmarrjes përkatëse i kanë konsideruar ose jo komentet e sipërmarrësit Neofone sh.p.k., në kohën e paraqitjes së tyre dhe kanë rezultuar me vendimmarrjen përkatëse në kohën kur janë zhvilluar analizat sipas tregjeve të konsideruara në dokumentet respektive.

Gjithashtu, dëshirojmë të sjellim në vëmendje se, në përputhje me metodologjinë për hartimin e dokumenteve për përcaktimin e tregjeve përkatëse dhe analizën e tyre (në linjë me parashikimet rregullatore të aplikuar në vendet e BE-së), AKEP ka hartuar këtë dokument duke marrë në shqyrtim të dhënat e plota statistikore dhe financiare të tregut të marrë në analizë, duke përfshirë vlerësim të tij si në nivel shumice, ashtu edhe atë të pakicës.

II. Komentet sipas pyetjeve të Këshillimit Publik dhe qëndrimi i AKEP

Pyetja nr.1: Cili është opinionimi juaj për vlerat aktuale të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar të propozuar në këtë dokument deri në vitin 2025, sipas rezultateve të Modelit të Kostove të miratuar nga AKEP?

Komentet e Autoritetit të Konkurrencës

Autoriteti i Konkurrencës shprehet se, sipas analizës së kryer, tarifat e terminimit në Shqipëri janë më të larta se tarifa mesatare e thjeshtë e vendeve anëtare të BE dhe vendeve që raportojnë në BEREC. Tarifat e terminimit në Shqipëri kanë ardhur duke u reduktuar në mënyrë të përshkallëzuar si rezultat i ndërhyrjes së AKEP, nga viti në vit, duke konverguar drejt një simetrie të plotë mes tre operatorëve, duke pasur fillimisht një asimetri midis dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj) kundrejt operatorëve ekzistues Vodafone Albania dhe One Telecommunications, për të shkuar drejt një simetrie të plotë pas daljes së Plus nga tregu, në tetor 2018. Me ndryshimet e reja të ndodhura në strukturën e tregut të telefonisë celulare pas bashkimit të Altelecom dhe One Telecommunications, tregu i telefonisë celulare ka kaluar nga 3 operatorë në 2 operatorë: Vodafone Albania dhe One Albania.

Komentet e One Albania

One Albania vlerëson propozimin e AKEP për përcaktimin e një *glide path*-i për implementimin e tarifës së thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar të saj deri në barazimin me koston e shërbimit të terminimit të thirrjeve sipas rezultateve të modelit të kostos, miratuar me VKD të AKEP nr. 10, datë 11.7.2021.

One kundërshton aplikimin e reduktimit të MTR-së sipas *glide path*-it të propozuar, bazuar në një sërë argumentesh:

- *Reduktimi i mëtejshëm dhe sinjifikativ*: One shprehet se, duke konsideruar trendin rënës të të ardhurave me shumicë vit pas viti, i cili vijon edhe për vitin 2023, në rast reduktimi të MTR-së sipas *glide path*-it të propozuar në dokumentin e analizës, të ardhurat neto të One Albania do të ulen edhe më shumë.
- *Mungesa e efekteve të mundshme pozitive tek përdoruesi fundor nga Reduktimi i MTR*: One shprehet se reduktimi i MTR nuk sjell ndonjë efekt pozitiv në lidhje me përdorimin e trafikut zanor nga abonenti. Kjo për faktin se në Retail, One i ofron abonentëve paketa me minuta të bollshme drejt të gjitha rrjeteve fikse dhe celulare, të cilat as nuk arrijnë të konsumohen nga abonenti.
- *Përkeqësim i rezultatit financiar negativ i operatorëve celularë*: Nga të dhënat e publikuara për vitin 2022, është evidentuar rezultat financiar negativ për të gjithë operatorët celularë dhe gjithashtu një rënie e investimeve në rrjetet celulare. Çka do të thotë se një ulje e mëtejshme e të ardhurave për shkak të reduktimit të tarifave të terminimit do të përkeqësojë më shumë humbjen tonë, dhe do ta bëjë edhe më të vështirë investimin për shërbime të reja dhe teknologjinë 5G.

- *Ulja e të ardhurave të AKEP nga pagesa e mbikëqyrjes së tregut:* One shprehet se reduktimi i MTR do të ndikojë gjithashtu negativisht të ardhurat e AKEP nga pagesa e operatorëve për mbikëqyrjen dhe supervizimin e tregut, e cila llogaritet si përqindje e të ardhurave vjetore të operatorëve.
- *Reduktimi i të ardhurave për shtetin nga ulja e TVSH-së:* One shprehet se nga reduktimi i tarifës së terminimit të thirrjeve ndërmjet operatorëve, reduktimi i të ardhurave nga tregtimi i këtyre shërbimeve do të përkthehet përkatësisht në ulje të taksës së TVSH, duke ndikuar në mënyrë indirekte edhe në uljen e buxhetit të shtetit.
- *Konsiderimi i praktikës evropiane në rastin e vendosjes së Euro tarifës:* One shprehet se edhe në BE, vendosjes së një MTR/FTR të vetme në të gjithë BE-në i ka paraprirë procesi dhe diskutimi gradual të paktën 10-vjeçar dhe madje është detyruar nga zbatimi i RLAH në BE. Prandaj, reduktimi i MTR-ve drejt rezultateve të kostos ka nevojë për një kohë të përshtatshme në mënyrë që operatorët të kenë kohë për t'u përgatitur mbi ndikimet e pritshme.

Për sa më sipër One Albania kërkon shtyrjen në kohë të aplikimit të *glide path*-it të MTR, duke filluar nga 1.1.2025, dhe zgjerimin e periudhave me 12 muaj sipas propozimit më poshtë:

		01.12.2019	01.01.2025_	01.01.2026_	01.01.2027_
ONE	Albania				
/Vodafone	Albania	1.11	1.02	0.89	0.75

Komentet e Vodafone Albania

Vodafone Albania mbështet parimisht qasjen për një reduktim gradual të tarifave të terminimit sipas një *glide path* disa vjeçar, që siguron një ulje graduale të zbutur të MTR duke mitiguar efektet kolaterale dhe shprehet se duhen marrë parasysh disa faktorë ndikues për rishikimin e MTR kombëtare:

- Shërbimet e platformave OTT po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë shërbimet klasike të komunikimeve elektronike duke sjellë për rrjedhojë një rënie graduale të vazhdueshme të niveleve të trafikut të thirrjeve zanore dhe, si rezultat, më pak të ardhura të arkëtuara nga këto shërbime.
- *Glide path* i ri, nëse do të parashikojë një rënie drastike të MTR-ve kombëtare mund të ketë një efekt negativ në nivelin e të ardhurave neto të raportuara e konsoliduara në nivel Grupi Vodafone, ku ulja e të ardhurave neto ka ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen e investitorëve për investime të reja në tregun shqiptar nga Vodafone Group, sidomos në spektër si 5G, etj.

Për sa më sipër, Vodafone propozon modelin si më poshtë, me një rishikim të lehtë të modelit të propozuar nga AKEP:

	Si është	Prill '24	Prill '25	Prill '26	Prill '27
Propozimi i Vodafone (LEK/min)	1.11	1.02	0.93	0.84	0.75
% ndryshimi		-8.1%	-9.0%	-9.0%	-11.2%

Qëndrimi i AKEP:

Nga komentet vihet re se të dy sipërmarrësit, One Albania dhe Vodafone Albania, mbështesin parimisht qasjen për një reduktim gradual të tarifave të terminimit sipas një *glide path* disa vjeçar, duke propozuar një rishikim të modelit të propozuar nga AKEP. One Albania kërkon shtyrjen në kohë të aplikimit të *glide path*-it të MTR, duke filluar nga 1.1.2025, dhe zgjerimin e periudhave me 12 muaj, gjithashtu edhe Vodafone Albania ka propozuar një rishikim të afatit të fillimit të reduktimit të tarifave duke filluar nga muaji prill 2024, por me një shkallëzim të ndryshëm nga modeli.

AKEP konsideron se Analizat e Tregut ndër vite, përfshirë edhe dokumentin aktual, të cilat kanë patur në fokus reduktimin e tarifimit të shërbimit të terminimit, kanë vlerësuar në mënyrë racionale reduktimin e MTR-së. Në këtë aspekt edhe *glide path* i propozuar mbart racionalitet në reduktimin e kësaj tarife, pasi tregjet e terminimit celulare dhe fikse mund të jenë në proces rishikimi në të ardhmen, me një periodicitet që referon edhe Kodi Evropian për Komunikimet Elektronike (EECC) dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe BEREC mbi Analizat e Tregjeve.

AKEP vlerëson që propozimi për *glide path-in* e referuar në dokumentin për Këshillim Publik është i arsyeshëm pasi ka marrë parasysh rezultatet dhe rekomandimet e kompanisë konsulente për ndërtimin e një modeli kostosh sipas metodës BULRIC duke marrë në konsideratë rrethanat kombëtare (rezultatet finale të modelit dhe rekomandimi final i konsulencës, janë pasqyruar në seksionin 5 të dokumentit të Këshillimit Publik). Ndërtimi i modelit të kostos BULRIC për shërbimet celulare është bërë në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian për orientimin e tarifave të terminimit drejt kostos. Dokumentet për hartimin e modelit të kostove dhe rezultatet finale të tij janë konsultuar gjerësisht me palët e interesuara, dhe operatorët celularë kanë paraqitur gjatë fazave përkatëse komentet dhe sugjerimet e tyre përpara miratimit final nga AKEP.

Në vijim të sa më lart, AKEP pas shqyrtimit të komenteve të operatorëve në lidhje me *glide path-in* e propozuar, ka vendosur të marrë në konsideratë pjesërisht komentet e ardhura për reduktimin e parashikuar të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet e telefonisë mobile. Tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile do të jenë sipas vlerave dhe afateve të mëposhtëm:

	1.12.2019	01.10.2024	01.04.2025	01.10.2025
Tarifa maksimale e Terminimit të thirrjeve (lek/min pa TVSH)	1.11	1.02	0.89	0.75

Pyetja nr.2: A duhet ta konsiderojë AKEP që në periudhën nga viti 2025 e në vijim, që edhe në Shqipëri të aplikohen tarifa terminimi të njëjta me euro tarifën, sipas të njëjtave vlera të unifikuar për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore edhe në vendet e BE-së?

Komentet e Autoritetit të Konkurrencës:

Autoriteti i Konkurrencës shprehet se tarifatat aktuale të vendeve të BE-së janë më të ulëta se tarifatat aktuale të terminimit në Shqipëri, kështu, vlerëson se AKEP duhet të konsiderojë që nga viti 2025 e në vijim të implementojë metodologjinë e vendeve të BE-së për përcaktimin e tarifave të terminimit, duke qenë se ato kanë për qëllim orientimin e çmimeve drejt kostos së terminimit të thirrjeve.

Komentet e One Albania:

One Albania mendon se nga momenti i aplikimit të MTR-së në nivelin 0.75 lekë/min sipas kostos dhe kostos së shërbimit të terminimit të thirrjeve, tarifa e terminimit duhet të vijojë në këtë nivel deri kur Shqipëria të bëhet anëtare e EU-së me të drejta të plota.

Komentet e Vodafone Albania:

Vodafone lidhur me këtë çështje shprehet se synimi për të aplikuar një euro tarifë të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore për Shqipërinë njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së do të impaktojë të dy tregjet: i. Tregun Kombëtar dhe ii. Tregun Ndërkombëtar të terminimit të thirrjeve, duke çuar në një reduktim drastik deri në 0.2 euro cent/minute. Vodafone kundërshton një iniciativë të tillë, sidomos për terminimin ndërkombëtar prej të cilit ende operatorët sigurojnë një përqindje të rëndësishme të ardhurash. Sipas Vodafone, dokumenti ri ngre për diskutim çështjen e rregullimit të tarifave ndërkombëtare të terminimit, problematikë kjo e trajtuar gjerësisht në të shkuarën që prej vitit 2012, kur AKEP, me Vendimet nr. 1739, 1740 dhe 1741, datë 20.12.2011, vendosi ta derregullojë këtë treg dhe ta ndajë nga ai i terminimit të thirrjeve Kombëtare.

Në këto kushte, VFAL kundërshton një rregullim aktual dhe të menjëhershëm brenda vitit 2025 të tarifave të terminimit ndërkombëtar, duke synuar implementimin uniform me vendet e BE-së.

Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron se qëllimi i ndërtimit të modelit të kostos BULRIC për shërbimet celulare dhe përlllogaritja e rezultateve të modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare, miratuar me Vendimin nr.10, datë 22.7.2021, është përcaktimi i tarifave të terminimit të orientuara në kostot e ofrimit të shërbimit të terminimit të thirrjeve mobile. Ndërtimi i modelit të kostos BULRIC për shërbimet celulare është bërë në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian për orientimin e tarifave të terminimit të thirrjeve drejt kostos. Mbi këtë bazë ka referuar edhe reduktimin e përshkallëzuar "glide path" të MTR-së kombëtare, përshkallëzim i cili parashikon reduktimin e tarifës aktuale të terminimit të thirrjeve mobile në nivelin 0.75 lekë/minutë deri në fillim të vitit 2025. Synimi për të aplikuar një euro tarifë të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore për Shqipërinë njësoj si tarifa e unifikuar e

BE-së mbetet opion i një vendimmarrje të mëvonshme të AKEP, e cila padiskutim do të jetë pjesë e një procesi Analize dhe Këshillimi me palët e interesuara, duke marrë në konsideratë në mënyrë më të hollësishme të gjitha argumentet *pro* dhe *kundër* këtij opsioni.

Pyetja nr.3: Cili është opinioni juaj mbi propozimin e AKEP-it për heqjen e masës rregullatore të detyrimit për mosdiskriminimin e thirrjeve *on-net* vs *off-net* në rrjetet mobile?

Komentet e Vodafone Albania:

Sipas Vodafone, tërheqja e kësaj mase rregullatore do t'i linte shteg operatorëve që të përfitojnë në periudha të caktuara dhe të rihapin një luftë çmimesh me njëri - tjetrin, si dhe hap mundësinë që operatorët të aplikojnë një tarifë preferenciale brenda rrjetit, të cilat do të sjellin automatikisht humbjen e të ardhurave (veçanërisht në kohë "luftë çmimesh"). Gjithashtu, nga pikëpamja e eksperiencës konsumatore, do të krijojë konfuzion për klientin për të kuptuar e kombinuar produktet, kur në treg ka aktualisht një gamë të gjerë produktesh e shërbimesh.

Komentet e One Albania:

Lidhur me masën rregullatore të mosdiskriminimit *on-net/off-net*, One Albania mendon se kjo masë nuk duhet të hiqet, pasi në çdo rast ruan konkurrencën e lirë dhe të ndershme në treg, dhe shmang stimujt për praktika antikonkurrese nga ana e operatorëve duke kufizuar zgjedhjen e biznesit dhe duke lejuar potencialisht një lojtar të madh të dëmtojë konkurrencën. One Albania çmon se heqja e detyrimit të mosdiskriminimit *on-net/off-net* shoqëruar edhe me reduktimin e tarifave të terminimit, ekspozon vetëm shoqërinë One Albania me zhvillime jo pozitive të tregut celular, duke kërkuar ruajtjen e këtij detyrimi edhe në këtë raund të procesit të Analizës së Tregut.

Komentet e Autoritetit të Konkurrencës:

Sipas Autoritetit të Konkurrencës, nga periudha në të cilën është vendosur kjo masë rregullatore situata e ndërmarrjeve që operojnë në treg ka ndryshuar qenësisht, ku nga katër ndërmarrje, tashmë në treg ka vetëm dy, One Albania dhe Vodafone Albania, me pjesë tregu të përafërta për sa i përket numrit të pajtimtarëve, por pavarësisht në kushtet kur AKEP ende nuk ka realizuar një analizë të tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, vlerësohet se kjo masë rregullatore duhet të jetë ende në fuqi.

Qëndrimi i AKEP:

Duke lexuar me vëmendje argumentet e sjella nga dy rrjetet celulare "*për mosndryshimin e masës rregullatore të mosdiskriminimit on-net/off-net, masë rregullatore e vendosur nga AKEP në vitin 2014*", një masë rregullatore e kontestuar në argumente të shumta në kohën e vendosjes nga dy rrjetet celulare aktuale, e ankimuar në rrugë administrative dhe gjyqësore nga ana e tyre, si dhe duke lexuar sugjerimet aktuale të dy rrjeteve celulare, të cilët referojnë në komentet e tyre se kjo masë rregullatore është e 'dobishme' për të dy operatorët aktual mobile, krijohet dyshimi nëse është kuptuar qartë se në dokumentin e paraqitur në Këshillim Publik është propozuar heqje



e masës rregullatore dhe jo modifikim apo ristrukturim i kësaj mase. Kjo duke konsideruar që përfaqësuesit e këtyre sipërmarrësve e kanë kundërshtuar fuqimisht vendosjen e kësaj mase rregullatore në vitin 2014 nga AKEP. Të plota argumentet kundërshtuese gjenden në dokumentet e miratuara me VKD nr.2522, datë 6.11.2014, në faqen zyrtare të AKEP (<https://akep.al/vendime-te-keshillit-drejtues/>).

Jo vetëm bazuar në argumentet e dhënë për dokumentin e Këshillimit Publik, mbi arsyet bazë pse duhet hequr kjo masë rregullatore, por referuar edhe qëndrimeve të mbajtura në vitin 2014 nga Vodafone Albania dhe One Albania (ish AMC), kundër vendosjes së masës rregullatore të mosdiskriminimit *on-net/off-net*, vlerësojmë se:

Qëndrimi i referuar në komentet aktuale nga Vodafone Albania dhe One Albania për mosheqjen e masës rregullatore të mosdiskriminimit *on-net/off-net*, nuk është i drejtë arsyeshëm (arsyetuar drejtë), pasi në fund të fundit ajo është një masë rregullatore e vendosur në një moment të caktuar, për arsyet e kohës dhe nuk duhet konsideruar si '*instrument efikas*' që ndihmon operatorët celularë në performancën e tyre. Çdo masë rregullatore, kur hiqet, në parim mirëpritet nga aktorët e tregut të cilët në një moment të caktuar mund të jenë ngarkuar me një masë rregullatore përkatëse. Rasti konkret, heqja e masës rregullatore e propozuar nga rregullatori, lehtëson skuadrat e sipërmarrësve për të propozuar oferta më fleksibël dhe të pandikuara nga kushtet rregullatore siç edhe janë deri në këtë moment.

Ndërkohë AKEP sjell në vëmendje se në rolin e rregullatorit ka në konsideratë jo vetëm mbarëvajtjen dhe shëndetin financiar të dy rrjeteve celulare, të cilat duhet të rezultojnë në nxitje të investimeve dhe rritje të cilësisë së shërbimit, por edhe konsumatorin fundor për rritjen e mundësive të tyre për përfitimin e produkteve/shërbimeve përkatëse me një ofertë të arsyeshme dhe racionale nga ofertuesit e tij, të krahasueshme dhe me vendet e rajonit dhe më gjerë mbi cilësinë, përmbajtjen e paketave dhe çmimin final të tyre.

Në këtë këndvështrim, AKEP nuk është dakord me qëndrimin e të dy operatorëve Vodafone Albania dhe One Albania për mosheqjen e kësaj mase rregullatore, pasi jo vetëm propozimi për mosheqje mase është konfuz, por arsyet bazike lidhen me faktin se tashmë situata në të cilën ndodhet tregu i telefonisë celulare ka ndryshuar, duke pasur vetëm dy operatorë celularë, kjo edhe në mungesë të MVNO-ve në këtë treg, me bazë pothuajse të njëjtë të pajtimtarëve, në kushtet e një niveli të ulët të tarifave të terminimit afër kostos eficiente të shërbimit të terminimit dhe në simetri të plotë të tyre. AKEP e ndërmori masën e mosdiskriminimit *on-net vs off-net* në vitin 2014 në një treg me 4 operatorë mobile dhe në kushtet e tarifave të larta të terminimit të thirrjeve, ku thirrjet drejt rrjeteve të tjera celulare bashkë me efektin '*club*' penalizonin operatorët më të vegjël në treg kundrejt operatorëve që kishin pjesë më të madhe tregu. Ky ka qenë dhe faktori kryesor që AKEP përcaktoi këtë masë rregullatore.

Në kushtet kur ulja e volumit të thirrjeve voice është reduktuar ndjeshëm në favor të rritjes së thirrjeve nëpërmjet shërbimeve OTT, dhe kur pjesët e tregut të dy operatorëve mobile Vodafone Albania dhe One Albania janë të ngjashme, me një strukturë të balancuar të pajtimtarëve dhe të thirrjeve, AKEP vlerëson se aplikimi i kësaj mase rregullatore nuk është më i nevojshëm.

AKEP, mbi komentin e Autoritetit të Konkurrencës për mosndryshimin e masës rregullatore të mosdiskriminimit të thirrjeve *on-net* vs *off-net*, e konsideron më shumë për t'i shërbyer rekomandimit të adresuar për AKEP, me qëllim që të zhvillojë një analizë në tregun celular me pakicë, para se të tërheqë masën përkatëse, se sa të lidhur objektivisht me arsyet reale të dhe argumentet e referuara në dokumentin përkatës të këshilluar me palët nga AKEP. E PAQARTE

Gjithsesi, AKEP monitoron me kujdes të veçantë situatën e çmimeve me pakicë në treg nga të dy operatorët në tregun e shërbimeve celulare dhe do të bashkëpunojë vazhdimisht me Autoritetin e Konkurrencës në rast të dyshimeve për abuzime me pozitën dominuese apo praktika të ndaluara. AKEP është shprehur se periodikisht në dokumentet për Këshillim Publik trajton edhe ecurinë e tregut me pakicë, por në funksion të evidentimit të konkurrueshmërisë në këtë nivel dhe jo me synim vendosjen e masave rregullatore në nivelin e pakicës, duke konsideruar në mënyrë të qartë specifikat dhe karakteristikat e ndërhyrjeve *ex-ante* dhe *ex-post*.

Për sa më lart, e konsiderojmë të drejtë propozimin e bërë për heqjen e masës rregullatore të mosdiskriminimit të thirrjeve *on-net* vs *off-net* dhe do e pasqyrojë në vendimmarrjen përkatëse në përfundim të procesit të kësaj analize.

Pyetja nr.4: Cili është opinionin juaj për opsionet e paraqitura nga AKEP për rregullimin në tregun e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare?

Komentet e Autoritetit të Konkurrencës:

Autoriteti i Konkurrencës shprehet se kostot e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, janë thuajse të njëjta, pasi terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është një shërbim që kryhet në RSH. Në dokumentin e nxjerrë për Këshillim Publik rezulton se pesha e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara është reduktuar ndjeshëm për shkak të rënies së trafikut hyrës ndërkombëtar, por edhe për shkak të rritjes së ndjeshme të trafikut *off-net*, por MTR ndërkombëtare gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje krahasuar me vitet 2019 – 2021, periudhë gjatë të cilës ka qenë në nivelet më të ulëta.

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se AKEP duhet të përdori praktikën më të mira të vendeve të BE që rregullimi/derregullimi t'i shërbejë rritjes së konkurrencës dhe uljes së tarifave, duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos.

Komentet e Vodafone Albania:

Vodafone kundërshton kategorikisht rregullimin e tarifave për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare për disa arsye:

- Më pak të ardhura për operatorët dhe më pak të ardhura për buxhetin e shtetit nga një reduktim i MTR-së në 0.762 lek/min për thirrjet hyrëse ndërkombëtare (40-fish krahasuar me nivelin aktual të MTR-ve ndërkombëtare);
- Disbalancë në të ardhura midis operatorëve vendas dhe atyre të huaj me një ulje të të ardhurave të terminimit ndërkombëtar për operatorët që operojnë brenda Republikës së Shqipërisë (si rrjedhim më pak të ardhura në buxhet dhe potencialisht “waterbed effect”);

- Qasje e ngjashme nga vende jo-anëtare të BE-së që vijojnë të diferencojnë trafikun, duke rregulluar vetëm tarifatat kombëtare;
- Qasja e vetë BE-së për të diferencuar tarifatat me vendet jashtë BE-së;
- Rregullimi i tarifave ndërkombëtare do të ulë të ardhurat e operatorëve e për rrjedhojë fuqinë e tyre investuese në vend.

Komentet e One Albania:

One Albania shprehet se terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare nuk duhet të përfshihet në tregun e terminimit të thirrjeve në rrjetin celular, për shkak se ky treg gëzon karakteristika të veçanta nga tregu i terminimit të thirrjeve të origjinuara brenda Shqipërisë dhe zona gjeografike e rregullimit është jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

One Albania shprehet kategorikisht kundër çdo opsioni të rregullimit të tarifës së terminimit ndërkombëtar, qoftë duke e barazuar me MTR kombëtare, qoftë me një reduktim të përshkallëzuar të ndryshëm nga ai i propozuar për MTR-të kombëtare, për disa arsye:

- Redukton në mënyrë sinjifikative të ardhurat e operatorëve celularë;
- Përkeqëson rezultatin financiar negativ të operatorëve celularë;
- Redukton indirekt të ardhurat e AKEP;
- Ul stimujt për investime në shërbime të reja dhe teknologjinë 5G;
- Dobëson fuqinë negociuese të operatorëve celularë shqiptarë kundrejt partnerëve ndërkombëtarë;
- Nuk ka impakt për përdoruesin fundor dhe krijon fitim të tepërt për carrier-ët ndërkombëtar.

Për sa më sipër, ONE kërkon lënie në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, siç është aktualisht, si i vetmi opsion që siguron qëndrueshmërinë financiare të operatorëve celularë.

Komente të Neofone

Neofone kërkon vendosjen e masave rregulluese për sipërmarrësit të vlerësuar me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT), operatorët celularë (Vodafone Albania dhe One (bashkimi i Telekom Albania dhe Altelecom), për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare dhe tregun e akses-origjinimit të thirrjeve kombëtare, duke vendosur për operatorët celularë të deklaruar me FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe në tregun përkatës të aksesit dhe origjinimit, detyrimet e veçanta sipas neneve 39, 40, 41, 42 dhe 45, të ligjit nr. 9918.

Qëndrimi i AKEP:

Në lidhje me terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, AKEP ka analizuar gjerësisht argumentet *pro* dhe *kundër* për përfshirjen ose jo të këtij tregu nën rregullim sipas opsioneve të propozuara në Këshillimin Publik, si: (i) Përfshirjen e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare); (ii) me përkufizimin si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje *ex-ante* dhe FNT me të

gjitha detyrimet si MTR kombëtare ose vetëm me detyrim dhënie aksesi dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare; (iii) aplikimin e një reduktimi të veçantë nëpërmjet *glide path* edhe për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare, duke synuar në afatmesëm orientimin drejt MTR kombëtar; (iv) lënie në derregullim siç është aktualisht.

AKEP, në këtë fazë, duke konsideruar faktorët “*pro dhe kundër*” të referuar në dokumentin e analizës për shërbimin e terminimit të thirrjeve mobile, karakteristikat dhe rrethanat kombëtare, qasjen e Komisionit Evropian për mosrregullimin e thirrjeve ndërkombëtare nga dhe drejt vendeve të treta (jashtë BE-së), vlerëson lënien në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare siç është aktualisht, deri në fazën e ardhshme të Analizës së Tregut ku do të analizohet edhe mundësia për të orientuar tarifatat drejt një euro tarife të njëjtë për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore në Shqipëri, njësoj si tarifa e unifikuar e BE-së në tregjet e terminimit.

Për sa më lart, AKEP vlerëson lënien në derregullim të tregut të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare siç është aktualisht, deri në fazën e ardhshme të Analizës së Tregut.

Eig

